



ANKETA KOMBËTARE E MIGRACIONIT NË FAMILJE NË SHQIPËRI





ANKETA KOMBËTARE E MIGRACIONIT NË FAMILJE NË SHQIPËRI

Ky botim është financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, në kuadër të Programit Global "Migracion për Zhvillim".

Opinionet e shprehura në këtë dokument pasqyrojnë pikëpamjet e autorëve dhe nuk janë domosdoshmërisht përfaqësuese të opinionit të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe Organizatës Ndërkombëtare të Migracionit (IOM).

Gjithashtu, emërtimet e përdorura dhe paraqitja e materialeve përgjatë dokumentit nuk nënkuptojnë shprehjen e asnjë qëndrimi nga ana e IOM-it lidhur me statusin ligjor të ndonjë vendi, territori, qyteti, zone apo me autoritetet e tyre, apo në raport me kufijtë e kufizimet e tyre.

IOM-i i përmbahet parimit se migracioni i rregullt e njerëzor është në të mirë të migrantëve dhe shoqërisë. Si organizatë ndërqeveritare, IOM-i vepron me partnerët e tij dhe bashkësinë ndërkombëtare për të ndihmuar në përballimin e sfidave operative të migracionit, për të thelluar kuptimin e çështjeve të migracionit, për të nxitur zhvillimin ekonomik e shoqëror përmes migracionit, si dhe për të ruajtur dinjitetin e mirëqenien e migrantëve.

Pjesa e parë e raportit është përgatitur nga Instituti Shqiptar i Statistikave.

Pjesa e dytë e raportit është përgatitur nga Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale - CESS Albania.

Botues: Organizata Ndërkombëtare për Migracion – Misioni në Shqipëri

Rruga Brigada VIII, P. LID

Kati III, Ap. 303

Tiranë, Shqipëri

Tel.: +355 42257836-7

Faks: +355 4225 7835

E-mail: infotirana@iom.int

Faqe interneti: www.albania.iom.int

Ky botim u publikua pa redaktim zyrtar nga IOM.

Ky botim është publikuar pa aprovimin e Njësisë së Publikimeve të IOM (PUB).

Ky botim është publikuar pa u përkthyer zyrtarisht nga Njësia TRS.

© 2020 International Organization for Migration (IOM)

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sistem të rikthimit, ose të transmetohet në çfarëdo forme ose me çfarëdo mënyre, elektronike, mekanike, fotokopjimi, regjistrimi, ose çdo formë tjetër, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit.

PJESA I

Anketa Kombëtare e Migracionit në Familje

Parathënie dhe falënderime

Instituti i Statistikave, në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin, kryen për herë të parë Anketën e Migracionit në familjet shqiptare për periudhën 2011-2019.

INSTAT punon vazhdimisht për përmirësimin e cilësisë së të dhënave të popullsisë. Edhe pse ka tashmë një gamë të gjerë anketash të kryera, të dhënash të mbledhura e statistikash të prodhuara si pjesë e kalendarit statistikor, anketë specifike për migracionin nuk kryhet në mënyrë sistematike. Megjithatë, matja e migracionit është mjaft e rëndësishme për Shqipërinë, për shkak të lëvizshmërisë së madhe të popullsisë, valëve të rëndësishme migratore dhe ndikimit domethënës që prodhojnë këto lëvizje në raport me potencialin e rritjes dhe zhvillimit që ka popullsia migratore, ndaj është e nevojshme që të kemi statistika më të konsoliduara në këtë drejtim.

Anketa e Migracionit në Familje do të kontribuojë për të mbledhur të dhëna të besueshme lidhur me përcaktuesit dhe ndikimet e migracionit në Shqipëri, si dhe do të ndihmojë INSTAT-in të zhvillojë njohuri mbi zgjerimin e gamës së indikatorëve që matin këtë fenomen.

Anketa shqyrton lëvizjet kryesore migratore të popullsisë shqiptare. E para e këtij lloji në Shqipëri, ajo ka një kampion prej më shumë sesa 20 000 familjesh dhe vë në zbatim disa teknika e qasje shumë novatore. Më tej, kjo anketë përpiket të ofrojë një panoramë gjithëpërfshirëse të lëvizjeve migratore në vend, me qëllim ofrimin e më shumë informacioneve për hartimin e politikave efektive. Ne besojmë se rezultatet e anketës do të jenë burim i dobishëm për politikëbërësit, institucionet administrative qendrore e vendore, si dhe për akademikët dhe studiuesit. Po kështu, ajo do të japë kontribute të vlefshme për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Migracionit (2019–2022) dhe Planit të saj të Veprimit, i cili parashikon përmirësimin e mbledhjes, analizës dhe ndarjes së të dhënave si një nga objektivat e veta specifike.

Anketa u bë e mundur falë mbështetjes së Qeverisë Gjermane përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe Programit Global “Migracion për Zhvillim” si dhe falë bashkëpunimit me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin. Informacioni i mbledhur na ofron një vështrim të thelluar mbi dinamikën e migracionit dhe ndihmon politikëbërësit, shoqërinë civile, organizatat ndërkombëtare dhe institucionet vendore e qendrore që të kuptojnë më mirë problemet dhe të ofrojnë shërbime të përshtatshme që synojnë si migrantët e mundshëm, ashtu edhe të kthyerit në Shqipëri. Falënderime dhe vlerësime të posaçme shkojnë për të gjithëve ata që, me përkushtim, kontribuan për këtë studim: ekspertet ndërkombëtare, Magdalena Mojsiewicz, personelit të INSTAT-it, Majlinda Nesturi dhe Olta Caca si dhe Zyrës së IOM-it në Tiranë për mbështetjen e tyre.

Elsa Dhuli, PhD

Drejtor i Përgjithshëm i INSTAT

Alma Jani

Drejtuese e Zyrës së IOM-it Shqipëri

Pasqyra e lëndës

Parathënie dhe falënderime	5
Shkurtime	7
Lista e tabelave	8
Lista e figurave	9
Harta	9
Përmbledhje	10
Hyrje	13
1. Karakteristikat dhe organizimi i anketës së migracionit në familje	14
1.1 Qëllimi i anketës	14
1.2 Objekti i anketës	16
1.3 Përmbajtja e anketës	18
1.4 Organizimi i anketës	19
2. Metodologjia e anketës së migracionit familjar	21
2.1 Plani i zgjedhjes së kampionit	21
2.2 Grupet e të dhënave	22
2.3 Përgjithësimi i rezultateve	22
3. Statistikat familjare – familjet që kanë ndryshuar vendbanimin që nga viti 2011	24
3.1 Emigracioni	24
3.2 Familjet me anëtarë të kthyer – fluksi hyrës i migracionit	27
3.3 Migracioni i brendshëm	29
4. Statistikat familjare – personat që kanë ndryshuar vendbanimin që nga viti 2011	32
4.1 Emigrantët	32
4.2 Të kthyerit dhe imigrantët – fluksi hyrës i migrantëve	35
4.3 Migrantët e brendshëm	37
5. Profili socio-demografik i personave që kanë ndryshuar vendbanimin që nga viti 2011	39
5.1 Mosha dhe gjinia	39
5.2 Arsimi	42
5.3 Statusi i punësimit	43
5.4 Arsytet e largimit nga vendbanimi – planet e migrantëve për të ardhmen	44
6. Përfundimet e anketës së migracionit familjar	47
6.1 Gjetjet kryesore të Anketa e migracionit në familje pa akronim 2019	47
6.2 Përfundime mbi sistemin e anketave të migracionit në Shqipëri	48
Bibliografi	50

Shkurtime

CAPI	Intervista personale përmes kompjuterit
DGF	Diskutim në Grupe të Fokusuara
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
NjEF	Njësi ekonomike familjare
AMF	Anketa e Migracionit në Familje
ISCED	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
INSTAT	Instituti Shqiptar i Statistikave
IIK	Intervistë me Informator Kyç
AFP	Anketa e Forcës së Punës
NUTS	Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikën
PSU	Njësi Primare Kampionimi
GSR	Gabime Standarde Relative
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara

Lista e tabelave

Tabela 1:	Dinamika migratore e vrojtuar në kuadër të AMF 2019	18
Tabela 2:	Struktura e familjeve shqiptare deri më 15 korrik 2019 sipas profilit të emigracionit dhe prefekturës	26
Tabela 3:	Struktura e familjeve shqiptare më 15 korrik 2019 sipas profilit të emigracionit dhe madhësisë së familjes	27
Tabela 4:	Struktura e familjeve shqiptare më 15 korrik 2019 sipas numrit të anëtarëve që kanë qëndruar jashtë për më shumë se 12 muaj dhe sipas prefekturës	28
Tabela 5:	Struktura e familjeve shqiptare më 15 korrik, sipas profilit të migracionit të brendshëm dhe prefekturës	30
Tabela 6:	Struktura e familjeve shqiptare më 15 korrik 2019 sipas profilit të migracionit të brendshëm dhe madhësisë së familjes	31
Tabela 7:	Numri i anëtarëve emigrues të familjes që nga viti 2011 deri më 30 shtator 2019, sipas prefekturës	32
Tabela 8:	Anëtarët e familjes që qëndrojnë jashtë më gjatë sesa 12 muaj sipas prefekturës	35
Tabela 9:	Individët që largohen nga familja për shkak të migracionit të brendshëm deri më 30 shtator 2011 sipas prefekturës	37
Tabela 10:	Numri i anëtarëve të familjeve shqiptare deri më 15 korrik 2019 ku përfshihen flukset migratore sipas grupmoshës	39
Tabela 11:	Anëtarët migrues të familjeve me migracion të pjesshëm më 15 korrik 2019 sipas moshës dhe gjinisë	40
Tabela 12:	Anëtarët migrantë të familjeve me migracion të pjesshëm deri më 15 korrik 2019 sipas nivelit arsimor	42
Tabela 13:	Anëtarët në moshë 15 vjeç e sipër nga familjet me migracion të pjesshëm deri më 15 korrik 2019 sipas statusit të punësimit	43
Tabela 14:	Anëtarët emigrues të familjeve me migracion të pjesshëm sipas planeve për të ardhmen	45
Tabela 15:	Të kthyerit që janë bashkuar me familjet e tyre sipas planeve për të ardhmen dhe vendit të mëparshëm të qëndrimit	46
Tabela 16:	Migrimi i brendshëm i familjeve me migracion të pjesshëm sipas arsyes së largimit nga vendbanimi	46
Tabela 17:	Karakteristikat kryesore të gjetjeve të AMF 2019	47

Lista e figurave

Figura 1:	Profili i emigracionit të anëtarëve të familjes 2011-2019	16
Figura 2:	Familjet që kanë emigruar tërësisht nga popullsia e vitit 2011	24
Figura 3:	Familjet që kanë emigruar në tërësi që nga viti 2011 sipas destinacionit	25
Figura 4:	Familjet që kanë emigruar tërësisht që prej vitit 2011 sipas prefekturës	27
Figura 5:	Lëvizjet e brendshme të familjeve tërësisht migrante që nga viti 2011 sipas prefekturës së destinacionit dhe origjinës	31
Figura 6:	Fluksi emigrator i familjeve nga popullsia në vitin 2011	33
Figura 7:	Numri kumulativ i anëtarëve të familjeve që kanë emigruar që në vitin 2011	34
Figura 8:	Struktura e imigrantëve që mbërritën në Shqipëri deri në 2019	35
Figura 9:	Numri kumulativ i anëtarëve të familjes që mbërritën në Shqipëri deri në 2019	36
Figura 10:	Numri kumulativ i anëtarëve të familjes që ndryshojnë vendbanimin brenda Shqipërisë	38
Figura 11:	Lëvizja e brendshme e familjeve që kanë migruar tërësisht që nga viti 2011 sipas destinacionit dhe prefekturës së origjinës	38
Figura 12:	Anëtarët emigrues të familjeve me migracion të pjesshëm deri më 15 korrik 2019, sipas moshës dhe gjinisë	41
Figura 13:	Imigrantët që janë bashkuar me familjet e mëparshme deri më 15 korrik 2019, sipas moshës dhe gjinisë	41
Figura 14:	Migrantët e brendshëm të familjeve me migracion të pjesshëm deri më 15 korrik 2019	42
Figura 15:	Struktura e anëtarëve të familjeve me migracion të pjesshëm të grupmoshës 15 vjeç e lart deri më 15 korrik 2019, sipas nivelit arsimor	43
Figura 16:	Struktura e familjeve shqiptare me migracion të pjesshëm sipas arsyes së emigracionit	44
Figura 17:	Të kthyerit që janë bashkuar me familjet e mëparshme sipas arsyes së kthimit dhe vendit të mëparshëm të qëndrimit	45

Harta

Harta 1:	Familjet nga viti 2011 me anëtarë me vendbanimin jashtë vendit në 2019, sipas prefekturës	25
Harta 2:	Familjet me një pjesë të anëtarëve të zhvendosur brenda vendit si rezultat i migracionit të brendshëm për periudhën 2011-2019, sipas prefekturës	29

Përmbledhje

INSTAT-i ka kryer një anketë të migracionit në familje, objektivi kryesor i së cilës është të ofrojë informacion për shkallën e migracionit neto për periudhën 2011-2019 dhe karakteristikat e popullsisë së përfshirë. Anketa u zhvillua në kuadër të Programit Global "Migracion për Zhvillim", i financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe implementuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin.

Përveç një shqyrtimi në thellësi të flukseve migratore neto për periudhën 2011-2019, kjo anketë ka prodhuar për herë të parë statistika mbi ndryshimin e vendbanimit nga familjet, kështu duhet konsideruar si studim eksperimental.

Një prej detyrave më të rëndësishme të statistikave zyrtare është të sigurojnë përlogaritjet lidhur me popullsinë jo vetëm në vitet e censeve, por edhe gjatë periudhave midis tyre. Në pjesën më të madhe të sistemeve statistikore evropiane, të gjitha matjet e nevojshme, përfshi ato që kanë të bëjnë me flukset migratore, janë të lidhura ngushtë me regjistrat zyrtarë. Me sistemin aktual të statistikave demografike, Shqipëria është një prej vendeve që ka probleme me gjenerimin e statistikave të mjaftueshme për migracionin. Matja e flukseve migratore në Shqipëri vijon të bazohet mbi anketimin e një kampioni përfaqësues të familjeve.

Anketat sociale janë të larmishme, si nga forma, ashtu edhe nga qëllimi. Disa formate të tyre lejojnë përdorimin e kampioneve më të mëdhenj dhe janë veçanërisht të përshtatshme për t'u zbatuar në vendet ku popullsia ka shkallë të lartë lëvizshmërie. Për këtë arsye, INSTAT-i, në bashkëpunim me IOM-in, përgatiti një anketë të zgjeruar të migracionit në familje, gjetjet e së cilës synojnë të tregojnë ndryshimet që kanë ndodhur gjatë viteve të fundit në shoqërinë shqiptare. Kjo anketë që i kushtohet veçanërisht migracionit përbën një zhvillim të rëndësishëm që ka për qëllim përmirësimin e statistikave në përgjithësi dhe të dhënave demografike dhe të migracionit, në veçanti. Duke qenë se është zhvilluar vetëm një herë, AMF-ja ka karakter ad hoc. Për anketën u përdor metoda CAPI (Intervistë Personale përmes Kompjuterit). Pyetësi u përgatit nga INSTAT-i, duke u këshilluar me ekspertin ndërkombëtar të rekrutuar nga IOM-i në kuadrin e projektit që ofron mbështetje për institutin lidhur me statistikën e migracionit. Për hartimin e pyetësorëve, u mor mbështetje e mëtijshme edhe nga Zyra Rajonale e IOM-it në Vjenë dhe Zyra Qendrore e IOM-it në Gjenevë.

Puna në terren u zhvillua nga 17 prilli deri më 15 korrik 2019. Hipoteza e AMF-së ishte se pyetjeve do t'u përgjigjeshin kryefamiljarët. AMF-ja ishte anketë e cila bazohet në vullnetin e lirë të familjeve për të marrë pjesë në anketë. Në shumicën e vendeve, kjo lloj ankete, sidomos kur mbulon familjet, ka një normë përgjigjeje prej 30 për qind. Shqipëria përbën një rast përjashtimor, pasi AMF 2019 shënoi një normë përgjigjesh prej 80 për qind. Refuzimi për të marrë pjesë në anketë dhe mungesa e kontaktit me NjEF-të e përzgjedhura në mënyrë rastësore ishin relativisht të rralla, me pak më shumë sesa 20 për qind. Qëndrimi i favorshëm i të intervistuarve ishte i mjaftueshëm për të justifikuar përdorimin e kampioneve përfaqësues në anketat sociale në Shqipëri.

Përjashtimisht, ndryshe nga të gjitha praktikatat e mëparshme të INSTAT-it, AMF bën të mundur që në rast se të gjithë anëtarët e familjes nuk ishin të pranishëm, të përgjigjeshin fqinjët e tyre më të afërt. Avantazhi kryesor i kësaj zgjidhjeje ishte ulja e normës së mosmbulimit të popullsisë. Madhësia e kampionit të arritur (numri i njësisë të vrojtueshme të kampionit për familje dhe individë me intervistë të pranuar) është i barabartë me 19 821 për familjet dhe 71 538 për individët. Rezultatet e anketës përqendrohen në tiparet kryesore demografike të NjEF-ve dhe popullsisë që kanë ndryshuar vendbanimin krahasuar me vitin 2011 (Censi i fundit i Popullsisë dhe Banesave të Shqipërisë). Ajo çka ishte më e rëndësishme dhe novatore në zërthimin e vlerave të përlogaritura në këtë anketë ishte dallimi i profileve të migracionit të familjeve. Numri në vijim i familjeve dhe personave migrantë u përlogarit sipas llojit të profilit të migracionit, si më poshtë:

- asnjë pjesëtar i familjes nuk ka migruar (zero migracion),
- së paku një, por jo të gjithë pjesëtarët e familjes, ka migruar dhe
- e gjithë familja ka migruar

Karakteristikat kryesore të familjeve shqiptare sipas profileve të migracionit përfutur nga AMF-ja janë si vijon:

- Në vitin 2019, numri i NjEF-ve pa migrantë si brenda dhe jashtë vendit që nga viti 2011 ishte 493 841. Popullsia e këtyre familjeve ishte 1 872 974 persona.
- Sa i takon fluksit dalës: 171 482 NjEF kategorizohen në profilin e migracionit të pjesshëm (të paktën, një anëtar i familjes ka migruar që prej vitit 2011 jashtë ose diku tjetër në Shqipëri).
- Sa i takon fluksit hyrës: 64 740 NjEF përfshihen në kategorinë e profilit të imigracionit të pjesshëm (të paktën, një anëtar i familjes është kthyer ose ka imigruar që nga viti 2011).
- Numri i familjeve që kanë lëvizur plotësisht si brenda dhe jashtë vendit ishte 84 434 në 2019, me 311 194 persona.

Duke qenë studim i rishtë, kjo anketë nuk duhet krahasuar me statistika të tjera zyrtare në Shqipëri, si Anketa e Forcave të Punës. Në anketat e zakonshme, INSTAT-i përshkruan popullsinë e pjesëtarëve të familjeve me profil migracioni të pjesshëm.

Në periudhën 2011-2019, të gjitha familjet migrante përbëjnë 6,6 për qind (47 669 NjEF) të familjeve shqiptare të numëruara nga Censi i fundit i vitit 2011 ose 6,5 të të gjithë popullsisë shqiptare (183 428 persona). Për të njëjtën periudhë, 6,4 për qind e popullsisë shqiptare (180 606) ka migruar, duke lënë 15.5 për qind të NjEF-ve (111,950). Këto janë familje me profil migrator të pjesshëm.

Tiparet kryesore demografike të migrantëve të përfutur nga anketa, zakonisht, marrin si referencë anëtarët e familjeve shqiptare që migrojnë pjesërisht. Për popullsinë me profil migracioni të plotë, informacioni i grumbulluar lejon vetëm përlogaritjen e numrit të familjeve që dërgojnë migrantë dhe sa është masa e popullatës migrante nga këto familje. Sa i takon përkufizimit dhe objektit, këto tipare mbeten ato që janë më shumë në linjë me metodikën aktuale të anketave të migracionit nga INSTAT-it. Megjithatë, rezultatet e këtyre anketave mbeten ende pjesërisht të krahasueshme, si rrjedhojë e vërtetimit të flukseve të migracionit neto në AMF 2011-2019.

Analiza e moshës dhe gjinisë së migrantëve tregon dallime ndërmjet gjinive në tri grupet kryesore ku mund të analizohen karakteristikat socio-demografike. Grupet që janë veçuar janë emigrantët, imigrantët dhe personat që kanë lëvizur brenda vendit. Ka dy përfundime kryesore që nxirren nga kjo analizë.

E para, ka të bëjë me mbizotërimin e burrave kundrejt grave në kategorinë e emigrantëve dhe imigrantëve. Për emigrantët, u regjistruan deri në 200 për qind burra më shumë se gra në grupmoshën 30-56 vjeçare, ndërsa për imigrantët e së njëjtës grupmoshë, numri i burrave e tejkalonte atë të grave me 400 për qind. Përveç kësaj, te individët që lëvizin së brendshmi është vënë re se ka tejkalim domethënës të numrit të grave kundrejt burrave për moshën 15 vjeç e sipër. Në grupin e personave 15 vjeç e sipër, u mbledhën të dhënat për nivelin arsimor dhe statusin e punësimit. Personat me nivel të lartë arsimor mes emigrantëve dhe imigrantëve ishin përkatësisht 13,97 dhe 11,97 për qind.¹ Analiza e statusit të punësimit tregon se flukset migratore përbëhen më së shumti nga popullsia në moshë aktive. Megjithatë, vlen të përmendet se mes imigrantëve ka një numër të lartë personash joaktivë, në pension apo pension të parakohshëm.² Rreth 9 000 imigrantë në këtë grup shfaqin prirjen që personat që largohen nga tregu i punës të kthehen. Nga të dhënat e mbledhura u mundësua gjithashtu vlerësimi i shpërndarjes së migrantëve, bazuar në arsyen e ndryshimit të vendbanimit. Personat që kanë emigruar për arsye financiare dhe për kushte më të mira punësimi e jetese ishin rreth 65 për qind. E njëjta përqindje u regjistrua edhe mes të kthyerve në Shqipëri, të cilët përmendën arsyet familjare si motiv për kthimin e tyre. Për personat që migrojnë brenda vendit, arsyet familjare ishin faktorët më të shpeshtë shtytës (52 %).

Matja e flukseve migratore në Shqipëri duhet përmirësuar vazhdimisht. Si një anketë e re pranë familjeve, AMF-ja, duke përfshirë gjithashtu mbledhjen e informacionit edhe për familjet e larguara tërësisht në flukset migratore, ofroi një informacion krejt të ri për përbërjen e tyre. Më tej, kjo çoi në identifikimin dhe matjen e llojeve të familjeve bazuar në profilet e migracionit. Ky studim është i një natyre eksperimentale. Censi i ardhshëm i popullsisë dhe banesave mund të konfirmojë apo të vendosë në pikëpyetje cilësinë e statistikave aktuale. Në Shqipëri duhen zhvilluar anketa periodike për migracionin në familje. Në të ardhmen, mund të merret në konsideratë një periodicitet 5-vjeçar midis raundeve të anketave të AMF-ve, duke konsideruar një periudhë 10-vjeçare si referencë, domethënë, AMF 2024 të zhvillohet në

1 Megjithatë, nuk duhet bërë balancimi i drejtpërdrejtë për emigrantët dhe imigrantët, për shkak të retrospektivave të ndryshme të përdorura për këto dy flukse. Në botimet e ardhshme të kësaj ankete rekomandohet të korrigjohet përkufizimi.

2 Ky grup, po ashtu, përfshin kategorinë që ka lënë biznesin e vet.

periudhën 2015-2024 dhe, më pas, në vitin 2029 për periudhën 2019-2029. Gjithashtu, duhen marrë në konsideratë disa korrigjime të shtresës përcaktuese, sidomos, lidhur me flukset imigratore, për të përjashtuar personat që janë kthyer më përpara sesa 10 vitet e fundit.

Hyrje

Për ta menaxhuar migracionin me efektivitet, politikëbërësit dhe ata që janë përgjegjës për zbatimin duhet të kenë qasje në të dhëna të besueshme dhe në kohë. INSTAT-i në Shqipëri ka vite që punon për përmirësimin e cilësisë së të dhënave demografike, në përgjithësi dhe të dhënave të migracionit, në veçanti. Strategjia për Migracionin e miratuar në vitin 2019 ka identifikuar sfidat me të cilat përballemi në këtë fushë, si mungesa e mbledhjes së standardizuar të të dhënave administrative dhe studimet e pamjaftueshme.

Kjo Anketë e Migracionit Familjar synon ta zvogëlojë këtë hendek, duke kontribuar në mbledhjen e të dhënave të besueshme për përcaktuesit dhe ndikimin e migracionit në Shqipëri, si dhe për shtimin e njohurive dhe ekspertizës së INSTAT-it me qëllim kryerjen sistematike të AMF-së.

Statistikat për migracionin janë të rëndësishme:

- (i) për të siguruar vlerësime të besueshme dhe të sakta të popullsisë,
- (ii) për të krijuar profile migracioni me qëllim hartimin e programeve të përshtatura për të kthyerit,
- (iii) për të vlerësuar numrin e saktë të banorëve dhe forcës së punës në shkallë rajonale e lokale.

Të dhënat e anketës do të kontribuojnë për të përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme mënyrat me të cilat menaxhohen e trajtohen një gamë çështjesh sociale nga politikëbërësit, njësitë administrative vendore e qendrore dhe shërbejnë si burim i vlefshëm informacioni për studiuesit dhe akademikët.

I. Karakteristikat dhe organizimi i anketës së migracionit në familje

1.1 Qëllimi i anketës

Instituti shqiptar i statistikave përgatit vlerësime vjetore të popullsisë, duke marrë parasysh ngjarjet jetësore (rritja natyrore e popullsisë) dhe flukset migratore. Shifrat me cilësinë më të mirë për popullsinë përfitohen nga censet. Censi i fundit i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri u zhvillua në vitin 2011. Në periudhën që nuk përfshihet në vitet e censit, përllogaritjet do të bëhen në varësi të nevojave të vendit për informacion. Për rrjedhojë, kryhen matje vjetore të flukseve që regjistrojnë ndryshimet që vijnë si rezultat i proceseve të lindjeve dhe vdekjeve dhe lëvizjeve migratore. Sfida më e madhe për vlerësimet vjetore të popullsisë është matja e flukseve migratore ndërkombëtare.

Që prej vitit 2014, në përputhje me rekomandimet e Eurostat-it, Instituti shqiptar i statistikave (INSTAT) ka vendosur të përfshijë modulën e ri të migracionit në pyetësonin e Anketës së Forcës së Punës (AFP). Të dhënat e përfuara janë përdorur për të përllogaritur popullsinë më 1 janar të çdo viti. Migracioni dhe rritja natyrore janë dy komponentët e rritjes së popullsisë dhe lidhjet logjike midis këtyre dy aspekteve të ndryshimeve demografike paraqiten në një ekuacion. Ekuacioni në fjalë që përdoret për vlerësimet aktuale të popullsisë shpreh në mënyra të thjeshtuara sesi ndryshon me kohën çdo popullsi. Kjo mund të shprehet si vijon:

$$P_{t_2} = P_{t_1} + B_{t_2/t_1} - D_{t_2/t_1} + I_{t_2/t_1} + E_{t_2/t_1}$$

ku P_1 dhe P_2 përfaqëson popullsinë në dy data të ndryshme, t_1 , t_2 dhe B , D , I dhe E përfaqësojnë përkatësisht lindjet, vdekjet, imigrantët (ose migrantët e brendshëm në statistikën rajonale) dhe emigrantët (ose migrantët e jashtëm) midis këtyre dy datave. Kjo mund të rishprehet në termat e rritjes natyrore, $NI_{t_2/t_1} = B_{t_2/t_1} - D_{t_2/t_1}$, dhe migracionit neto, $MI_{t_2/t_1} = I_{t_2/t_1} - E_{t_2/t_1}$. Vlerësimet e migracionit neto mund të bëhen drejtpërdrejt nga krahasimi i flukseve bruto brenda dhe jashtë një zone apo tërthorazi, duke krahasuar popullsinë në dy pika. Në mënyrë që vlerësimet e mëposhtme të jenë të qarta, duhen dalluar konceptet në vijim³:

migracioni neto – diferenca midis numrit të personave/banorëve që lëvizin drejt një zone specifike dhe numrit të atyre që largohen. Nga ana tjetër, migracioni neto i referohet balancës MI_{t_2/t_1} të lëvizjeve (flukseve) drejt një territori të dhënë ose prej tij midis dy datave, t_1 , t_2 ;

fluksi migrator bruto – numri i përgjithshëm i lëvizjeve migratore drejt një territori të dhënë ose prej tij midis dy datave, t_1 , t_2 . Përveçse kur t_1 dhe t_2 përfaqësojnë fillimin e viteve të njëpasnjëshme, fluksi bruto mund të përfshijë largime dhe kthime të shumëfishta nga i njëjti person;

fluksi migrator neto – numri efektiv i lëvizjeve migratore drejt një territori të dhënë ose prej tij midis dy datave t_1 , t_2 . Veçanërisht, për matjen e t_1 dhe t_2 , kur nuk janë fillimet e viteve të njëpasnjëshme, fluksi neto përfitohet nga krahasimi i situatave të popullsisë në momentet t_1 dhe t_2 dhe nuk përfshin largimet dhe kthimet e shumëfishta të të njëjtit person.

Për përllogaritjet e migracionit neto MI_{t_2/t_1} janë përdorur të dhënat nga Anketa e Forcës së Punës. Një përllogaritje ndihmëse bëhet edhe duke përcaktuar flukset migratore midis t_1 dhe t_2 si fillimet e viteve të njëpasnjëshme. Mbi baza vjetore, me qëllim përkufizimin e popullsisë përmes konceptit të rezidentëve, këto flukse migratore të matura nga AFP-ja

3 Në këtë pikë, duhet theksuar se po diskutojmë rastin e Shqipërisë, e cila e përkufizon popullsinë përmes 'popullsisë me vendbanim të zakonshëm'. Çdo ndryshim i përkufizimit kombëtar apo i rekomandimeve ndërkombëtare për përkufizimin e qëndrimit të një banori do të sillte si rezultat ndryshime në këto dallime. Përkufizimet e popullsisë që përdoren në vendet evropiane përshkruhen më gjerësisht në "Demographic statistics: definitions and method of collection in 44 European countries," Eurostat 2015, (DOI): 10.2785/717072.

trajtohen si njësi matëse e flukseve migratore⁴. Megjithatë, shuma e flukseve të përfuara përgjatë disa viteve (midis t_1 dhe t_n) nuk do të jetë e barabartë me flukset neto gjatë asaj periudhe, por me flukset bruto.

Këto anketa mund të përsëriten kur të ri-intervistohen persona të ngjashëm, për të prodhuar treguesit e prirjes në kohë. Në çdo raund të anketës së AFP-së, të gjitha intervistat janë vetëm një pjesë e vogël e popullsisë së përgjithshme për të cilën kërkohen të dhënat⁵. Detyra e lidhjes së gjetjeve të anketës me popullsinë e gjerë është komplekse dhe bart rrezikun e gabimit në përzgjedhjen rastësore të njërive. Shkalla e gabimit në kushtet e dhëna është e minimizuar. Edhe pse cilësia e të dhënave të grumbulluara është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe fusha e tyre është zgjeruar, pasojat që lidhen me madhësinë e kampionit të AFP-së ishin të pashmangshme.

Anketat demografike janë të larmishme në formë e qëllim. Mjaft shpesh, përdoret një lloj i ndryshëm ankete, që është anketa me një raund të vetëm, e cila përfshin vetëm një intervistë me të intervistuarit. Ky format lejon përdorimin e kampionëve më të mëdhenj dhe është i përshtatshëm për t'u përdorur sidomos kur popullsia ka lëvizshmëri të madhe. Si rezultat, INSTAT-i, në bashkëpunim me IOM-in, përgatiti një anketë të zgjeruar të migracionit familjar, gjetjet e së cilës tregojnë ndryshimet që kanë ndodhur në shoqërinë shqiptare gjatë viteve të fundit. Kjo anketë që është ekskluzive për migracionin përbën një zhvillim të rëndësishëm për përmirësimin e statistikave publike në Shqipëri në përgjithësi dhe statistikave të popullsisë e migracionit, në veçanti.

Për rrjedhojë, Anketa e Migracionit Familjar i kushtohet mbledhjes së të dhënave të migracionit që janë kaq të nevojshme për shoqërinë shqiptare. Rezultatet e anketës janë të përqendruara te tiparet kryesore demografike të NjEF-ve dhe popullsisë që kanë ndryshuar vendbanimit krahasuar e vitin 2011 kur është zhvilluar Censi i fundit i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri⁶.

AMF 2019 ishte një anketë e re e paplanifikuar në Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare, 2017-2021.⁷

Anketa u krye në kuadrin e Programit Global "Migracion për Zhvillim", i financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe implementuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin.

Objekti i projektit ishte të kontribuonte në përmirësimin e të dhënave të migracionit në Shqipëri, që mund të përdoren për hartimin e zbatimit e politikave mbështetur në fakte e të dhëna. Duke e arritur këtë, projekti kontribuoi për plotësimin e një hendeku serioz në disponibilitetin e të dhënave mbi migracionin ndërkombëtar dhe lëvizshmërinë brenda vendit. Ministri të ndryshme, organizata qeveritare, partnerë për zhvillim, organizata rajonale e ndërkombëtare dhe vendet e destinacionit për migrantët shqiptarë do të kenë një instrument thelbësor për të hartuar, zbatuar, monitoruar e vlerësuar politikat dhe programet e migracionit, si dhe për të shqyrtuar skemat e riintegritimit për migrantët e kthyer sipas modaliteteve të ndryshme operative.

Për të theksuar këtë aspekt të studimit, duhet identifikuar qartë tipari i dallueshëm i këtyre të dhënave. Vlerësimet e kryera ilustronë flukset e popullsisë në periudhën 2011-2019. Sipas përkufizimit, flukset migratore vjetore t_2/t_1 që maten nga AFP-ja mund të dallohen nga the shuma e krijuar për disa vjet t_n/t_1 nga flukset vjetore mbi bazë e serive kohore nga AFP, të cilat janë flukset bruto dhe nga flukset migratore neto për t_n/t_1 që e kanë zanafillën prej AMF-së. Një nivel i dhënë i migracionit neto mund të vijë si rezultat i një larmie të madhe kombinimesh brenda ose jashtë territorit; kështu, nuk ekziston një raport i thjeshtë midis të dyjave.

Për pasojë, në dritën e të gjitha konsideratave të mësipërme, është me rëndësi të theksohet se, për herë të parë, kjo anketë ka prodhuar:

- analizën e flukseve migratore neto për periudhën 2011-2019
- statistika mbi ndryshimin e vendbanimit të familjeve

Kështu, kjo anketë duhet konsideruar eksperimentale e duhet përmirësuar në vitet në vijim.

Anketa u hartua, nga njëra anë, për të regjistruar përmasat e lëvizjes së njerëzve dhe, nga ana tjetër, për të pasur një karakterizim më të hollësishëm të tri llojeve të migracionit. Kjo u bë mbështetur në intervistat e zgjeruara, që u kryen duke përdorur një pyetësor të konsoliduar, i hartuar për të marrë informacion mbi:

4 Në rastin e serive vjetore kohore dhe kushtit vjetor (12-mujor) të përdorur për përkufizimin e rezidentit, flukset neto dhe bruto mund të jenë identike. Megjithatë, metodika e AFP-së, sipas së cilës merren parasysh mesataret tremujore, i bën të paqartë kufijtë në shtresën përkufizuese.

5 Studimi për AFP-në zhvillohet në shumicën e vendeve evropiane. Në të gjitha rastet, ato janë përgatitur në bazën e një kampioni rastësor.

6 www.instat.gov.al/media/3058/main_results_population_and_housing_census_2011.pdf.

7 Shih www.instat.gov.al/media/3594/psz-2017-2021.pdf për Programin e plotë Kombëtar 2017-2021.

1. emigrantët – qytetarët shqiptarë që janë larguar nga vendi;
2. migrantët e kthyer (të kthyerit) – qytetarët shqiptarë që u kthyen në Shqipëri;
3. migrantët e brendshëm – personat që lëvizin brenda vendit.⁸

1.2 Objekti i anketës

Kampioni i popullsisë për AMF 2019 përbëhej nga familjet të identifikuara në censin e vitit 2011.


Në studimet statistikore mbi migracionin, shpesh, neglizhohen aspektet e dinamikave të popullsisë. Rezultoni se përmasa kohore është tejet e rëndësishme kur përcaktohet kampioni i popullsisë. Duke supozuar se ka dy pika të rëndësishme në kohë për anketën, momenti i censit të vitit 2011 dhe momenti i intervistës në vitin 2019, në popullsi mund të dallohen:

- a) elementet e qëndrueshme,
- b) të larguarit,
- c) personat që hyjnë,
- d) elemente të përziera.

Ky dallim bëhet i vlefshëm edhe sepse objekti i testimit është kompleks (njësia ekonomike familjare).

Le të marrim në konsideratë popullatën e anëtarëve të familjes të paraqitur në diagramin e mëposhtëm. Krahasimi i listës së anëtarëve të familjeve në 2011 dhe 2019, kombinuar me një intervistë të hollësishme lidhur me shkaqet e mundshme të mungesës së një personi, mund të jetë baza për të dalë në konkluzione lidhur me flukset migratore të individëve ose familjeve.

Figura 1: Profili i emigracionit të anëtarëve të familjes 2011-2019



Rasti 1 dhe 2: anëtarët e pranishëm të familjes në censin e vitit 2011 dhe AMF 2019 (elementet e qëndrueshme)

Krahasimi i listës së anëtarëve të familjeve në 2011 dhe 2019 mund të jetë bazë për nxjerrjen e përfundimeve lidhur me lëvizjet migratore. Duhet theksuar se ne nuk e njohim historikun e tyre të migracionit. Nuk jemi të sigurt nëse ndonjë nga anëtarët është larguar pas vitit 2011 dhe, më pas, është kthyer përpara vitit 2019.

Nga këndvështrimi i **fluksit migrator neto në periudhën 2011-2019** ky është një faktor i papërfillshëm.

8 Shih "Fjalorthin e migracionit" të IOM-it për një përkufizim më të hollësishëm të termin: https://publications.iom.int/system/files/pdf/iml_34_glossary.pdf.

Rasti 3: anëtarët e familjes të pranishëm në censin e vitit 2011 dhe që nuk janë të pranishëm në AMF 2019 (të larguarit)

Në varësi të destinacionit të migracionit, ky do të jetë një rast i regjistruar emigracioni ose migracioni të brendshëm (flukse jashtë një zone/bashkie). Në studimet e kryera deri tani nga INSTAT-i, ka qenë problem përfshirja e familjeve që janë larguar tërësisht nga vendbanimi i tyre.

Mungesa e të gjithë anëtarëve të familjes nënkupton se e gjithë familja ka migruar ose nuk është më (pasi të gjithë anëtarët e saj kanë vdekur). Pyetësi i mirëpërgatitur i AMF 2019 bëri të mundur përfshirjen si risi të këtyre zërave në kampionin e popullsisë. Intervistat e kryera me fqinjët e afërt të familjeve përkatëse të përzgjedhura në mënyrë rastësore mundësuan marrjen e informacionit rreth arsyes së mungesës së anëtarëve të familjes.

Rasti 4: anëtarët e familjes që nuk kanë qenë të pranishëm në censin e vitit 2011 dhe janë të pranishëm në AMF 2019 (personat që hyjnë)

Në varësi të destinacionit të migracionit, ky do të regjistrohet si rast imigracioni ose migracioni të brendshëm (fluks drejt një zone/bashkie).

Për shkak të nivelit të ulët të imigracionit afatgjatë drejt Shqipërisë (shtetas joshqiptarë që vijnë në Shqipëri për më shumë se 12 muaj), instrumenti kërkimor (pyetësi) përfshin një modul të gjerë që u kushtohet vetëm shqiptarëve që kthehen në vend, duke qenë se këta të kthyer duhet të numërohen jashtë fluksit kryesor të imigracionit. Për qëllime të kësaj ankete, imigracioni, në kuptimin më të gjerë, i referohet shumës së flukseve hyrëse të shtetasve joshqiptarë dhe të kthyerve⁹.

Duhet marrë në konsideratë rastet kur të gjithë anëtarët e familjes të cilët nuk ishin të pranishëm në censin e vitit 2011 dhe janë të pranishëm në AMF 2019. Ky ishte rasti i anëtarëve të familjes që kishin lëvizur nga jashtë ose nga një vend tjetër brenda vendit.

Familjet që vijnë nga jashtë nuk mund të mbulohen nga ky kampion popullsie. Kështu, AMF-ja nuk mund të ofrojë të dhëna për këtë rast.

E njëjta gjë vlen për familjet që kanë migruar tërësisht që nuk u përfshinë në kornizën e kampionit. Kjo mund të vlejë edhe për familjet të reja që janë ndarë nga ato ekzistuese.

Për shkak të përkufizimit të miratuar për një person që mungon në vitin 2011 dhe të pranishëm në 2019, duhet theksuar se imigracioni aktual mund të ketë ndodhur përpara vitit 2011. Për rrjedhojë, fluksi i paraqitur i migracionit nuk është i regjistruar në statistikën aktuale vjetore 2011-2019.

Rasti 5: anëtarët e familjes jo të pranishëm në Shqipëri në 2011, të cilët kanë lindur/janë vendosur pas vitit 2011 dhe kanë emigruar sërish përpara vitit 2019, që kanë munguar në AMF 2019 (elemente të përziera).

Kjo është një situatë e mundshme regjistrimi në rastin e një ankete të familjeve. Megjithatë, në anketat për migracionin neto në periudhën 2011-2019, duket se këta persona do të ishin regjistruar.

Nga ana tjetër, rastet kur familja e gjithë nuk ishte e pranishme në vitin dhe, për pasojë, nuk u përfshi në kampionin e censit nuk mundën të regjistroheshin. Këto raste mbetën jashtë objektit të AMF 2019.

Rasti 6: anëtarët e familjes që nuk ishin të pranishëm në 2011 (emigrantët), të cilët u kthyen pas AMF 2019 (elemente të përziera), njësoj si në rastin 5.

Për aq kohë sa kryefamiljari ka jetuar në një adresë në 2011, është e mundur që të regjistrohen ndryshimet në përbërjen dhe numrin e anëtarëve të familjes. Sidoqoftë, ishte e pamundur që këta anëtarë të familjes të përmendeshin nga kryefamiljari gjatë intervistës së drejtpërdrejtë. Nga ana tjetër, për rastet kur e gjithë familja nuk ishte e pranishme në vitin 2011, ata nuk janë regjistruar.

9 Të dhënat e vlefshme në Regjistrin Elektronik të të Huajve, që është pjesë e Sistemit të Menaxhimit Total të Informacionit në dispozicion të Policisë së Shtetit janë një alternativë e sigurt për matjen e imigrantëve. Një përgatitje e përshtatshme e kësaj baze të dhënash në të ardhmen mund të prodhojë flukse neto dhe bruto në periudhat t_0/t_1 .

Në përmblyllje të analizës së rasteve, popullsia e synuar për AMF 2019 ishin të gjithë personat që u përkisnin familjeve kryefamiljarët e të cilave ishin të pranishëm në vend në vitin 2011, si banorë të zakonshëm. Objektivi kryesor i AMF-së matja e shumanshme fluksit migrator 2011-2019; lëvizjet migratore u regjistruan kur NjEF-të e përfaqësuara nga kryefamiljari ishin të pranishme në vitin 2011.

Për shkak të strukturës së kampionit, u regjistruan vetëm ato ngjarje që kanë nisur në një adresë të zgjedhur rastësisht. Të dhënat për flukset e popullsisë që lëvizin në njësitë territoriale me të gjithë familjen mund të përdoren në shkallë të kufizuar. Tabela 1 paraqet një përmbledhje të vlerësimeve lidhur me objektin e AMF-së.

Tabela 1: Dinamika migratore e vrojtuar në kuadër të AMF 2019

Objekti i regjistruar	Anëtarët e familjes ku kryefamiljari ishte		Mungon nga censi 2011 I pranishëm në adresën e dhënë në 2019
	I pranishëm në Censin 2011 si banor i zakonshëm në adresën e caktuar	ngjarjet e vrojtura përfshijnë të gjithë anëtarët e NjEF-së (të pranishëm në 2011)	
Fluksi hyrës nga jashtë	Individë imigrantë personat e intervistuar të NjEF-së së qëndrueshme		NjEF imigrante të paregjistruar
Fluks dalës jashtë vendit	Individë emigrantë personat e intervistuar të NjEF-së së qëndrueshme	NjEF emigrante të regjistruara	
Fluks hyrës nga një bashki tjetër brenda Shqipërisë	Persona që lëvizin brenda vendit në vendbanimin në adresën e vitit 2019 personat e intervistuar të NjEF-së së qëndrueshme		NjEF që hyjnë/lëvizin brenda vendit Të regjistruar por si statistikë pasqyrë
Fluks dalës drejt një bashkie tjetër brenda Shqipërisë	Personat që lëvizin brenda vendit nga vendbanimi në adresën e vitit 2011 personat e intervistuar të NjEF-së së qëndrueshme	NjEF që largohen jashtë/lëvizin brenda vendit Të regjistruara	

Shënim: Të pranishëm në Censin 2011 nënkupton që adresa e vendbanimit ishte e njëjta më 30 shtator 2011 si dhe më 15 korrik 2019. Mungojnë nga Censi 2011 nënkupton mospërputhjen e këtyre adresave.

1.3 Përmbajtja e anketës

Anketa synon të vlerësojë të gjitha hyrjet përtej bashkive, duke regjistruar vendbanimin e mëparshëm dhe aktual të zakonshëm të të gjithë anëtarëve të familjes. Për këtë qëllim, u regjistruan më vete sa vijon:

migracioni i brendshëm – Lëvizja e personave brenda një vendi, që përfshin vendosjen në një vendbanimin të përkohshëm ose të përhershëm;

migracioni i brendshëm – Lëvizja e personave nga vendi i banimit të zakonshëm përtej kufirit ndërkombëtar drejt një vendi në të cilin nuk janë shtetas.

Lidhur me flukset e migracionit ndërkombëtar:

flukset dalëse të përbëra nga emigrantë të cilët kanë ndryshuar vendbanimin për një kohëzgjatje prej të paktën 12 muajsh (ose me qëllim për të qëndruar të paktën 12 muaj).

Rezultatet u përgatitën mbi bazën e 2 grupeve të të dhënave: një grup të dhënash mbi NjEF-të që janë larguar në tërësi nga Shqipëria dhe një grup të dhënash individuale për anëtarët e NjEF-ve, një pjesë e të cilëve ka mbetur në vend dhe një pjesë tjetër është larguar jashtë;

flukset hyrëse të përbëra prej të kthyerve (shtetas shqiptarë që kthehen në vendin e tyre të origjinës ose vendbanimit të zakonshëm, zakonisht pasi kanë qëndruar të paktën një vit në një vend tjetër) dhe imigrantët (joshqiptarë).

Anketa shqyrtoi si të kthyerit, ashtu edhe imigrantët, në kuptimin më të ngushtë, por numri i këtyre të fundit ishte i papërfillshëm. Rezultatet për këtë rubrikë mbështeten vetëm te njëri prej grupeve të të dhënave, ai individual i anëtarëve që janë bashkuar me NjEF-në ekzistuese në vitin 2011.

Duke qenë studim i ri e jostandard, AMF-ja shfaqti disa mangësi. Hartimi i kornizës së mostrës së popullsisë dhe hipoteza e gjurmimit të kryefamiljarit banor i zakonshëm nuk lejoi regjistrimin e familjeve të zhvendosura brenda Shqipërisë që kanë krijuar NjEF të reja. Kjo është shpjeguar në mënyrë më të plotë në Tabelën 1 dhe Rubrikën 1.2, që përmban përshkrimin e popullatës që është përfshirë.

Për rrjedhojë, nuk qe e mundur që të bëhej një krahasim midis familjeve që largohen dhe mbërrijnë në Shqipëri. Siç shpjegohet në përshkrimin e objektit të anketës, rezultati i vlerësimeve është përlogaritja e fluksit migrator neto; megjithatë, ai ndryshon nga koncepti i migracionit neto që përdoret zakonisht. Diferenca midis numrit të personave që lëvizin drejt një zone specifike dhe numrit të atyre që largohen njihet si migracion neto; kur studiohen lëvizjet ndërkombëtare, kjo është diferenca midis imigracionit dhe emigracionit. Na duhet të theksojmë qartë se mungesa e mbulimit të disa rasteve nga kjo anketë sjell si rezultat pamundësinë e prodhimit të statistikave të migracionit.

1.4 Organizimi i anketës

AMF 2019 ishte anketë vullnetare. Në shumicën e rasteve, kjo lloj ankete, sidomos mes njësive private ekonomike familjare, rezultoi me një normë përgjigjeje prej 30 për qind. Shqipëria është në një situatë përjashtimore; shkalla e përgjigjes së AMF 2019 ishte 79 për qind¹⁰.

AMF-ja u krye një herë dhe mbi baza të përkohshme. Për momentin, nuk ka asnjë plan për një anketë tjetër. AMF-ja përdori metodën CAPI (Intervista personale përmes kompjuterit). Pyetësi u përgatit nga INSTAT-i, me këshillimin e ekspertës ndërkombëtare që mbështeti INSTAT-in për statistikën e migracionit, e angazhuar nga IOM-i në kuadrin e këtij projekti. Për rishikimin e pyetësorit u ofrua mbështetje shtesë nga Zyra Rajonale e IOM-it në Vjenë dhe Zyra Qendrore e IOM-it në Gjenevë.

Pyetësi përbëhej prej tri pjesësh kryesore:

1. Informacion i përgjithshëm
2. Informacion për njësinë ekonomike familjare
3. Pyetje për migracionin
 - a. Tiparet demografike të anëtarëve të NjEF-së
 - b. Migracioni i brendshëm
 - c. Të kthyerit
 - d. Emigracioni

Puna në terren u zhvillua nga 17 prilli deri më 15 korrik 2019. AMF-ja 2019 mori si hipotezë se pyetjet do të përgjigjen drejtpërdrejt nga kryefamiljari. Megjithatë, u lejua që ajo të pranonte mundësinë e përgjigjes edhe nga një tjetër anëtar i familjes që e njihnte situatën e anëtarëve të tyre në mungesë të kryefamiljarit.

Një përjashtim ishte që AMF-ja lejoi edhe mundësinë e përgjigjeve të reduktuara nga persona që banonin në afërsi me familjet në mungesë të të gjithë anëtarëve të tyre. Nga njëra anë, kjo zgjidhje është si kundërveprim për të mos pasur ulje të shkallës së përgjigjeve në anketë, por, nga ana tjetër, kjo mund të ketë efekt negativ në cilësinë e përgjigjes në rastin e disa variableve (këta persona ishin përgjithësisht në vendndodhjet e personave që mungonin, por kishin njohuri të paplota kur vinte fjala për pyetje më të hollësishme, për shembull, e kishin të vështirë t'u përgjigjesin pyetjeve për aktivitetin kryesor të punësimit). Avantazhi kryesor i kësaj zgjidhjeje është që të ulë mundësinë që të mos mbulohet popullsia.

10 Kjo është e krahasueshme me nivelin e arritur në disa vende evropiane në anketat e detyrueshme të biznesit. Natyrisht, shpërndarja e shkallës së përgjigjes është shumë ndryshe në prefekturat individuale; në Tiranë, ku është numri më i madh i NjEF-ve me një anëtar, situata është më pak e favorshme (67 %). Megjithatë, në disa prefektura, u raportua më shumë sesa 90 për qind e përgjigjeve nga NjEF-të e përzgjedhura.

Të dhënat e mbledhura u kontrolluan vazhdimisht nga koordinatorët, përfshi edhe nëse informacioni ishte i saktë, ishte i regjistruar në instrumentin e mbledhjes së të dhënave dhe ishte i plotë. Analiza e llogaritjes së tabelave të kontrollit u krye në bazë të të dhënave jo-përgjithësuese. Falë tabelave të kontrollit, u mundësua një kontroll logjik. Madhësia e kampionit të arritur (numri i vrojtuar i njësive të kampionit për familjet dhe individët që pranuan një intervistë) është 19 821 për NjEF-të dhe 71 538 për individët.

U hartuan koeficientët e nevojshëm për përgjithësimin e rezultateve të AMF-së për popullsinë. Kalibrimi me përdorimin e të dhënave administrative nuk ishte i mundur, për shkak të mungesës së mbulimit të plotë, siç trajtohet në Rubrikën 1.1.

2. Metodologjia e anketës së migracionit familjar

2.1 Plani i zgjedhjes së kampionit

AMF-ja 2019 u zhvillua përmes zgjedhjes së kampionit dhe si njësi u përdorën familjet. Nga korniza e kampionit u përzgjedhën rastësisht 2 000 Zona Numërimi, me një shtresëzim të nënkuptuar (zona urbane/rurale). Përzgjedhja e kampionit u bë në dy faza, që u ndoqën nga hapi tjetër në të cilin u përzgjedhën rastësisht 10 adresa nga secila zonë numërimi. Për secilën zonë numërimi u siguruan nga gjashtë adresa shtesë për rezervë. Kampioni ishte planifikuar për 20 000 familje (madhësia aktuale e kampionit e përbërë prej njësive të përzgjedhura). Madhësia e kampionit u përcaktua që të siguronte saktësi të mjaftueshme të rezultateve në nivel kombëtar dhe prefekturë (NUTS 3).

Anketa u zhvillua duke përdorur një metodë përfaqësuese mbi një kampion rastësor që mundësoi rezultatin e anketës për popullsinë e përgjithshme. Periudha e referencës që u vendos për AMF-në ishte i gjithë harku nga viti 2011 (nga momenti i censit) deri në vitin 2019. Periudha nëntëvjeçare e referencës lidhet me shumicën e variableve të përfuara në kontekstin e migracionit, ndërkohë që disa prej variableve lidhen me situatën aktuale, si shtetësia, niveli arsimor, statusi i punësimit etj.

Korniza e kampionit

Korniza e kampionit bazohet në listën e Zonave të Numërimit në nivel ndërtësash (njësi banimit), e ngritur mbi rezultatet e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2011, të përditësuara në vitet në vijim, mbi bazën e anketave aktuale të statistikave zyrtare. Për përzgjedhjen e banesave për anketën u përdor një model i shtresëzuar në dy faza. Njësitë Primare të Zgjedhjes (PSU) të nxjerra në fazën e parë janë zonat e numërimit që ishin zona të vogla operative të përcaktuara në harta për numërimin e censit të vitit 2011. Në listën e kampionit përfundimtar, Shqipëria kishte gjithsej 11 698 zona numërimi.

Faza e dytë e përzgjedhjes përfshin familjet e renditura nga zonat e numërimit të përzgjedhura. U përzgjedhën 10 familje për PSU, përfshi 6 rezervë. Procedura e përdorur është një përzgjedhje sistematike e 16 familjeve të para dhe, më tej, 6 brenda 16 përsëri. Kështu, përgjigjet e synuara nga PSU-të ishin 10. Rezervat përdoren sipas radhës.

Shtresëzimi i kornizës së kampionit të AMF-së

Shtresat e bashkive nuk ishin domeni i vlerësimeve, por vetëm shtresa kampionimi për të përmirësuar efektivitetin e dizajnimit të kampionit. Për këtë arsye, shtresat e kampionit ishin 61 bashkitë. E vetmja kërkesë ishte që të përzgjidheshin një minimum prej pesë PSU-sh brenda secilës shtresë.

Duke qenë se zona e numërimit e kampionit u zgjedhën sistematikisht (me probabilitet në raport të drejtë me madhësinë në fazën e parë të përzgjedhjes së kampionit, kjo do të ketë shtresëzim gjeografik të nënkuptuar (së pari, urban/rural), që do të reflektojnë gjithashtu disa prej shpërndarjeve socio-ekonomike të popullsisë. Zonat e numërimit në kornizën e kampionit brenda çdo shtrese të përzgjedhur u organizuan në rend gjeografik, me qëllim që të mund të siguronin shtresëzimin të nënkuptuar.

Procedurat e përzgjedhjes së kampionit për AMF-në

Procedurat e përzgjedhjes së kampionit për AMF 2019 u bazuan në një model kampioni të shtresëzuar me dy faza. Në fazën e parë PSU-të e kampionit zonat e numërimit janë përzgjedhur sistematikisht me PPS brenda çdo shtrese (bashkitë). Përpara fazës së parë të përzgjedhjes së kampionit, korniza e kampionit të zonave të numërimit brenda çdo shtrese ishte e organizuar gjeografikisht, për të siguruar shtresëzimin e nënkuptuar dhe për të përfutur një kampion përfaqësues brenda çdo prefekturë.

Në fazën e parë të përzgjedhjes së kampionit, mund të përdoren këto procedura për përzgjedhjen e kampionit të zonave të numërimit brenda çdo shtrese (prefekturë, urbane/rurale) sistematikisht me PPS:

1. Kumulimi i njësive matëse të madhësisë (numri i NjEF-ve) në listën e renditur të PSU-ve brenda shtresës Matja kumulative përfundimtare e madhësisë është numri i përgjithshëm i NjEF-ve në kampion për shtresën (M_h).
2. Për të përfutur intervalin e zgjedhjes së kampionit për shtresën h (l_h), pjesëtoni M_h me numrin e përgjithshëm të PSU-ve që do të përzgjidhen në shtresë h (n_h):

$$l_h = \frac{M_h}{n_h}$$

3. Përzgjidhni një numër rastësor (R_h) midis 0 dhe l_h . PSU-të e kampionit në shtresën h do të identifikohen përmes numrave vijues të përzgjedhur:

$$S_{hi} = R_h = [l_h \cdot (i - 1)],$$

të rrumbullakosur, ku $i = 1, 2, \dots, n_h$. PSU-ja i e përzgjedhur është ajo me njësinë matëse të kumuluar të madhësisë së është më afër S_{hi} e cila është më e madhe apo e barabartë me S_{hi} .

Në fazën e parë të hartimit të kampionit u përdor paketa kompjuterike statistikore, SAS, për të përzgjedhur zonat e numërimit e kampionit sistematikisht me PPS brenda çdo shtrese. Ky program prodhon një skedar që përfshin probabilitetin e fazës së parë të përzgjedhjes për çdo PSU.

Lista e NjEF-ve të numëruara të censit për çdo zonë numërimi të kampionit u përdor si kornizë për përzgjedhjen e 16 NjEF-ve në secilën zonë numërimi të kampionit, duke zbatuar përzgjedhjen sistematike rastësore të kampionit me probabilitet të barabartë. Në të njëjtën kohë, një kampion shtesë rastësor prej gjashtë NjEF-sh u përzgjedh brenda çdo 16 familjeve si zëvendësuese rastësore të atyre familjeve që nuk mund të intervistoheshin.

Megjithatë, edhe pse ishte planifikuar që të gjithë anëtarët e familjeve (të listuara paraprakisht nga censi 2011) të përfshiheshin në bazën përfundimtare të të dhënave, ashtu si edhe anëtarët e NjEF-ve të reja, gjatë verifikimit të të dhënave mikro u deshën korrigjime të mëtejshme. Mangësitë e pjesshme në të dhëna u eliminuan përmes kontrollit logjik dhe të vlerave. Në ato raste kur duheshin plotësuar të dhënat që mungonin, u rekomandua imputimi. Teknika më e përshtatshme në këtë rast ishte përsëritja e rasteve të përzgjedhura në mënyrë rastësore nga të dhënat e njohura në të njëjtën shtresë.

2.2 Grupet e të dhënave

Rezultatet e AMF-së 2019 përbëhen nga dy baza të dhënash që përmbajnë:

1. informacion mbi familjet;
2. informacion mbi individët, që përbëhet nga të dhëna demografike e sociale nga pyetësori.

Struktura e të dy bazave të të dhënave përbëhet kryesisht nga pyetjet/ndryshimet e përfshira në formë të ndryshme. Përveç kësaj, këto baza të dhënash përmbajnë disa variabla teknike, identifikues që mundësojnë lidhjen e informacionit të grumbulluar rreth një personi të dhënë brenda këtyre dy formateve dhe informacionit shtesë rreth variabla që rrjedhin prej tyre, që janë përdorur për të përpunuar informacionin që vjen si rezultat (p.sh. peshat që u caktohen personave individualisht).

2.3 Përgjithësimi i rezultateve

Metoda e vlerësimit e AMF-së përdor përlogaritjen e faktorëve të përshtatshëm përgjithësues (peshat) dhe u zhvillua në tri faza.

Në fazën e parë, u llogaritën peshat primare (fillestare), të cilat janë ndryshime të probabilitetit të zgjedhjes së kampionit të NJEF-së individuale (dhe në këtë moment kompensohet ndërtimi shpërpjesëtimor i kampionit).

Më pas, përlogariten të ashtuquajturit koeficientë të përgjigjes (faktorët R).

Ato përlogariten sipas formulës $I_h = \frac{M_h}{n_h}$, ku K-ja është vlera e (sipas peshave fillestare) e numrit të familjeve që kualifikohen për në anketë dhe N është vlera e numrit të familjeve që kualifikohen për të marrë pjesë në anketë, por nuk lejojnë që të vrojtohen për çfarëdo arsye. Koeficientët e përgjigjes janë përcaktuar për secilën prej 61 bashkive në dy grupe që dallohen sipas zonës urbane/rurale. Në hapin e dytë, janë përlogaritur peshat dytësore duke pjesëtuar peshat fillestare me R, ku faktori R varet nga bashkia dhe pesha në të cilën është vendosur banesa (rurale apo urbane).

Në hapin e tretë, zakonisht, përlogariten peshat përfundimtare për të dhënat e individëve. Këto përlogaritje kryhen në mënyrë të tillë që t'ua përshtatin rezultatet e anketës vlerave demografike aktuale. Kjo bëhet nëpërmjet kalibrimin, që aplikohet te shtresat, seksi dhe grupmoshat e përcaktuara. Peshat përfundimtare përftohen nga shumëzimi i peshave dytësore me faktorët përkatës kalibrues. Peshat përfundimtare për përgjithësimet e NJEF-ve përlogariten si vlera mesatare të peshave përfundimtare që u janë caktuar anëtarëve të familjes. Qasja novatore e AMF 2019 me intervistat e tërthorta me personat që janë më në afërsi të tyre e përjashton këtë korrigjim.

Në rastin e të dhënave të AFM-së, pas fazës së përgjithësimit rekomandohet të kontrollohet saktësia e tyre dhe të llogariten gabimet relative standarde - RSE (të njohura edhe koeficienti i variacionit - KV), dhe mbi bazën e tyre, të përcaktohen të ashtuquajturat intervale të besimit (IB), për shkak se jo të gjitha rezultatet mund të jenë të përshtatshme për një analizë të mëtejshme. Në situatën kur rezultati përbëhet nga pak vrojtime (pak të intervistuar e gjetën veten në kategorinë e analizuar), rezultatet mund të jenë të ngarkuara me një gabim të madh rastësor të kampionit, ndaj saktësia e tyre mund të jetë e ulët, kështu që përfundimet rreth shpërndarjes së një tipari të dhënë në popullsi nuk duhet të nxirren mbi bazën e tyre. Kjo ndodh shpesh kur llogariten rezultatet për ndarjet më të vogla territoriale ose për grupe njerëzish që përcaktohen duke përdorur karakteristika të shumëfishta.

3. Statistikat familjare – familjet që kanë ndryshuar vendbanimin që nga viti 2011


3.1 Emigracioni

Sipas të dhënave nga Censi Kombëtar i Popullsisë dhe Banesave,¹¹ më shumë se 85,4 për qind e personave nuk e kishin ndryshuar vendbanimin e tyre që nga 1 prilli 2001, kur u zhvillua censi i mëparshëm. Nga 1 prilli 2001, rreth 4 për qind e rezidentëve shqiptarë kishin qendruar jashtë për më shumë sesa 12 muaj në periudhën 2001-2011. Për rrjedhojë, ekipi studimor zhvilloi hipotezën se kishte norma të konsiderueshme të flukseve migratore dalëse të familjeve që kanë lëvizur në tërësi. Për ta verifikuar këtë hipotezë, në vitin 2019, u ndërmor një Anketë e Migracionit Familjar. Kështu u përftuan llogaritjet për numrin e familjeve që kanë të paktën një anëtar më pak për shkak të emigracionit. Në dritën e rezultateve të kësaj ankete përfaqësuese që u zhvillua në periudhën prill-qershor 2019 në Shqipëri është përgatitur një pasqyrë e ndryshimeve të popullsisë së NjEF-ve të përkufizuara si rezidente në 2011.

Nga të gjitha familjet e identifikuar në censin e vitit 2011, 77,9 për qind ose 583 811 familje nuk kanë asnjë anëtar që ka emigruar gjatë periudhës 2011-2019.


Një nga termat që përdoret përgjatë gjithë analizës është “profili i emigracionit”. Anketa e Migracionit Familjar bëri të mundur identifikimin e familjeve që kanë një pjesë apo të gjithë anëtarët jashtë vendit. Nga gjitha familjet e personave me qëndrim në Shqipëri të identifikuar në Censin e vitit 2011, në vitin 2019, 22,1 për qind (165 946) kishin të paktën një anëtar jashtë. Prej tyre, 29,8 për qind ishin familje plotësisht të emigruara, ndërsa pjesa tjetër, 70,2 për qind, ishin familje me emigracion të pjesshëm, më të paktën një (por jo të gjithë) anëtarët në emigracion.

Figura 2: Familjet që kanë emigruar tërësisht nga popullsia e vitit 2011




Lëvizja e familjeve tërësisht nga popullsia e vitit 2011 ka qenë proces i vazhdueshëm. Në kohën e AMF 2019, shifra e përgjithshme e familjeve që kishin emigruar tërësisht ishte rreth 6,6 për qind e NjEF-ve në 2011. Ky proces paraqitet në Figurën 2. Prej kësaj shifre prej 6,6 për qind të familjeve, shumica kanë lëvizur në Itali ose Greqi (shih Figurën 3). Emigracioni i familjeve në tërësi drejt të dyja vendeve është një proces në vazhdim. Përgjatë periudhës së vërtetimit, ky fluks përbën më shumë sesa 50 për qind të fluksit të përgjithshëm të lëvizjes së familjeve jashtë vendit.

Figura 3: Familjet që kanë emigruar në tërësi që nga viti 2011 sipas destinacionit



Shpërndarja hapësinore e përqindjes së familjeve me historik migrator që nga viti 2011 tregohet në Hartën 1 dhe Tabelën 2.

Harta 1: Familjet nga viti 2011 me anëtarë me vendbanimin jashtë vendit në 2019, sipas prefekturës



Kjo hartë është vetëm për qëllime ilustrimi. Kufijtë dhe emrat e treguar dhe përcaktimet e përdorura në këtë hartë nuk nënkuptojnë një miratim zyrtar ose pranim nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin.

Shënim: NjEF të emigruara pjesërisht nënkupton NjEF-të kur të paktën një, por jo të gjithë anëtarët kanë migruar nga Shqipëria.

Tabela 2: Struktura e familjeve shqiptare deri më 15 korrik 2019 sipas profilit të emigracionit dhe prefekturës

Prefektura e vendbanimit të NjeF-së në 2011	NjeF 2011	Familjet më 2019			
		Pa anëtarë të emigruar	Me anëtarë që janë më qëndrim jashtë vendit		
			gjithsej	të gjithë	disa anëtarë
PREFEKTURA=100					
Gjithsej në Shqipëri	100.0	77.9	22.1	6.6	15.5
Berat	100.0	75.5	24.5	4.6	19.9
Dibër	100.0	74.1	25.9	2.7	23.2
Durrës	100.0	73.7	26.3	7.2	19.0
Elbasan	100.0	77.4	22.6	5.6	16.9
Fier	100.0	71.5	28.5	5.1	23.4
Gjirokaštër	100.0	86.3	13.7	5.4	8.3
Korçë	100.0	85.7	14.3	5.7	8.6
Kukës	100.0	67.9	32.1	2.3	29.8
Lezhë	100.0	85.7	14.3	3.3	11.0
Shkodër	100.0	71.2	28.8	7.0	21.8
Tiranë	100.0	80.9	19.1	10.3	8.8
Vlorë	100.0	79.2	20.8	4.0	16.8
PROFILI I EMIGRACIONIT =100					
Gjithsej në Shqipëri	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
Berat	5.3	5.2	5.9	3.7	6.8
Dibër	4.1	3.9	4.8	1.6	6.1
Durrës	9.2	8.7	10.9	10.1	11.3
Elbasan	10.1	10.1	10.3	8.6	11.0
Fier	11.4	10.4	14.7	8.8	17.2
Gjirokaštër	2.9	3.3	1.8	2.4	1.6
Korçë	8.3	9.2	5.4	7.2	4.6
Kukës	2.4	2.1	3.4	0.8	4.5
Lezhë	4.5	4.9	2.9	2.2	3.2
Shkodër	7.5	6.9	9.8	7.9	10.6
Tiranë	27.2	28.2	23.4	42.3	15.4
Vlorë	7.1	7.2	6.6	4.3	7.6

Shënim: Me "qëndrim jashtë" nënkuptohet qëndrimi jashtë vendit për të paktën 12 muaj. U morën në konsideratë anëtarët e familjeve përfaqësuesi (kryefamiljari) i të cilave ishte i pranishëm në censin e vitit 2011, në mënyrë që të paraqitet vetëm emigracioni që nga 2011-ta.

Numri i familjeve që nuk kishin asnjë anëtar i cili jetonte jashtë Shqipërisë në 2019 e tejkaloi 80.0 për qind në katër prefektura, konkretisht, Korça, Lezha, Gjirokastra dhe Tirana.

Për prefekturat e lartpërmendura, familjet e emigruara pjesërisht përbënin 60,4 për qind në Gjirokastrë, 60,0 për qind Korçë dhe 77,1 për qind në Lezhë. Tirana nuk e ndjek prirjen kryesore të korrelacionit negativ; numri i familjeve të emigruara pjesërisht përbënin vetëm 46,2 për qind.

Supozohet se në disa prefektura, numri i familjet të migruara plotësisht është më i madh. Fillimisht, kjo u lidh me faktin që familjet më të vogla, përfshi ato me një person, ishin më të shpeshta. Vlerësimi i familjeve sipas madhësisë së tyre bëri të mundur verifikimin e këtij. Strukturat familjare sipas numrit të anëtarëve dhe profilit të emigracionit paraqiten të përmbledhura në Tabelën 3. Nga ana tjetër, hipoteza duhet vënë në pikëpyetje. Përqindja më e lartë e familjeve joemigruante ishin ato me një dhe dy anëtarë, me rreth 90 për qind në të dyja rastet.


Tabela 3: Struktura e familjeve shqiptare më 15 korrik 2019 sipas profilit të emigracionit dhe madhësisë së familjes

Madhësia e NjEF-së 2019	NjEF 2011	NjEF 2019			
		Asnjë migrant	Me anëtarë me vendbanimin jashtë		
			Gjithsej	të gjithë ^a	disa anëtarë
	in %				
KLASA E MADHËSISË =100					
Total	100.0	77.9	22.1	6.6	15.5
1 person	100.0	89.3	10.7	9.1	1.6
2	100.0	91.9	8.1	4.9	3.2
3	100.0	78.1	21.9	7.4	14.5
4	100.0	73.3	26.7	9.5	17.2
5	100.0	72.9	27.1	6.8	20.3
6 e më shumë persona	100.0	72.7	27.3	2.5	24.9

^aMadhësia e familjes në momentin largimit nga Shqipëria.

Shënim: Me "vendbanimin jashtë" do të thotë të qëndrosh jashtë së paku 12 muaj. U morën në konsideratë anëtarët e NjEF-së, përfaqësuesi i së cilës (kryefamiljari) ishte i pranishëm në censin e vitit 2011, në mënyrë që të paraqitet emigracioni që nga ky vit. Kur merret në konsideratë humbja e disa anëtarëve nga NjEF individuale, duhet pasur parasysh se këto janë NjEF-të që, në vitin 2019, kishin vetëm një anëtar; vitet e mëparshme, mund të ketë pasur më shumë njerëz që kanë jetuar bashkë.

Një aspekt i rëndësishëm i emigracionit të familjeve që janë larguar tërësisht është se mund të ulë mundësinë e kthimit në vend në të ardhmen. Prefektura e Tiranës mbizotërohej nga familjet e emigruara tërësisht krahasuar me familjet me emigrim të pjesshëm më shumë sesa prefekturat e tjera (shih Figurën 4).

Figura 4: Familjet që kanë emigruar tërësisht që prej vitit 2011 sipas prefekturës

3.2 Familjet me anëtarë të kthyer – fluksi hyrës i migracionit

Matja e fluksit hyrës merr në konsideratë numrin e personave që lëvizin në një vend të ndryshëm nga ai i vendbanimit të zakonshëm dhe që ngrenë vendbanimin e zakonshëm në një vend të ri. Nëse do të merrnim parasysh si tipar shtesë shtetësinë e imigrantëve, do të përftonim një ndarje të këtij fluksi në të kthyer (vendas) dhe persona me shtetësi tjetër që, në kuptimin e ngushtë, mund të përkufizohen si imigrantë. Analiza e mëposhtme do të përqendrohet te të dyja grupet.

Tabela 4 paraqet strukturën e familjeve me ose pa anëtarë që kthehen. Në shkallë vendi, që prej vitit 2011, 8,6 për qind e familjeve kanë pritur persona që kthehen apo vijnë nga jashtë vendit 2011. Në dy prefektura, shifrat e përfuara ishin kryesisht përjashtimore, konkretisht, në Dibër, me 18,4 për qind të familjeve dhe Berat, me 17,5 të familjeve nga viti 2011. Ndërkohë, statistikën për Tiranën dhe Shkodrën për familjet pritëse të imigrantëve duket se janë nën mesatare.

Tabela 4: Struktura e familjeve shqiptare më 15 korrik 2019 sipas numrit të anëtarëve që kanë qëndruar jashtë për më shumë se 12 muaj dhe sipas prefekturës

Prefektura e vendbanimit të familjes	NjEF 2011	NjEF 2019	
		asnjë imigrant	ish-anëtarë të familjes me qëndrim jashtë
		në %	
PREFEKTURA=100			
Gjithsej Shqipëria	100.0	91.4	8.6
Berat	100.0	82.5	17.5
Dibër	100.0	81.6	18.4
Durrës	100.0	90.8	9.2
Elbasan	100.0	89.6	10.4
Fier	100.0	91.3	8.7
Gjirokastrër	100.0	90.5	9.5
Korçë	100.0	92.1	7.9
Kukës	100.0	92.1	7.9
Lezhë	100.0	90.3	9.7
Shkodër	100.0	95.5	4.5
Tiranë	100.0	94.2	5.8
Vlorë	100.0	91.7	8.3
PROFILI I EMIGRACIONIT =100			
Gjithsej Shqipëria	100.0	100.0	100.0
Berat	5.3	4.8	10.8
Dibër	4.1	3.7	8.7
Durrës	9.2	9.2	9.8
Elbasan	10.1	9.9	12.2
Fier	11.4	11.4	11.5
Gjirokastrër	2.9	2.9	3.2
Korçë	8.3	8.4	7.6
Kukës	2.4	2.4	2.2
Lezhë	4.5	4.4	5.0
Shkodër	7.5	7.9	4.0
Tiranë	27.2	28.0	18.2
Vlorë	7.1	7.1	6.8


Shënim: Anëtarë të NjEF-ve që kanë pasur vendbanimin e mëparshëm jashtë vendit nënkuptojnë dy lloje personash të ardhur, të kthyer dhe imigrantë në kuptimin më të ngushtë. Baza e dizenuar e kampionit lejon vetëm matjen e fluksit hyrës të imigracionit në NjEF-të ekzistuese në 2011. NjEF-të e reja të krijuara si rezultat i flukseve imigratore nuk janë përfshirë. Krahasuar me profilet e emigracionit, u përfutuan variante të "asnjë" "një pjesë e NjEF-së" u vendosën në Shqipëri. Nuk u bë asnjë regjistrim i variantit "një NjEF e plotë" e vendosur në Shqipëri pas qëndrimit të mëparshëm jashtë vendit.

3.3. Migracioni i brendshëm

Gjatë viteve të censit 2001-2011, lëvizjet e popullsisë brenda vendit kishin arritur shifrën mbi 200 000 njerëz. Asokohe nuk u llogarit asnjë statistikë e ngjashme për familjet. Nga popullata e gjithë familjeve kryefamiljarët e të cilave ishin rezidentë shqiptarë gjatë Censit 2011, 644 484 nuk shënuan asnjë ulje në numrin e anëtarëve si rezultat i migracionit të brendshëm; ato përbënin 86,0 për qind të të gjitha këtyre familjeve.

Shpërndarja hapësinore e këtyre familjeve sipas profilin të fluksit të lëvizjes së brendshme që nga viti 2011 paraqitet në Hartën 2 dhe Tabelën 5. Përqindja e familjeve që nuk kanë asnjë anëtar me vendbanim diku tjetër në Shqipëri në vitin 2019 i tejkalon 90,0 për qind për dy prefektura, Lezhë dhe Vlorë. Për pasojë, përqindja e familjeve që ndryshojnë tërësisht vendbanim nuk e tejkalon 1 për qind.

Harta 2: Familjet me një pjesë të anëtarëve të zhvendosur brenda vendit si rezultat i migracionit të brendshëm për periudhën 2011-2019, sipas prefekturës



Kjo hartë është vetëm për qëllime ilustrimi. Kufijtë dhe emrat e treguar dhe përcaktimet e përdorura në këtë hartë nuk nënkuptojnë një miratim zyrtar ose pranim nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin.

Shënim: NjEF pjesërisht migrante nënkupton NjEF-në nga e cila të paktën një, por jo të gjithë anëtarët e mëparshëm kanë migruar së brendshmi.

Tabela 5: Struktura e familjeve shqiptare më 15 korrik, sipas profilit të migracionit të brendshëm dhe prefekturës

Prefektura e vendbanimit të familjes 2011	NjEF 2011	NjEF në 2019			
		asnjë person migrant	me anëtarë që banojnë diku tjetër në Shqipëri		
			gjithsej	të gjithë	jo të gjithë
	in %				
PREFEKTURA=100					
Gjithsej Shqipëria	100.0	86.0	14.0	4.7	9.4
Berat	100.0	87.7	12.3	3.2	9.1
Dibër	100.0	79.6	20.4	7.2	13.2
Durrës	100.0	82.3	17.7	5.2	12.5
Elbasan	100.0	84.4	15.6	6.2	9.4
Fier	100.0	80.7	19.3	3.6	15.7
Gjirokastrër	100.0	82.9	17.1	5.2	11.9
Korçë	100.0	83.3	16.7	6.2	10.5
Kukës	100.0	61.0	39.0	5.0	33.9
Lezhë	100.0	96.2	3.8	0.5	3.2
Shkodër	100.0	89.8	10.2	4.6	5.6
Tiranë	100.0	89.7	10.3	5.3	5.0
Vlorë	100.0	91.7	8.3	0.9	7.4
PROFILI I MIGRACIONIT =100					
Gjithsej Shqipëria	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
Berat	5.3	5.4	4.7	3.6	5.2
Dibër	4.1	3.8	6.0	6.3	5.8
Durrës	9.2	8.8	11.6	10.3	12.3
Elbasan	10.1	9.9	11.2	13.5	10.1
Fier	11.4	10.7	15.6	8.8	19.0
Gjirokastrër	2.9	2.8	3.6	3.3	3.7
Korçë	8.3	8.1	9.9	11.1	9.4
Kukës	2.4	1.7	6.6	2.6	8.6
Lezhë	4.5	5.0	1.2	0.5	1.5
Shkodër	7.5	7.9	5.5	7.4	4.5
Tiranë	27.2	28.3	19.9	31.2	14.4
Vlorë	7.1	7.5	4.2	1.4	5.5

Shënim: Me "banim diku tjetër në Shqipëri" nënkupton të zhvendosur në një tjetër vend në Shqipëri për të paktën 12 muaj. U morën në konsideratë anëtarët e NjEF-së, përfaqësuesi (kryefamiljari) i të cilëve ishte i pranishëm në censin e vitit 2011, me qëllim që të paraqitej vetëm fluksi i brendshëm që nga viti 2011.

Nga familjet anëtarët e të cilave e kishin vendbanimin diku tjetër në vend në 2019, 33,2 për qind kishin lëvizur tërësisht. Po kështu, 66,8 për qind e tyre kishin migruar pjesërisht, me të paktën një anëtar të zhvendosur diku tjetër në Shqipëri. Migracioni i përgjithshëm brenda vendit është tejet i lartë në Tiranë, nga ku 51,9 për qind e familjeve me fluks të brendshëm migracioni kanë ndryshuar vendbanimin në tërësi. Përveç Tiranës, këto statistika mbi mesataren u shënuan në Shkodër, Korçë, Elbasan dhe Dibër. Në këto prefektura, migracioni i brendshëm ka prekur një numër më të lartë të familjeve të plota.

Një fluks domethënës dalës i popullsisë në zona të tjera të vendit është konstatuar në Kukës, Fier dhe Dibër. Në të gjitha prefekturat e përmendura, përqindja e familjeve ku një anëtar ka migruar (familje pjesërisht migrante) brenda vendit ishte e lartë.

Ashtu si në rastin e migracionit jashtë vendit, u analizua shpërndarja e familjeve të zbërthyera sipas numrit të anëtarëve. Strukturat për profilet e migracionit janë paraqitur në Tabelën 6. Lëvizja e migrantëve në zona të tjera në Shqipëri karakterizohet nga shkallë të ndryshme përqendrimi, në varësi të faktit nëse ishte migracion familjar i pjesshëm ose i plotë.

Tabela 6: Struktura e familjeve shqiptare më 15 korrik 2019 sipas profilit të migracionit të brendshëm dhe madhësisë së familjes

Madhësia e NjEF-së në 2019	NjEF 2011	NjEF në 2019			
		asnjë migrant	me anëtarë me vendbanim diku tjetër në Shqipëri		
			gjithsej	të gjithë ^a	disa
	në %				
KLASA E MADHËSISË =100					
Gjithsej	100.0	86.0	14.0	4.7	9.4
1 person	100.0	91.7	8.3	7.3	1.0
2	100.0	94.7	5.3	3.7	1.5
3	100.0	86.8	13.2	5.2	8.0
4	100.0	84.0	16.0	6.2	9.8
5	100.0	82.7	17.3	4.8	12.6
6 persona e sipër	100.0	81.4	18.6	2.0	16.6


^aMadhësia e NjEF-së në kohën e largimit nga vendbanimi i mëparshëm.

Shënim: Me "vendbanim jashtë" do të thotë të qëndrosh jashtë së paku 12 muaj. U morën në konsideratë anëtarët e NjEF-së, përfaqësuesi i së cilës (kryefamiljari) ishte i pranishëm në censin e vitit 2011, në mënyrë që të paraqitet migracioni që nga ky vit. Kur merret në konsideratë humbja e disa anëtarëve nga NjEF individuale, duhet pasur parasysh se këto janë NjEF-të që, në vitin 2019, kishin vetëm një anëtar; vitet e mëparshme, mund të ketë pasur më shumë njerëz që kanë jetuar bashkë.

Figura 5 shfaq një përpjekje për të krahasuar përqindjen e familjeve tërësisht migrante brenda së njëjtës prefekturë. Rreth 33.3 për qind e migracionit të brendshëm në Shqipëri gjatë periudhës 2011-2019 lidhet me ndryshimin e vendbanit brenda së njëjtës prefekturë. Në shpërndarjen territoriale, mund të përpilojmë të dhëna për fluksin hyrës të familjeve në një prefekturë të dhënë dhe të dhëna mbi drejtimin e fluksit dalës. E para tregon prefekturat e banimit të atyre familjeve që lëvizin tërësisht sipas vendbanimit in 2011 (diagrami në të majtë), ndërsa e dyta tregon prefekturat e vendbanimit në vitin 2019 të familjeve që kanë imigruar tërësisht (diagrami i djathtë).

Nga ana tjetër, situata e Tiranës është e veçantë, pasi shumica e familjeve që zhvendosen së brendshmi mbeten në të njëjtën prefekturë (mbi 90 %). E njëjta gjë vlen për Durrësin, ku kjo shifër është mbi 85 për qind. Në të njëjtën kohë, të dyja këto prefektura duket se janë tërheqëse si destinacione për t'u zhvendosur. Kështu, statistikët raportojnë se përqindja e familjeve që lëvizin tërësisht nga një prefekturë tjetër është mbi 30 për qind.

Figura 5: Lëvizjet e brendshme të familjeve tërësisht migrante që nga viti 2011 sipas prefekturës së destinacionit dhe origjinës



Shënim: 100 për qind nënkupton popullatën e familjeve shqiptare më 2011.

4. Statistikat familjare – personat që kanë ndryshuar vendbanimin që nga viti 2011

4.1 Emigrantët

Rubrika 4 tregon se në vitin 2019, 22,1 për qind e familjeve, përfaqësuesi i të cilave (kryefamiljari) ishte me qëndrim në Shqipëri në vitin 2011, ishin prekur nga njëri prej dy llojeve të migracionit – ose familja në tërësi ose pjesë e saj ishin banorin jashtë vendit në 2019. Analiza e kryer si hap i mëtejshëm përfshinë madhësinë e popullsisë migrante, përfshi anëtarët e familjeve të vrojtura. Rubrika 4.1 paraqet fluksin dalës të popullsisë shqiptare, ndërsa rubrika 4.2 paraqet fluksin hyrës. Sidoqoftë, karakteristikat e migracionit neto nuk do të diskutohen.¹²

Deri në vitin 2019, nga familjet shqiptare u largua një numër i përgjithshëm prej 360 699 personash, ndërkohë që shifrat tregojnë se ky grup arriti në 12,9 për qind të popullsisë së përgjithshme të vendit në vitin 2011. Sërish, fluksi emigrator duhet përcaktuar me shumë kujdes. Rubrika 3 përmban përfundime të arsyetuara lidhur me përqindjen e familjeve tek të cilat u regjistrua fluksi migrator dalës. Ndërkohë që trajton gjetjet rreth popullatës së familjeve, kjo rubrikë ofron një shpjegim disi të thjeshtëzuar të fluksit emigrator¹³. Sidoqoftë, ne do ta konsiderojmë këtë si më pak të rëndësishëm.

Tabela 7 paraqet statistika më të hollësishme lidhur me numrin e familjeve shqiptare deri më 30 shtator 2011, që janë zvogëluar si pasojë e fluksit të emigracionit që nga viti 2011, sipas prefekturës. Duke e konsideruar vrojtimin e variabilitetit në përbërjen e familjeve për periudhën 2011-2019 si të papërfillshëm, mund të vlerësohet numri i anëtarëve të familjes që kanë emigruar në një shkallë me shpërndarje thuajse të barabartë midis atyre që janë larguar bashkë me familjet dhe atyre që kanë lënë një pjesë të familjes në Shqipëri.

Tabela 7: Numri i anëtarëve emigrues të familjes që nga viti 2011 deri më 30 shtator 2019, sipas prefekturës

Prefektura e vendbanimit të familjeve 2011	Popullsia e përgjithshme banuese 2011	Anëtarët emigrantë të familjeve në 2019	
		Gjithsej	nga të cilët, ata me gjithë NjEF-në
		Personat	
Gjithsej në Shqipëri	2,800,138	360,699	183,352
Berat	141,944	17,318	6,474*
Dibër	137,047	13,873	3,514*
Durrës	262,785	37,173	18,001
Elbasan	295,827	37,080	15,319
Fier	310,331	48,069	16,389
Gjirokastrë	72,176	6,610	4,204*
Korçë	220,357	21,134	12,636

¹² Rubrika 1.2, e cila trajton kufizimet e kësaj ankete, mungesën e familjeve të zhvendosura tërësisht në Shqipëri nga viti 2011 deri tani në bazën e kampionit. Hendeku i informacionit që ka ardhur si rezultat është plotësuar deri diku nga rastet studimore të paraqitura në rubrikat 7-10. Megjithatë, është e nevojshme që marrësit e të dhënave të ndërgjegjësohen për specifikën e vlerësuesve të përgatitur të flukseve të jashtme e të brendshme migratore, që nuk duhet të jenë krahasohen lehtësisht me njëri-tjetrin.

¹³ Kjo vjen nga fakti se përbërja e familjeve, kryefamiljari i të cilave ka qenë me vendbanimin në Shqipëri në vitin 2011, ka ndryshuar dhe nuk jemi të bindur që fluksi i përgjithshëm dalës i popullsisë ka të bëjë me popullsinë e pranishme në vitin 2011. Sa u takon familjeve, vetëm kryefamiljari ishte element i qëndrueshëm, siç theksohet në rubrikën 1.2. Në periudhën 2011-2019, familjes i janë bashkuar anëtarë të rinj, si rezultat i lindjes ose migracionit.

Prefektura e vendbanimit të familjeve 2011	Popullsia e përgjithshme banuese 2011	Anëtarët emigrantë të familjeve në 2019	
		Gjithsej	nga të cilët, ata me gjithë NjEF-në
		Personat	
Kukës	85,292	10,541	1,985*
Lezhë	134,027	9,338	4,398*
Shkodër	215,347	35,884	15,705
Tiranë	749,365	102,632	77,701
Vlorë	175,640	21,047	7,025
%			
Gjithsej në Shqipëri	100.0	12.9	6.5
Berat	100.0	12.2	4.6*
Dibër	100.0	10.1	2.6*
Durrës	100.0	14.1	6.9
Elbasan	100.0	12.5	5.2
Fier	100.0	15.5	5.3
Gjirokastrë	100.0	9.2	5.8*
Korçë	100.0	9.6	5.7
Kukës	100.0	12.4	2.3*
Lezhë	100.0	7.0	3.3*
Shkodër	100.0	16.7	7.3
Tiranë	100.0	13.7	10.4
Vlorë	100.0	12.0	4.0


* Shifra me saktësi të ulët.

Shënim: Shifrat e paraqitura përshkruajnë flukset e migracionit neto, shih metodologjinë, rubrika 1. Ato nuk mund të krahasohen me shumën e përgjithshme të flukseve migratore vjetore në periudhën 2011-2019.

Ishte e qartë se fluksi emigrator mbizotëronte kryesisht mes familjeve që kanë emigruar tërësisht. Kështu, 6,6 për qind e familjeve që emigrojnë në tërësi përbëjnë 6,5 për qind të popullsisë. Për grupin e dytë me migracion të pjesshëm, 15,5 për qind e familjeve shënuan një fluks dalës prej 6,4 për qind të popullsisë. Në analizën hapësinore mund të vërehen disa dallime. Tirana është rast i veçantë, ku 10,3 për qind e të gjitha familjeve që kanë emigruar tërësisht ose 10,4 për qind e popullsisë, janë larguar nga prefektura. Në të njëjtën kohë, përqindja e emigrantëve nga familje me emigrim të pjesshëm ishte tri herë më e ulët.

Fluksi dalës i popullsisë nga familjet migrante ishte një proces i vazhdueshëm me një dinamikë konstante (shih Fig. 6), ashtu si në rastin e vrojtimit të kryer për grupin e familjeve.

Figure 6: Fluksi emigrator i familjeve nga popullsia në vitin 2011



Shënim: 100 për qind do të thotë popullsia e Shqipërisë në 2011.

Numri kumulativ i emigrantëve i paraqitur në Figurën 7 tregon numrin e përgjithshëm të personave që janë larguar. Përlogaritjet u bazuan në fluksin dalës neto, për rrjedhojë, nuk do të ishte e justifikuar të kishte ndryshime midis vlerave


të mëpasme si flukse vjetore. Më saktësisht, numri kumulativ i personave duhet të konsiderohet më shumë si numri i personave të larguar në periudhën kumulative që nga viti t^{14} . Në këtë rast, kohëzgjatja kumulative e vërtetimit zgjatet pas në kohë nga momenti i anketës. Një numër i përgjithshëm prej 67 535 emigrantësh që nga viti 2018 përbën fluksin e përgjithshëm dalës në periudhën nga 1 janari 2018 deri më 15 korrik 2019. Më tej, 360 699 persona që kanë emigruar që nga viti 2011 përbëjnë numrin total neto të emigrantëve për periudhën 2011-2019.

Sa i takon shkallës së fluksit dalës vjetor, u krahasuan vendet e destinacionit Greqia dhe Italia dhe vende të tjera. Flukset më të mëdha që u vrojtuan ishin drejt Greqisë dhe Italisë. Për të gjitha destinacionet, fluksi i emigracionit ishte i shpërndarë në mënyrë të barabartë përgjatë gjithë periudhës midis familjeve që kanë emigruar tërësisht ose pjesërisht. Ky fluks dalës u diversifikua në raport me nivelin dhe strukturën:

- 120 754 persona u larguan për në Itali dhe nuk ishin kthyer deri në vitin 2019, prej të cilëve 110 persona u larguan së bashku me të gjithë familjen për çdo 100 persona që kanë migruar nga familjet me profil të pjesshëm migracioni,
- Greqia priti 92 159 emigrantë. Për çdo 100 njerëz që migrojnë nga familje të emigruara pjesërisht, 88 u larguan së bashku me të gjithë familjen dhe
- 40 468 u larguan për në Gjermani. Për çdo 100 anëtarëve që largohen nga familje të emigruara pjesërisht, 138 u larguan nga Shqipëria me të gjithë familjen.

Figura 7: Numri kumulativ i anëtarëve të familjeve që kanë emigruar që në vitin 2011

Deri më 15 korrik 2019



Shënim: Për shkak të specifikës së anketës, diferencat midis vlerave kumulative të periudhës që nga 'viti t' dhe 'viti t-1' nuk duhet të krahasohen drejtpërdrejt me statistikën e publikuar vjetore mbi migrantët. Shifrat aktuale pasqyrojnë të ashtuquajturin fluks të migracionit neto. Shih shpjegimet mbi metodologjinë në Rubrikën 1.2.

14 Për shembull, numri i personave që mungonin në vitin 2019 dhe ishin larguar në periudhën midis 1 janarit 2018 dhe 15 korrik 2019 ishte 30 427+37 108=67 535. Numri i personave që nuk ishin të pranishëm më 15 korrik, që ishin larguar në periudhën 1 janar 2011-15 korrik 2019 ishte 177 347+183 353=360 699. Një skemë e tillë u përdor për Figurat 9 dhe 10.

4.2 Të kthyerit dhe imigrantët – fluksi hyrës i migrantëve

Duke marrë parasysh 96 755 personat që u larguan nga vendi i banimit të zakonshëm, pas qëndrimit në një vend tjetër për të paktën një vit dhe atyre që mbërritën në Shqipëri në vitin 2019, numri i të kthyerve u vlerësua në 95 064 persona, ndërsa numri i imigrantëve (joshtetas) u llogarit në 1 691(*) persona. Vlerësimi i fundit duhet të analizohet me kujdes për shkak të saktësisë së ulët. Sidoqoftë, rendi i magnitudës së kësaj shifre është kaq i rëndësishëm në shtresën e saj informative, sa struktura e imigrantëve paraqitet specifikisht në Figurën 8.

Figura 8: Struktura e imigrantëve që mbërritën në Shqipëri deri në 2019

Deri më 15 korrik 2019




Tabela 8 paraqet shpërndarjen hapësinore të individëve që mbërrijnë (imigrantët në kuptimin më të gjerë) dhe intensitetin e këtij fluksi hyrës si përqindje e popullsisë në periudhën e censit 2011. Nga këta imigrantë, 18,1 për qind vendosen në rajonin e Tiranës, i ndjekur nga Elbasani me 13,5 për qind. Në të njëjtën kohë, intensiteti i dukurisë ishte nga më të ulëtët për prefekturën e Tiranës, ndërsa për Elbasanin, ishte deri në 44,2 imigrantë për 1 000 banorë.

Tabela 8: Anëtarët e familjes që qëndrojnë jashtë më gjatë sesa 12 muaj sipas prefekturës

Deri më 15 korrik 2019

Prefektura e vendbanimit të familjeve	Imigrantët përfshi të kthyerit dhe migrantët në kuptimin e ngushtë	
	Individë	Individë për 1 000 banorë, 2011
Gjithsej në Shqipëri	96,755	34.6
Berat	8,661	61.0
Dibër	7,779	56.8
Durrës	9,212	35.1
Elbasan	13,080	44.2
Fier	9,403	30.3
Gjirokastrë	3,754	52.0
Korçë	7,177	32.6
Kukës	2,508	29.4
Lezhë	6,015	44.9
Shkodër	4,304	20.0
Tiranë	17,477	23.3
Vlorë	7,385	42.0

Shënim: Nuk u regjistrua varianti i vendosjes së 'familjes në tërësi' në Shqipëri pas një qëndrimi të mëparshëm jashtë.


Nga numri i përgjithshëm prej 96 755 imigrantësh, 34 128 persona mbërritën në Shqipëri përpara vitit 2011. Numri kumulativ i imigrantëve shfaqet në Figurën 9. Ashtu si në Figurën 7, kohëzgjatja kumulative e analizës shtrihet pas nga momenti i anketës. Sa i takon migracionit, çështja bëhet edhe më e ndërlikuar kur vjen fjala tek interpretimi. Fillimi i ‘grupit të kampionit’ është teorikisht censi i vitit 2011. Duhet theksuar se koha e përdorur dhe ndarja territoriale përcakton grupin e familjeve përbërja e të cilave u vrojtua. Kjo përbërje u vrojtua deri më 15 korrik 2019, kështu është mundësia që ngjarjet të kenë ndodhur përpara 30 shtatorit 2011.

Pak më shumë se 85 për qind e imigrantëve kishin qenë më parë me qëndrim në tri vende, që janë edhe destinacionet më popullore për emigrantët, Greqia, Italia dhe Gjermania. Duke qenë se shumica e imigrantëve në Shqipëri janë të kthyerit, duhet kryer një analizë e destinacionit të tyre të fundit bashkë me vrojtimin e vendeve të mëparshme të emigracionit. Kjo do të bënte të mundur nxjerrjen e përfundimeve rreth destinacionit të dëshiruar për studime të ardhshme, duke analizuar historikun e ngjarjeve të migracionit në këtë grup.

Në Figurën 9, faktet rreth historikut të kohëve të fundit të emigracionit nga Shqipëria rezultojnë me rëndësi. Popullariteti i emigracionit drejt Greqisë përpara vitit 2011 vjen me gjasë si rezultat një fluks të lartë të kthyerish. Në kundërshtim me këtë, kthimet nga Gjermania nuk janë kaq të shumta në numër. Çështja nëse këto janë kthime apo migracioni i shtetasve të tjerë duhet të jetë objekt i kërkimeve të mëtejshme.

Figura 9: Numri kumulativ i anëtarëve të familjes që mbërritën në Shqipëri deri në 2019

Deri më 15 korrik 2019



Shënim: Për shkak të specifikës së anketës, diferenca midis vlerave kumulative të periudhave që nga ‘viti t’ dhe ‘vitit t-1’ nuk duhen krahasuar drejtpërdrejt me statistikën e botuar vjetore mbi emigrantët. Baza e kampionit bën të mundur vetëm matjen e fluksit të migracionit në NjEF-të ekzistuese në vitin 2011. NjEF-të e reja të krijuara si rezultat i flukseve të migracionit nuk u përfshinë. Ndarja sipas flukseve migratore ka sjellë dy variable – “asnje” ose “një pjesë” e NjEF-së e vendosur në Shqipëri.

4.3 Migrantët e brendshëm

Nga grupi i familjeve shqiptare kryefamiljari i të cilave ishte banor në vend në vitin 2011, 4,7 për qind kanë ndryshuar vendbanimin në tërësi, ndërsa 9,4 për qind e kanë bërë pjesërisht. Është vlerësuar se nga totali prej 14 për qind i familjeve, 8 për qind e popullsisë kanë ndryshuar vendbanimin e mëparshëm duke qëndruar në vend.

Tabela 9 paraqet të dhëna të hollësishme. Analiza e mundshme e përqendrimit të përqendrimit të migracionit të brendshëm në grupin e familjeve të migruara tërësisht mund të kryhet e parë në raport me rezultatet e Tabelës 5. Kukësi duket se është prefektura me përqindjen më të lartë të popullsisë që ndryshon vendbanimin brenda vendit, me 16,1 për qind të popullsisë së përgjithshme banuese në vitin 2011. Në të njëjtën kohë, sa i takon strukturës së familjes, kjo prefekturë kishte përqindjen më të lartë të familjeve që migrojnë së brendshmi me migracion të pjesshëm, me 33,9 për qind. Nga ana tjetër, përqindja e familjeve të tëra që kanë lëvizur brenda vendit dhe e popullsisë së përgjithshme që migron së brendshmi është e lartë në Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Elbasan dhe Korçë.

Tabela 9: Individët që largohen nga familja për shkak të migracionit të brendshëm deri më 30 shtator 2011 sipas prefekturës

Qarku i vendbanimit të NjEF-së në 2011	Popullsia e përgjithshme banuese 2011	Anëtarët e familjes migrante në 2019	
		gjithsej	NjEF në tërësi
		Individë	
Gjithsej për vendin	2,800,138	223,509	127,843
Berat	141,944	9,262	4,351
Dibër	137,047	13,643	7,992
Durrës	262,785	24,181	13,316
Elbasan	295,827	29,043	18,084
Fier	310,331	28,776	10,517
Gjirokastrë	72,176	7,462	3,873
Korçë	220,357	22,406	14,332
Kukës	85,292	13,693	4,138
Lezhë	134,027	2,175	784
Shkodër	215,347	14,153	9,830
Tiranë	749,365	52,273	39,251
Vlorë	175,640	6,443	1,374
%			
Gjithsej për vendin	100.0	8.0	4.6
Berat	100.0	6.5	3.1
Dibër	100.0	10.0	5.8
Durrës	100.0	9.2	5.1
Elbasan	100.0	9.8	6.1
Fier	100.0	9.3	3.4
Gjirokastrë	100.0	10.3	5.4
Korçë	100.0	10.2	6.5
Kukës	100.0	16.1	4.9
Lezhë	100.0	1.6	0.6
Shkodër	100.0	6.6	4.6
Tiranë	100.0	7.0	5.2
Vlorë	100.0	3.7	0.8


Shënim: Llogaritjet e paraqitura përshkruajnë flukset e migracionit neto, shih metodologjinë, rubrika 1. Ato nuk mund të krahasohen me shumën e flukseve dalëse migratore vjetore për periudhën 2011-2019.

Numri kumulativ i migrantëve të brendshëm paraqitet në Figurën 10. Numri i përgjithshëm prej 223 509 që migrojnë brenda vendit që nga viti 2011 është i barabartë me numrin e përgjithshëm të të gjithë migrantëve të brendshëm në periudhën 2011-2019. Në këtë seri të shkurtër kohore mund të shohim dy dinamika të ndryshme të fluksit të

brendshëm migrator: një në periudhën 2011-2013 dhe tjetra nga viti 2014, kur fluksi vjetor i migracionit të brendshëm duke se është dy herë më i lartë për individët.

Figura 10: Numri kumulativ i anëtarëve të familjes që ndryshojnë vendbanimin brenda Shqipërisë


Deri më 15 korrik 2019



Shënim: Për shkak të specifikës së anketës, dallimi midis vlerave të kumuluar që nga 'viti t' dhe 't-1' nuk duhen krahasuar drejtpërdrejt me statistikën e botuar vjetore mbi migrantët e brendshëm.

Deri më tani, vlerësimet janë përqendruar te vendbanimi nga ku janë larguar migrantët. Llogaritjet sipas prefekturës së origjinës u përfutuan për shkallën e supozuar të zërvendimit të të dhënave (shih Figurën 11). Në të njëjtën kohë është e mundur të zhvillohet një analizë e ngjashme nga këndvështrimi i vendbanimit të ri (prefektura e destinacionit). Popullsia që ndryshon vendbanimin brenda vendit, por jo brenda prefekturës, përbënte 61,6 për qind e të gjithë migrantëve të brendshëm¹⁵. Shumica dërrmuese e personave që lëvizin nga Tirana (93,8 %) mbeten në të njëjtën prefekturë. Ky "fluks hyrës" specifik shihet si diferenca midis atyre që ndryshuan vendbanimin brenda prefekturës dhe atyre që shkuan në një prefekturë tjetër. Në të njëjtën kohë, më shumë sesa gjysma e personave të vendosur në prefekturën e Tiranës vijnë nga prefektura të tjera (54,4 %).

Figura 11: Lëvizja e brendshme e familjeve që kanë migruar tërësisht që nga viti 2011 sipas destinacionit dhe prefekturës së origjinës



SHËNIM: 100 për qind nënkupton popullsinë e Shqipërisë në 2011.

15 Kjo mund të nënkuptojë se ata kanë ndryshuar vendbanimin ose duke ndenjur në të njëjtën bashki, ose duke ndryshuar bashkinë brenda prefekturës.

5. Profili socio-demografik i personave që kanë ndryshuar vendbanimin që nga viti 2011

5.1 Mosha dhe gjinia

Ky studim i AMF-së është një përpjekje për të informuar politikëbërësit mbi shkallën dhe strukturën e migracionit. Veçanërisht, kjo lloj analize pritet të përshkruajë profilin e migrantëve. Në rastin e AMF-së, kjo pritshmëri standarde nuk mund të përmbushej plotësisht, për shkak të metodave të përdorura. Megjithatë, ne shpresojmë se pavarësisht kufizimeve të përshkruara më poshtë, karakteristikat e identifikuar të migrantëve mund të përdoren për hartimin e politikave dhe vlerësimit mundshëm të ndikimit të migracionit mbi forcën aktive të punës.

Migrantët e përshkruar në rubrikën 4 janë ndarë në tri grupe kryesore – emigrantë, imigrantë dhe migrantë të brendshëm. Gjatë analizës, iu kushtua vëmendje e veçantë identifikimit të saktë të të intervistuarve në njërin prej këtyre nëngrupeve:

- individë që emigrojnë më të gjithë familjen,
- emigrantë që lënë pas anëtarë të familjes në vend,
- imigrantë që bashkohen me familjet e mëparshme,
- migrantë të brendshëm që lëvizin me të gjithë familjen dhe
- migrantë të brendshëm, që lënë anëtarët e familjes së mëparshme për t'u bashkuar me familje të tjera ekzistuese.

Ky koncept do të jetë me rëndësi në procesin e identifikimit të moshës, gjinisë dhe karakteristikave të tjera të migrantëve. Tabela 10 paraqet shpeshtësinë që vjen si rezultat i shpërndarjes së emigrantëve, imigrantëve dhe migrantëve të brendshëm sipas moshës. Duket se këto struktura janë të krahasueshme, edhe pse ka pasaktësi, si më poshtë:

- numri i përgjithshëm i imigrantëve që janë bashkuar me familjet e mëparshme ekzistuese nuk mund të krahasohet me asnjë tjetër vlerë. Për këtë veprim nuk u grumbullua asnjë informacion lidhur me familjet që janë zhvendosur plotësisht në Shqipëri nga jashtë; numri i imigrantëve (96 755) është i paplotë;
- numri i përgjithshëm personave që emigrojnë dhe lëvizin brenda vendit përfshin numrin e personave që janë larguar me familjet e tyre. Për këta njerëz nuk ka asnjë informacion lidhur me moshën apo atribut të tjera socio-demografike. Për këtë qëllim, është përfshirë një kategori shtesë, 'moshë e panjohur'.

Tabela 10: Numri i anëtarëve të familjeve shqiptare deri më 15 korrik 2019 ku përfshihen flukset migratore sipas grupmoshës

Grupmosha	Emigrantë që nga 2011	Imigrantë nga NjEF-të kryefamiljari i të cilave ishte i pranishëm në 2011	Migrantët e brendshëm që nga 2011
Total	360,699	96,755	223,509
Nën 15 vjeç	11,991	6,552	3,083
15-64 vjeç	160,876	81,646	89,945
65 vjeç e sipër	4,480	8,557	2,638
E panjohur	183,352	.	127,843

. – nuk ka të dhëna të disponueshme

Shënim: Mosha në këtë tabelë zbatohet vetëm për ato raste ku ishte e mundur që të përcaktohej. Kjo është mosha faktike e matur gjatë kohës së anketës.

Vetëm anëtarët e familjeve me migracion të pjesshëm u përzgjedhën për t'u karakterizuar më tej. Edhe në këtë rast, popullsia imigrante nuk përkon plotësisht me periudhën e supozuar kohore për flukset e tjera migratore. Për këtë grup u përgatitën shpërndarjet e moshës dhe gjinisë (shih Tabelën 11).

Tabela 11: Anëtarët migrues të familjeve me migracion të pjesshëm më 15 korrik 2019 sipas moshës dhe gjinisë

Gjinia	Mosha	Emigrantë që nga 2011	Imigrantë nga NjEF-të kryefamiljari i të cilave ishte i pranishëm në 2011	Migrantët e brendshëm që nga 2011
Gjithsej	Gjithsej	177 347	96 755	95 666
	Nën 10 vjeç	5 960	3 140	1 389(*)
	10-14 vjeç	6 031	3 412	1 694(*)
	15-19 vjeç	11 327	3 406	5 627
	20-24 vjeç	31 124	6 805	24 952
	25-29 vjeç	41 220	9 792	25 772
	30-34 vjeç	30 117	10 171	16 653
	35-39 vjeç	19 129	10 312	8 340
	40-44 vjeç	10 188	9 649	3 225
	45-49 vjeç	7 870	9 234	2 277
	50-54 vjeç	4 832	8 922	1 196(*)
	55-59 vjeç	2 926	7 545	(*)
	60-64 vjeç	2 143	5 810	(*)
	65 vjeç e sipër	4 480	8 557	2 638
Meshkuj	Gjithsej	110 748	71 246	32 131
	Nën 10 vjeç	3 216	1 510(*)	(*)
	10-14 vjeç	3 445	1 858	(*)
	15-19 vjeç	7 461	2 001	1 726(*)
	20-24 vjeç	17 509	4 254	6 679
	25-29 vjeç	24 862	7 417	6 248
	30-34 vjeç	19 640	7 863	6 220
	35-39 vjeç	12 867	8 168	4 071
	40-44 vjeç	7 658	7 772	1 963
	45-49 vjeç	5 675	7 174	1 089(*)
	50-54 vjeç	3 119	7 506	(*)
	55-59 vjeç	1 981	5 992	(*)
	60-64 vjeç	1 092(*)	4 235	(*)
	65 vjeç e sipër	2 223	5 496	1 334(*)
Femra	Nën 10 vjeç	66 608	25 513	63 535
	10-14 vjeç	2 746	1 629(*)	(*)
	15-19 vjeç	2 587	1 551(*)	(*)
	20-24 vjeç	3 865	1 406(*)	3 899
	25-29 vjeç	13 618	2 551	18 272
	30-34 vjeç	16 358	2 376	19 526
	35-39 vjeç	10 477	2 309	10 433
	40-44 vjeç	6 262	2 144	4 269
	45-49 vjeç	2 530	1 878	1 262(*)
	50-54 vjeç	2 194	2 061	1 187(*)
	55-59 vjeç	1 715(*)	1 415(*)	(*)
	60-64 vjeç	945(*)	1 552(*)	(*)
	65 vjeç e sipër	1 051(*)	1 575(*)	(*)
	Nën 10 vjeç	2 260	3 066	1 306(*)

x(*) – x është rezultati i një përlogaritjeje me saktësi të ulët

(*) – vlerë e fshehur për shkak të një gabimi shumë të madh në llogaritje apo një mesatareje të fshehur


NOTE: Anëtarët që janë larguar nga vendbanimi i mëparshëm me të gjithë familjen nuk janë marrë në konsideratë. Mosha faktike u mat gjatë kohës së anketës.

Figurat 12-14 paraqesin piramidën e moshës dhe, në të njëjtën kohë, tregojnë ndryshimet gjinore në tri grupet kryesore ku mund të identifikohen karakteristikat e variableve socio-demografike. Përfundimet kryesore që dalin nga grafikët përfshijnë:

- mbizotërim të theksuar të burrave kundrejt grave të emigrantët dhe imigrantët në moshë pune. Burrat emigrantë mbizotëronin me 8 në 200 për qind më shumë në grupmoshat 30-65 vjeçe. Tek imigrantët, ky mbizotërim për të njëjtën grupmoshë arrinte në 400 për qind dhe
- mbizotërim të theksuar të grave kundrejt burrave në moshën 15-vjeçare e lart në kategorinë e migrantëve të brendshëm, me përjashtim të grupmoshës 40-44 vjeçe.


Grafiku në vijim paraqet mbizotërimin në të gjitha grupmoshat. Në figurat 12-14, të dhënat mbi grupmoshat më pak të shpeshta mund të jenë pa rëndësi statistikore ose mund të shoqërohet me një gabim të konsiderueshëm në përlogaritje që tregohet qartë në Tabelën 11 më sipër.

Figura 12: Anëtarët emigrues të familjeve me migracion të pjesshëm deri më 15 korrik 2019, sipas moshës dhe gjinisë




Shënim: Emigrantët neto që nga viti 2011. Njerëzit që janë larguar nga vendbanimi i mëparshëm me të gjithë familjen nuk janë marrë në konsideratë.

Figura 13: Imigrantët që janë bashkuar me familjet e mëparshme deri më 15 korrik 2019, sipas moshës dhe gjinisë



Shënim: Përfshi individët që janë bashkuar me NjEF-të në popullsinë e synuar përpara vitit 2011.

Figura 14: Migrantët e brendshëm të familjeve me migracion të pjesshëm deri më 15 korrik 2019

Shënim: Emigrantët neto që nga viti 2011. Anëtarët e NjEF-ve që janë larguar me të gjithë familjen nuk janë marrë në konsideratë. Për shkak të nivelit të papranueshëm të gabimit standard për grupmoshat më të reja, janë marrë vetëm personat 15 vjeç e sipër.

5.2 Arsimi

Ashtu si në Rubrikën 3.1, në rastin e arsimit, u përzgjedhën vetëm individët nga familje me migracion të pjesshëm. Madhësia e kampionit bëri të mundur vlerësimin e nivelit arsimor në grupet kryesore, mbështetur në Klasifikimin Standard Ndërkombëtar të Arsimit (ISCED) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Ashtu siç tregohet në Figurën 15 dhe Tabelën 12, shpërndarja e personave që lëvizin bazuar në nivelin e tyre arsimor ishte e ngjashme për flukset ndërkombëtare. Si në tabelë, ashtu edhe në figura përfshihet niveli arsimor i emigrantëve përpara largimit.


Kategoria 'e panjohur' nuk përkton me grupin anëtarëve që kanë migruar me të gjithë familjen. Siç përmendet më sipër, të dhënat përkatëse u mbledhën nga intervistat e drejtpërdrejta me kryefamiljarët e familjeve me migracion të pjesshëm.

Tabela 12: Anëtarët migrantë të familjeve me migracion të pjesshëm deri më 15 korrik 2019 sipas nivelit arsimor

Niveli arsimor			Emigrantë që nga 2011	Imigrantë nga NjEF kryefamiljarët e të cilave ishin të pranishëm në 2011	Migrantët e brendshëm që nga 2011
			Individë të grupmoshës 15 e sipër		
Gjithsej			177 347	96 755	95 666
Arsim i ulët ISCED 0-2	pa arsim		69 690	36 009	25 164
	Arsim fillor				
	Arsim i ulët i mesëm (7/8/9 vjet)				
Arsim i mesëm ISCED 3-4	I lartë i mesëm	Shkollë profesionale	70 896	42 616	36 968
		Gjimnaz (shkollë e mesme)			
	Arsim post-sekondar dhe jo i lartë				
Arsimi i lartë ISCED 5-8	I lartë	Bachelor	24 769	11 581	30 453
		Master			
		Doktoraturë			
E panjohur			11 992	6 549	3 081

Shënim: Emigrantët dhe migrantët e brendshëm neto që nga viti 2011. Anëtarët e NjEF-ve që janë larguar me të gjithë familjen nga vendbanimi i mëparshëm nuk janë marrë në konsideratë. Imigrantët përfshijnë individët që janë bashkuar me NjEF-të në popullsinë e synuar përpara vitit 2011.

Figura 15: Struktura e anëtarëve të familjeve me migracion të pjesshëm të grupmoshës 15 vjeç e lart deri më 15 korrik 2019, sipas nivelit arsimor



Shënim: shih Tabelën 12.

5.3 Statusi i punësimit

Për të provuar përputhshmërinë me parametrat bazë të analizuar të tregut të punës, anëtarët 15 vjeç e lart të familjeve me migracion të pjesshëm u morën në shqyrtim në mënyrë të veçantë nga e gjithë popullsia. Hipoteza mbi ngjashmërinë midis popullsisë aktive¹⁶ dhe normave të papunësisë tek emigrantët dhe imigrantët nuk duhet formuluar në kuptimin e ngushtë, për shkak të mospërputhjeve në përcaktimin e përmasës kohore të vendosjes në vend pas mbërritjes nga jashtë (Rubrika 4.2).

Për rrjedhojë, Tabela 13 paraqet një grup treguesish duke shmangur referencën ndaj termave të mirëfillta të përdorura në analizat e rezultateve të Anketës së Forcës së Punës. Sigurisht, në analizën e emigracionit, është me vlerë të theksohet se 80 për qind e personave që janë pjesë e flukseve migratore janë aktivë.

Tabela 13: Anëtarët në moshë 15 vjeç e sipër nga familjet me migracion të pjesshëm deri më 15 korrik 2019 sipas statusit të punësimit

Statusi i punësimit		Emigrantë që nga 2011	Imigrantë nga NjEF kryefamiljarët e të cilave ishin të pranishëm në 2011	Migrantët e brendshëm që nga 2011
		Individë të grupmoshës 15 e sipër		
Gjithsej		177 347	96 755	95 666
Aktivë	Gjithsej	134 589	73 571	63,337
	Nga të cilët			
	Të punësuar (me kohë të plotë/të pjesshme)	59 289	38 852	34,769
	Të papunë	75 300	34 719	28,568
Joaktivë	Gjithsej	30 766	16 635	29,248
	nga të cilët			
	nxënës student formim i mëtejshëm përvojë pune e papaguar	14 370	4 254	15,347
	në pension ose në pension të parakohshëm ose kanë hequr dorë nga biznesi	3 062	8 860	2,054
	angazhuar në punë shtëpie	9 338	2 365	10,175
Nuk dihet		11 992	6 549	3 081
		për 100 persona gjithsej (përjashto ata që nuk dihen)		
Aktivë		81,39	81,56	68,41
Joaktivë		18,61	18,44	31,59

16 Termi "aktiv" u referohet personave të punësuar dhe të papunë.

Statusi i punësimit	Emigrantë që nga 2011	Imigrantë nga NJEF kryefamiljarët e të cilave ishin të pranishëm në 2011	Migrantët e brendshëm që nga 2011
	Individe të grupmoshës 15 e sipër		
Gjithsej	177 347	96 755	95 666
	për 100 persona aktivë		
Të papunë	55,95	47,19	45,10
	për 100 persona joaktivë		
Nxënës, studentë, formim u mëtejshëm, përvojë pune e papaguar	46,71	25,57	52,47
në pension ose në pension të parakohshëm ose kanë hequr dorë nga biznesi	9,95	53,26	7,02
angazhuar në punë shtëpie	30,35	14,22	34,79

Shënim: Shih Tabelën 12. Sipas statusit aktual të punësimit.


5.4 Arsyet e largimit nga vendbanimi – planet e migrantëve për të ardhmen

Për tri grupet e migrantëve – emigrantë, të kthyer dhe migrantë të brendshëm – u përgatit një vlerësim i motiveve për lëvizjen e tyre. Në të gjitha rastet, u përcaktuan vlerësuesit për nëngrupet e familjeve me migracion të pjesshëm. Nga të gjitha statistikat e përpiluara për studimin përfaqësues të AMF 2019 u përzgjedhën ato që u vërtetuan se kishin një nivel standard gabimi dhe saktësie.

Figurat 16 dhe 17 tregojnë arsyet përse anëtarët e familjeve me profil migracioni të pjesshëm u larguan apo u kthyen në vend. Është sërish me rëndësi të theksohet se gjetjet përfshinin familjet e pranishme gjatë kohës së censit 2011, d.m.th. familjet me kryefamiljar me qëndrim në Shqipëri në 2011 (shih shpjegimet metodologjike në rubrikën 1.2.). Përfundimi kryesor është se arsyet kryesore të largimit nga vendi ishin problemet financiare dhe kushtet e jetesës ndërsa për kthimin, arsyet familjare. Për fat të keq, AMF-ja nuk ofroi informacion lidhur me motivet e familjeve që kanë lëvizur tërësisht apo planet e tyre për të ardhmen.

Emigrantët

Figura 16: Struktura e familjeve shqiptare me migracion të pjesshëm sipas arsyes së emigracionit



Shënim: Emigrantët neto që nga viti 2011. Anëtarët e NJEF-ve që janë larguar nga vendbanimi i tyre së bashku me gjithë familjen nuk u morën në konsideratë.

Perceptimi mbi kthimin në vendin e origjinës duhet të lidhet me analizën e motiveve në korrelacion me atë të planeve për të ardhmen. Tabelat 14-15 përmbajnë një vlerësim të emigrantëve që kanë në plan të kthehen dhe përqindjen e të kthyerve që kanë në plan të riemigrojnë. Pyetjet lidhur me planet e emigrantëve për një kthim të mundshëm në Shqipëri u përfshinë në intervistën për kryefamiljarët e familjeve të pranishme në vend, siç është e zakonshme për këtë lloj ankete sociale.


Tabela 14: Anëtarët emigrues të familjeve me migracion të pjesshëm sipas planeve për të ardhmen

Plani për të ardhmen	Gjithsej	Gjithsej sipas vendit të emigrimit		
		Itali	Greqi	Gjermani
	Individë			
Gjithsej	177 347	57 483	49 023	17 003
Plan për t'u kthyer në Shqipëri	19 490	3 699	8 243	2 124
Asnjë plan për t'u kthyer në Shqipëri	86 213	30 777	19 773	6 656
Nuk dihet	71 644	23 007	21 008	8 223
	%			
Gjithsej	100,0	100,0	100,0	100,0
Plan për t'u kthyer në Shqipëri	11,0	6,4	16,8	12,5
Asnjë plan për t'u kthyer në Shqipëri	48,6	53,5	40,3	39,1
Nuk dihet	40,4	40,0	42,9	48,4

Shënim: Emigrantët neto që nga viti 2011. Anëtarët e NjEF-ve që janë larguar së bashku nga vendbanimi i mëparshëm nuk janë marrë parasysh.

Të kthyerit

Figura 17: Të kthyerit që janë bashkuar me familjet e mëparshme sipas arsyes së kthimit dhe vendit të mëparshëm të qëndrimit



Shënim: Përfshi personat që janë bashkuar me NjEF-të në popullsinë e synuar përpara vitit 2011.

Tabela 15: Të kthyerit që janë bashkuar me familjet e tyre sipas planeve për të ardhmen dhe vendit të mëparshëm të qëndrimit

Plani për të ardhmen	Gjithsej	Gjithsej sipas vendit të emigrimit		
		Itali	Greqi	Gjermani
		Individë		
Gjithsej	96 755	48 623	24 093	10 387
Do të riemigrojnë	33 705	13 755	9 578	5 218
Nuk do të riemigrojnë	37 145	22 977	7 823	2 798
Nuk dihet	25 906	11 891	6 693	2 372
		%		
Gjithsej	100,0	100,0	100,0	100,0
Do të riemigrojnë	34,8	28,3	39,8	50,2
Nuk do të riemigrojnë	38,4	47,3	32,5	26,9
Nuk dihet	26,8	24,5	27,8	22,8

Shënim: Përfshi personat që u janë bashkuar NjEF-ve në popullsinë e synuar përpara vitit 2011.

Migrantët e brendshëm

Arsyet për migrimin e brendshëm janë po ashtu me rëndësi për t'u theksuar. Në këtë drejtim, vëmendja është përqendruar tek ato familje që kanë profil migracioni të pjesshëm. Duke pasur parasysh analizën e Tabelës 16 bashkë me analizën e shpërndarjes së individëve që lëvizin së brendshmi sipas gjinisë dhe moshës (shih Figure 14), mund të supozohet fluksi më i madh i migrimit të brendshëm shkaktohet nga ngritja e familjeve të reja. Për fat të keq, AMF-ja nuk ofron informacion lidhur me arsyet e lëvizjes së familjeve migrante në tërësi, njësoj si edhe për emigracionin. Informacioni mbi migracionin e familjeve në tërësi nuk u mor nga intervistat, por nga të dhënat e mbështetura në informacionet e thjeshtuara nga fqinjët (shih Tabelën 1).

Tabela 16: Migrimi i brendshëm i familjeve me migracion të pjesshëm sipas arsyes së largimit nga vendbanimi

Arsyeja e largimit nga vendbanimi	Persona	%
Gjithsej	95 667	100,0
Mundësitë e punësimit	19 712	20,6
Mundësitë e studimit	17 624	18,4
Arsye familjare	49 889	52,1
Të tjera	8 442	8,8

Shënim: Personat që lëvizin brenda vendit që nga viti 2011. Anëtarët e NjEF-ve që janë larguar së bashku nga vendbanimi i mëparshëm nuk janë marrë parasysh.

6. Përfundimet e AMF-së

6.1 Gjetjet kryesore të AMF 2019

INSTAT-i, në bashkëpunim me IOM-in, kreu një anketë të zgjeruar të migracionit familjar gjetjet e së cilës paraqesin ndryshimet që kanë ndodhur gjatë viteve të fundit në shoqërinë shqiptare. Kushtuar tërësisht çështjeve të migracionit, kjo anketë është një zhvillim i rëndësishëm që ka për qëllim përmirësimin e statistikave publike të Shqipërisë në përgjithësi dhe statistikave të popullsisë e migracionit, në veçanti. Rezultatet e anketës përqendrohen në karakteristikat kryesore demografike të familjeve që kanë ndryshuar vendbanimin që nga viti 2011 (Censi i fundit i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri).

Rezultatet e përfuara nxjerrin në pah risinë e këtij studimi dhe, si të tilla, ato duhet të identifikohen qartësisht. Vlerësimet e anketës ilustrojnë flukset e popullsisë për periudhën 2011-2019. Sipas përkufizimit, flukset migratore vjetore që rezultojnë nga AFP-ja mund të dallohen nga flukset e përgjithshme shumëvjeçare në bazë të serive kohore të AFP-së, që janë flukse bruto, dhe flukset migratore neto për periudhën 2011-2019 që rezultojnë nga AMF-ja. Për pasojë, përkufizimi mund të bëjë dallimin midis flukseve migratore vjetore bruto që rrjedhin nga AFP-ja dhe flukset migratore neto që vijnë nga AMF-ja.

Duke pasur parasysh të gjitha vlerësimet, është me rëndësi të theksohet se kjo anketë prodhoi për herë të parë:

- një analizë të flukseve migratore neto për periudhën 2011-2019
- statistika për ndryshimin e vendbanimit nga familjes.

Karakteristikat kryesore të popullsisë shqiptare paraqiten në Tabelën 17. Vlera më e rëndësishme dhe novatore e prezantuar nga kjo anketë ishte dallimi i profilit të migracionit familjar, që është përdorur për të vlerësuar numrin e familjeve dhe individëve migrantë që ndahen në këto tre grupe vijuese:

- asnjë anëtar i familjes nuk ka migruar (zero migracion),
- të paktën një, po jo të gjithë anëtarët e familjes kanë migruar dhe
- e gjithë familja ka migruar.

Në periudhën 2011-2019, rastet kur e gjithë familja ka migruar përfaqësonin 6,6 për qind të popullsisë familjare të pranishme në censin e fundit të vitit 2011 ose 6,5 për qind të të gjithë popullsisë së Shqipërisë.

Gjatë së njëjtës periudhë, 6,4 për qind e popullsisë së Shqipërisë është larguar nga 15,5 për qind e familjeve. Këto ishin të ashtuquajtura familje me migracion të pjesshëm.

Tabela 17: Karakteristikat kryesore të gjetjeve të AMF 2019

Profili i migracionit familjar	Numri i familjeve	Numri i përgjithshëm e anëtarëve të familjeve që migrojnë
MIGRACIONI I TË GJITHË FAMILJEN (MIGRACION TËRËSOR) të gjithë anëtarët e familjeve kanë ndryshuar vendbanimit që nga viti 2011	84,434	311,194
largohen jashtë	49,500	183,352
largohen diku tjetër në Shqipëri	34,934	127,843

Profili i migracionit familjar	Numri i familjeve	Numri i përgjithshëm e anëtarëve të familjeve që migrojnë
MIGRACIONI I NJË PJESE TË ANËTARËVE TË FAMILJES (MIGRACION I PJESSHËM) të paktën 1 anëtar i familjes ka migruar që nga viti 2011		
largohen jashtë ose diku tjetër në Shqipëri	171,482	.
jashtë vendit	116,446	177,347
diku tjetër në Shqipëri	70,339	95,667
të paktën një anëtar i larguar jashtë dhe të paktën një që ka lëvizur diku tjetër në Shqipëri	15,304	.
Të kthyerit	64,740	96,755
ZERO MIGRACION asnjë anëtar i familjes nuk ka migruar që nga 2011	493,841	1,872,974a

anëtarët e NjEF-së që nuk kanë lëvizur.

6.2 Përfundime mbi sistemin e anketave të migracionit në Shqipëri

Një anketë novatore e migracionit familjar (AMF) ka ofruar një informacion krejtësisht të ri mbi përbërjen e flukseve migratore dhe mbi përqindjen e anëtarëve të familjes të përfshirë në to. Kjo çoi më tej në identifikimin dhe matjen e llojeve të familjeve sipas profilit të migracionit. Një përmbledhje e hollësishme e dallimeve të bëra paraqitet në Tabelën 17. Risia e parë e anketës ishte dallimi i familjeve në kategorinë e lartpërmendur. Një risi e dytë ishte vlerësimi i numrit të familjeve anëtarët e të cilave marrin ose jo pjesë në lëvizjen migratore. Së treti, INSTAT-i ka zhvilluar sistematikisht vlerësime të numrit të anëtarëve të familjeve që marrin pjesë në migracion, por nuk ka përfshirë grupin e familjeve që lëvizin brenda ose jashtë vendit në tërësi. Kjo është risia e tretë, që do të thotë, vlerësimi i numrit të personave që kanë ndryshuar vendbanimin me gjithë familjen.

Është me rëndësi të theksojmë se matjet novatore nuk mbulonin të gjithë familjen kur bëhej fjalë për imigrantët dhe të kthyerit. Në një farë mënyre, ky hendek informativ është plotësuar nga një tjetër pjesë e punës studimore e paraqitur në Raport në Rubrikën 7-9.

Në studimet e mëparshme të INSTAT-it për migracionin, analiza lidhur me gjithëpërfshirjen e tyre dhe strukturën e refuzimit për t'u përgjigjur tregonin mundësinë e veprimeve për të matur flukset dalëse migratore të familjes në tërësi. Kjo na lejoi të hartonim metodologjinë dhe instrumentin e kërkimit që qëndron në themel të studimit eksperimental të AMF-së 2019. Prezantimi i kësaj procedure në të ardhmen do të kërkonte një riorganizim të thellë të sistemit statistikor të popullsisë, që duhet parë me shumë kujdes. Sigurisht, ushtrimi i kryer nga ekspertët ka qenë i dobishëm, jo vetëm sepse është përfutur përvojë, por edhe sepse janë vërejtur disa mangësi e pasaktësi. Ne besojmë se studimi i vazhdueshëm në këtë fushë është me rëndësi, duke qenë se fluksi migrator (i brendshëm dhe i jashtëm) përfshin rreth gjysmën e anëtarëve të familjeve që largohen me gjithë familjen. Ky është përfundimi i nxjerrë nga shpërndarja e njëtrajtshme e flukseve midis familjeve migruese tërësisht ose pjesërisht për të gjithë periudhën 2011-2019.

Pasaktësitë e vërejtura në procesin e hartimit të AMF-së kanë të bëjnë kryesisht me mënyrat në të cilat janë vrojtuar rastet kur e gjithë familja ka migruar. Së dyti, do të ishte e këshillueshme që, në të ardhmen, të përkufizohej popullsia imigratore në një periudhë të dhënë, d.m.th. të përjashtohej ajo që është vendosur brenda harkut kohor të studimit. Ka gjasa që censi i vitit 2021 të ketë rezultate të ngjashme. Ekspertët e statistikave të popullsisë të cilët do të punojnë me rezultatet e censit mund të marrin parasysh konceptin e klasifikimit të ri të flukseve migratore të hartuar në AMF.

Konkluzioni i fundit metodologjik del nga cilësia e ulur e statistikave të përfutura nga matja e flukseve migratore të brendshme. Hipoteza e ngritur në fazën fillestare të punës studimore lidhur me mundësinë e përdorimit të rezultateve të studimit përfaqësues të kryer mbi një kampion të zgjeruar për përgatitjen e llogaritjeve të popullsisë duke përdorur një ekuacion balancues në nivel bashkie nuk mundi të zbatohet. Në një periudhë më afatgjatë, duket me vend që të merret parasysh rishikimi i dispozitave ligjore mbi përkufizimet e popullsisë kombëtare, me qëllim që të mund të shfrytëzohet në mënyrë më efikase bazat e të dhënave administrative.

Bibliografi

1. Eurostat, "Demographic statistics: a review of definitions and methods of collection in 44 European countries", (DOI): 10.2785/717072, 2015.
2. INSTAT, "Population_and_housing_census 2011", www.instat.gov.al/media/3058/main_results__population_and_housing_census_2011.pdf
3. INSTAT, "National Program of Statistics 2017-2021", www.instat.gov.al/media/3594/psz-2017-2021.pdf.
4. IOM, "Glossary on Migration", publications.iom.int/system/files/pdf/iml_34_glossary.pdf

PJESA II

Azilkërkuesit e kthyer Shqiptarë: Riintegrim apo Riemigrim?

Ilir Gëdeshi dhe Russell King

Përmbajtja

Figurat	55
Tabela	55
Falënderime	56
Shkurtime	57
Përmbledhje ekzekutive	58
1. Hyrje	60
2. Sfondi i migracionit shqiptar	62
3. Objektivi dhe metodologjia	65
4. Profili i të kthyerve që morën pjesë në grupet e fokusuar	66
5. Gjetjet nga intervistat në grupet e fokusuar	68
5.1 Migracioni nga Shqipëria	68
5.2 Përse azili?	68
5.3 Arsytet e migracionit	69
5.4 Kush migron?	72
5.5 Vendimet familjare	75
5.6 Vendet pritëse	77
5.7 Itineraret	78
6. Përvoja në vendin pritës	80
6.1 Strehimi	80
6.2 Të ardhurat	80
6.3 Kursimet	81
6.4 Dërgesat në para	82
6.5 Punësimi	84
6.6 Kujdesi shëndetësor	86
6.7 Arsimi	87
6.8 Kapitali i ri social	87
7. Kthimi dhe riintegrimi në vendin e origjinës	89
7.1 Arsytet e kthimit	89
7.2 Kthimi në atdhe	91
7.3 Riintegrimi	92

7.4	Punësimi	92
7.5	Strehimi	95
7.6.	Mbrojtja sociale	97
7.7	Kujdesi shëndetësor dhe ndihma psiko-sociale	98
7.8	Arsimi	100
8.	Synimet për të ardhmen	103
8.1	Format e emigrimit	105
8.2	Për ku?	106
9.	Përfundime dhe rekomandime	108
	Bibliografi	111

Figurat

Figura 1:	Vendet kryesore të emigracionit (përqindja e popullsisë banuese)	62
Figura 2:	Kurba e azilkërkuesve për herë të parë dhe prirja e përgjithshme (2010–2019)	63
Figura 3:	Shpërndarja e azilkërkuesve sipas vendeve të destinacionit, 2008–2018	77

Tabela

Tabela 1:	Numri i azilkërkuesve dhe përqindja e romëve (Gjermani), 2015–2016	61
------------------	--	----

Falënderime

Falënderimet tona të singerta u shkojnë shumë personave, të cilët na kanë ndihmuar për kryerjen e këtij studimi. Pikësëpari, falënderojmë posaçërisht qindra azilkërkues dhe të kthyer të cilët ofruan kohën dhe angazhimin e tyre gjatë proceseve të anketimit dhe intervistimit. Shpresojmë që ky studim të kontribuojë për të gjetur zgjidhje që do të ndihmojnë në përmirësimin e jetës së tyre dhe rritjes së zhvillimit ekonomik e shoqëror të Shqipërisë.

Ky raport studimor u bë i mundur me mbështetjen financiare të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM). Po kështu, do të dëshironim t'u shprehim mirënjohjen Alma Janit, Genci Pjetrit dhe Ermal Nazifit (IOM), si dhe Florenc Qoses e Luan Dervishajt (GIZ), për mbështetjen e madhe dhe komentet me vlerë gjatë fazave të ndryshme të studimit.

Përveç kësaj, i jemi mirënjohës ekipit që punoi së bashku me Qendrën për Studime Ekonomike e Shoqëror për ndihmën e dhënë në këtë studim: Ardiana Paca, Artan Gjolleha, Denisa Bogdani, Andia Haxhi, Eriona Bezatliu, Elisabeta Shatri, Vasilika Kura, Olsi Sherifi dhe shumë të tjerë. Ata mblodhën të dhënat sasiore e cilësore, pa të cilat studimi nuk do të ishte i mundur. Kontribut të posaçëm dha Stela Suloti, e cila punoi pa u lodhur me ekipin në terren. Bazat e të dhënave të anketës dhe zbardhjet e intervistave u bënë të mundura me ndihmën e Ramadan Sopotit, Nadire Xhaxhos dhe Rejhana Mucajt. Po kështu, dëshirojmë të falënderojmë Z. Gentjan Suli për përkthimin e studimit në anglisht dhe për sugjerimet e dobishme. Falënderimet tona shkojnë për Jenny Money për kontributin në redaktim dhe formatim, si dhe për kontrollin e referencave të përdorura në këtë studim.

Autorët

Ilir Gëdeshi është Drejtor i Qendrës së Studimeve Ekonomike dhe Shoqërore, Tiranë, Shqipëri

Russell King është profesor gjeografie në Universitetin e Sussex-it, Brighton, Mbretëria e Bashkuar

Shkurtime

BE	Bashkimi Evropian
EASO	Zyra Evropiane e Mbështetjes për Azilin
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
INSTAT	Instituti shqiptar i statistikave
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
OJF	Organizata joqeveritare
PBB	Produkti i brendshëm bruto
PNUD	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
QESSh	Qendra për Studime Ekonomike dhe Shoqërore
SVE	Studimi i Vlerave Evropiane
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar i Emergjencave i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

Përmbledhje ekzekutive

Që në fillim të viteve '90, migracioni ndërkombëtar dhe ndikimi i tij ekonomik, politik e shoqëror mbetet çështje thelbësore në Shqipëri. Shqipëria është mes vendeve kryesore në botë për shkallën dhe intensitetin e migracionit ndërkombëtar. Ndërkohë, kërkimi i azilit është një dukuri relativisht e re për vendin dhe ka nisur të raportohet në statistikat evropiane qysh prej fillimit të udhëtimit pa viza në zonën e Shengenit. Nga viti 2010 deri në shtator të vitit 2019, rreth 193 000 shtetas shqiptarë u regjistruan si azilkërkues për herë të parë në vendet e BE-së. Dukuria arriti pikën kulmore në vitin 2015, kur kërkuan azil rreth 67 000 shtetas shqiptarë, për t'u ulur më tej, si rezultat i procedurave të përshpejtuara të shqyrtimit të kërkesave të azilit, rregullave më rigorozë të migracionit dhe normave më të ulëta të pranimit.

Raporti, për të cilin janë përdorur kryesisht teknika cilësore (diskutime në grupe të fokusuara dhe intervista) duke mbuluar të gjitha qarqet e Shqipërisë, përpiket të japë një shpjegim më të mirë të dinamikave të kthimit dhe integritit me të cilat përballen migrantët gjatë kthimit dhe riintegritit në raport me shëndetin, arsimimin, strehimin, punësimin dhe shërbime të tjera. Ai merr në analizë profilin e azilkërkuesve shqiptarë, faktorëve shtytës, historikun dhe përvojën e migracionit, kthimit dhe riintegritit, si dhe ofron disa rekomandime për politika.

Studimi tregon se ky segment i popullsisë migratore është nga më të varfrit në Shqipëri, renditur në fund të shkallës së të ardhurave familjare, por, ndryshe nga disa vende të tjera të Ballkanit Perëndimor, nuk është një karakteristikë e theksuar e pakicës romë.¹ Struktura socio-demografike e këtij grupi tregon qartë se anëtarët e tij janë kryesisht të rinjtë, të papunët, ata me nivel më të ulët arsimor e profesional sesa popullsia e përgjithshme, që janë në kërkim të një mundësive më të mira për vete e, sidomos, për fëmijët e tyre.

Ky studim tregon se kushtet ekonomike – përfshi varfërinë, papunësinë dhe nën-punësimin, të ardhurat e ulëta nga sektorët formalë e joformalë, kushtet e vështira të jetesës mbrojtja e kufizuar sociale dhe borxhet – janë faktorët kryesorë shtytës për azilkërkuesit shqiptarë. Përveç këtyre faktorëve bazë, një tjetër shtytës është e ardhmja e fëmijëve të tyre. Përveç tyre, ka edhe të tjerë faktorë, si mangësitë dhe cilësia e ulët e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, strehimi, konfliktet dhe siguria fizike që shkaktojnë stres të vazhdueshëm psikologjik, përfshi cilësinë e ulët të arsimit (për të thënë disa prej tyre). Për disa nëngrupe (p.sh. romët dhe egiptianët), një faktor shtesë është diskriminimi.

Kthimi i azilkërkuesve shqiptarë – sa i takon madhësisë dhe intensitetit, gjatë disa viteve (2015-2017), Shqipëria kryesonte listat e vendeve për numrin e të kthyerve nga vendet e BE-së,² - ka çuar në riintegrimin e tyre sa i takon punësimit, shëndetit, strehimit, arsimit dhe shërbimeve sociale. Raporti tregon se, për shumë familje dhe individë, riintegrimi nuk ka qenë i qëndrueshëm, sidomos në aspektin ekonomik e shoqëror dhe situata e tyre nuk kishte ndryshuar (përkundrazi, në disa raste, ishte përkeqësuar) krahasuar me periudhën përpara migracionit. Si rezultat, të përballur me mungesën e ndihmës së qëndrueshme për riintegrim, shumë të kthyer e shohin riemigrimin apo emigrimin e dytë drejt vendeve të BE-së, kryesisht Gjermanisë, si alternativën e vetme që kanë.

Studimi tregon se shumica e të kthyerve kërkojnë të migrojnë rregullisht përmes një kontrate pune dhe vize. Vetëm një numër i vogël pohojnë se do të aplikojnë sërish për azil. Në këtë rast, autoritetet vendore dhe OJF të ndryshme që ofrojnë shërbime, përveç rritjes së mbështetjes së tyre për riintegrimin, duhet të punojnë për të rritur ndërgjegjësimin se kërkesa e përsëritur për azil nuk është zgjidhje për problemet e tyre dhe vetëm sa përkeqëson kushtet e tyre ekonomike.

Përmirësimi i shërbimeve në arsim, kujdes shëndetësor, mbrojtje sociale, strehim, siguri etj. do të kërkonte kohë, më

1 Grupi i Bankës Botërore (2019) *Mbështetja e riintegritit efektiv të të kthyerve romë në Ballkanin Perëndimor*. Washington DC: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Banka Botërore.

2 Grupi i Bankës Botërore (2019) *Mbështetja e riintegritit efektiv të të kthyerve romë në Ballkanin Perëndimor*. Washington DC: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Banka Botërore; Morrica, V. dhe Stavrou, S. (2018) Prezantim PowerPoint në Seminarin prezantues, 'Mbështetja e riintegritit efektiv të të kthyerve (romë) në Ballkanin Perëndimor'. Vjenë, më 15 janar.

shumë investime dhe së paku, një dyfishim të përqindjes së tyre në PBB-në e vendit. Ky objektivi, që do të ulë numrin e disa faktorëve shtytës për migracionin shqiptar, mund të arrihet vetëm për një periudhë afatgjatë. Në vijim, studimi paraqet vetëm disa rekomandime afatshkurtra e afatmesme të përshkruara në vijim.

Së pari, regjistrimi i azilkërkuesve të kthyer dhe mbledhja e të dhënave. Për ta bërë këtë, mund të ngrihet një sistem i menaxhimit të informacionit, i cili mbledh të dhëna elektronike, i vë të kthyerit në kontakt me institucionet përkatëse që ofrojnë shërbimet dhe ndjekin ecurinë e tyre në procesin e riintegrit. Ky sistem që duhet të përcjellë të dhënat njëkohësisht në nivelin qendror e lokal do të krijojë mundësinë për të monitoruar dhe matur efektivitetin e politikave dhe programeve të riintegrit.

Forcimi i kapaciteteve lokale për ofrimin e shërbimeve, sidomos në bashkitë ku ka numër të lartë të të kthyerve, është një tjetër aspekt. Kjo mund të arrihet përmes trajnimit të vazhdueshëm të personelit të ofruesve vendorë të shërbimeve, hartimit të planeve vendore të riintegrit dhe parashikimit të fondeve në buxhetet përkatëse, si dhe përmirësimit të bashkërendimit nga lart poshtë (me qeverinë qendrore) dhe bashkërendimit horizontal (me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të që punojnë me të kthyerit). Në disa raste (sidomos në ato bashki ku ka numër të lartë të të kthyerve), mund të krijohen ekupe ndërsektoriale me përfaqësues nga zyrat e punësimit, ndihma ekonomike, kujdesi social, zyrat arsimore, policia, OJF-të lokale e ndërkombëtare, punonjës socialë e psikologë, për të ndihmuar në riintegrimin e të kthyerve.

Nga këndvështrimi ekonomik, ri-integrimi në Shqipëri do të kërkonte përmirësim dhe zgjerim të strukturës së punësimit dhe mundësive të biznesit të vogël, me qëllim që të sigurohet punë për të kthyerit në sektorin formal dhe të ardhura më të larta. Krijimi i kooperativave ose ndërmarrjeve sociale për të kthyerit (si edhe për qytetarë të tjerë) do të ishte një rrugë efektive për krijimin e vendeve të reja të punës, kryesisht në prodhim dhe përpunim. Një tjetër mundësi punësimi dhe të ardhurash më të larta do të ishte ndihma për fillimin e një biznesi dhe zgjerimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme (përmes trajnimeve për menaxhim, sigurimit të burimeve financiare, formimit profesional etj.).

Fëmijët e kthyer duhet të ndihmohen për t'u riintegruar në sistemin shkollor. Kjo përfshin së pari regjistrimin e menjëhershëm në shkollë, në mënyrë që të mos e humbasin atë vit shkollor. Duhet zbatuar procedura të thjeshtuara për të ulur shpenzimet e familjeve të kthyer për përkthimin dhe noterizimin e dokumenteve shkollore për fëmijët. Në ato raste kur fëmijët e kthyer nuk disponojnë asnjë dokument shkollor, ata duhen ndihmuar me orë mësimi shtesë nga mësues me përvojë, përpara se të kryejnë testin vlerësues, në mënyrë që të mos e humbasin vitin shkollor. Fëmijët që nuk kanë njohuri të mjaftueshme të gjuhës shqipe duhen ndihmuar nga mësues me përvojë pas orëve rregullta të mësimi, ose në shkollë, ose në mjedise të tjera. Psikologët e shkollave dhe drejtorët duhet t'u kushtojnë vëmendje shtesë fëmijëve të kthyer për shqetësimet e mundshme që kanë. Mbatja e kontaktit sistematik me prindërit e tyre, në shkollë ose në shtëpi, duhet të jetë një praktikë e zakonshme. Shumë fëmijë të kthyer që kanë ndjekur kurse gjuhe ose shkollën për një apo dy vjet në vendet pritëse (Gjermani, Francë) flasin rrjedhshëm gjermanisht apo frëngjisht. Është e rëndësishme që ata t'i ruajnë dhe zhvillojnë më tej aftësitë e fituara gjuhësore përmes kurseve shtesë në shkollë apo diku tjetër. OJF-të lokale dhe ndërkombëtare mund të luajnë rol në këtë drejtim.

Në fushën e kujdesit shëndetësor, të kthyerit që kanë marrë trajtim në vendin pritës ose kanë probleme shëndetësore duhet të jenë në gjendje ta vazhdojnë mjekimin në spitale të specializuara publike ose private. Ndihma financiare, në këtë rast, duhet të ofrohet nga institucionet shëndetësore publike apo OJF-të që ofrojnë shërbime për të kthyerit. Në disa bashki ku ka mungesa personeli të kujdesit shëndetësor mund të dërgohen ekupe të specializuara mjekësh nga Tirana për raste specifike. Duhet të ofrohet ndihmë e posaçme për shëndetin mendor të të kthyerve (sidomos të grave, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuar, grupeve të diskriminuara), të cilat mund të kenë përjetuar stres psikologjik të vazhdueshëm, ankth dhe traumë gjatë qëndrimit të tyre në vendin pritës dhe në kthim.

Lidhur me strehimin, të kthyerit mund të ndihmohen financiarisht për një periudhë të caktuar kohe nga bashkia apo OJF-të që merren me çështjet e riintegrit për të mbuluar qiranë apo riparuar shtëpitë e tyre. Në raste të tjera, të kthyerit që janë të pastrehë apo jetojnë në kushte të vështira duhet të ndihmohen për të përgatitur dokumentacionin përkatës për t'u kualifikuar për strehim social.

I. Hyrje

Ky studim mbështetet mbi analizën e intervistave dhe diskutimeve në grupin e fokusuar zhvilluar me azilkërkues shqiptarë të kthyer nga vendet e BE-së, që jetojnë në 12 qarqet e Shqipërisë, si dhe mbi intervistat me informues kyç në qarqet e Shkodrës, Kukësit dhe Elbasanit, duke qenë se, sipas IOM-it, këto janë rajonet me numrin më të lartë të azilkërkuesve të kthyer.

Në literaturën gjithnjë e më të madhe për migracionin shqiptar, azili është dukuri e re që nuk është studiuar gjerësisht. E raportuar në statistikat evropiane qëkur shqiptarët nisën të udhëtonin pa viza në zonën e Shengenit,³ dukuria u bë më e dukshme në vitin 2012, për të arritur kulmin në 2015, me afro 67 000 shtetas shqiptar që kishin paraqitur kërkesë për azil, kryesisht në Gjermani. Më vonë, prirja shënoi rënie, si rezultat i procedurave të përsheptuara të aplikimit, rregullave më të rrepta të migracionit dhe normave më të ulëta të pranimit.⁴ Pavarësisht luhatjeve gjithsej në periudhën midis vitit 2010 dhe shtatorit 2019, një numër prej 193 000 shtetasish shqiptarë⁵ aplikuan për herë të parë për azil në vendet e BE-së. Në vitin 2015, Shqipëria ishte mes vendeve kryesore (e katërta pas Republika Arabe e Sirisë, Afganistanit dhe Irakut) për nga numri i azilkërkuesve.⁶ Megjithatë, statistikat e BE-së tregojnë se, në vitin 2018, vendet pritëse pranuan vetëm 2,1 për qind të kërkesave për azil nga shtetasit shqiptarë. Pjesa tjetër janë kthyer ose pritët se do të kthehen në të ardhmen e afërt.⁷ Për tre vjet, 2015–2017, Shqipëria kryesonte listën e vendeve për nga numri i të kthyerve nga vendet e BE-së.⁸ Disa azilkërkues aplikuan edhe dy apo tri herë të tjera për azil në vende të ndryshme të BE-së pas kthimit në vendin e tyre (kryesisht romë dhe grupi i të ashtuquajturve egjiptianë), duke u shndërruar kështu në një grup që as nuk është i riintegruar në vendin e origjinës, as i pranuar në vendin pritës.

Disa prej azilkërkuesve shqiptarë janë nga komunitetet rome dhe egjiptiane. Është e vështirë të kesh shifra të sakta për ta dhe përqindjen e tyre në numrin e përgjithshëm të azilkërkuesve, duke qenë se të dhënat mbi etninë e të kthyerve nuk mblidhen në pikat e kalimit kufitar dhe kur kthehen.⁹ Gjermania, vendi i vetëm i BE-së që ofron të dhëna për etninë e azilkërkuesve, raportoi në vitin 2011 se rreth 11 për qind e azilkërkuesve shqiptarë ishin romë dhe egjiptianë dhe 84 për qind vinte nga shumica e popullsisë shqiptare.¹⁰ Në një botim të mëparshëm, Zyra Evropiane e Mbështetjes për Azilin (EASO) vlerësoi se romët përfaqësonin 6–10 për qind të fluksit azilkërkues në Gjermani, çka tregon se përmasat dhe intensiteti i migracionit të romëve dhe egjiptianëve nga Shqipëria ishte rritur dhe se ishin të mbipërfaqësuar në popullsinë e migrantëve nga Shqipëria.¹¹ Përqindja e flukseve azilkërkuese rome dhe egjiptiane nga Shqipëria është qartësisht më e lartë sesa përqindja e tyre në raport me popullsinë e përgjithshme të vendit (më pak se 2 %).¹² Kjo tregon faktorë

3 Që nga fundi i dhjetorit 2008, shtetasit shqiptarë duhet të zotërojnë një pasaportë biometrike për të udhëtuar pa vizë në zonën e Shengenit. Për më tepër, sipas regjimit pa vizë, një shtetas mund të qëndrojë në zonën e Shengenit deri në 90 ditë brenda një afati 180-ditor, duke vendosur kufizime e ushtruar trysni mbi migrantët që do të preferonin të qëndronin më gjatë në vendin pritës. Për më shumë informacion, shih: 'Agreement between the European Community and the Republic of Albania on the facilitation of the issuance of visas' në [http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX:22007A1219\(05\)&qid=1395933714988](http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX:22007A1219(05)&qid=1395933714988).

4 Schuring, E., Pearson, C., Castro, A., Mathebula, B., Kronenberg, V., Becker, M. and Horneber, J. (2017) *Social Protection as an Alternative to Migration? An Assessment of the Role of Social Protection in Reducing Push Factors for Migration in Different Country Contexts*. Berlin: Gesellschaft für Versicherungswissenschaft und -Gestaltung e.v.

5 EASO (2019) Raporti vjetor për situatën e azilit në Bashkimin Evropian 2018. Valeta: Zyra Evropiane e Mbështetjes për Azilin.

6 OECD (2019) *International Migration Outlook 2019*. Paris: OECD Publishing.

7 WorldData info (www.worlddata.info/europe/albania/asylum.php).

8 World Bank Group (2019) *Mbështetja e riintegritetit efektiv të të kthyerve romë në Ballkanin Perëndimor*. Washington DC: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Banka Botërore. Morrica, V. dhe Stavrou, S. (2018) Prezentim PowerPoint në Seminarin prezantues, 'Mbështetja e riintegritetit efektiv të të kthyerve (romë) në Ballkanin Perëndimor'. Vjenë, më 15 janar.

9 World Bank Group (2019) *Mbështetja e riintegritetit efektiv të të kthyerve romë në Ballkanin Perëndimor*. Washington DC: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Banka Botërore.

10 EASO (2015a) *Aplikuesit për azil nga Ballkani Perëndimor. Analizë krahasuese e prirjeve, faktorët tërheqës dhe shtytës dhe përgjigjet – Përditësim*. Bruksel, Zyra Evropiane e Mbështetjes për Azilin.

11 EASO (2013) *Aplikuesit për azil nga Ballkani Perëndimor. Analizë krahasuese e prirjeve, faktorët tërheqës dhe shtytës dhe përgjigjet – Përditësim*. Bruksel, Zyra Evropiane e Mbështetjes për Azilin.

12 Nuk ka të dhëna të sakta mbi numrin e romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri. Në tetor 2011, censi në Shqipëri përfshiu për herë të parë pyetjen për etninë. Të dhënat nga censi i 2011 tregojnë se popullsia rome në Shqipëri ishte 8 301 banorë ose 0,3 e popullsisë së shumicës dhe popullsia egjiptiane ishte 3 368 banorë ose 0,12 për qind e popullsisë së shumicës (INSTAT (2012a) *Shqipëri. Rezultatet paraprake të censit të popullsisë dhe banesave 2011*, Tiranë. INSTAT (2015a) *Romët dhe egjiptianët në Shqipëri: një profil socio-demografik dhe ekonomik bazuar në Censin 2011*, Tiranë. Shoqatat e romëve dhe egjiptianëve dhe disa ekspertë argumentuan se të tilla të dhëna janë të dyshimta. Një projekt i UNICEF-it (2011), i zbatuar thuajse njëkohësisht me censin, tregoi se në Shqipëri jetonin rreth 14 564 romë (0,5 për qind e popullsisë së shumicës) në 3 139 familje në 108 vendbanime (për më shumë

shtytës më të fortë për të migruar për ta, të cilat do të shtellohen në rubrikat në vijim. Megjithatë, pavarësisht përqindjes së lartë të popullsisë rome dhe egjiptiane në numrin e përgjithshëm të azilkërkuesve nga Shqipëria, këto flukse nuk kanë një natyrë theksuar rome/egjiptiane si në vende të tjera të Ballkanit (Serbia, Maqedonia e Veriut, Bosnje-Hercegovina), ku përfaqësojnë mbi 50 për qind të azilkërkuesve.¹³ Tabela 1 paraqet përqindjen e romëve në numrin e azilkërkuesve nga Ballkani Perëndimor në Gjermani në vitet 2015 dhe 2016, kur u shënuar rritja kulmore.

Ka shumë pikëpyetje që rrethojnë dukurinë e azilkërkimit shqiptar, të cilave do të përpiqemi t'u përgjigjemi në rubrikat vijuese të studimit. Disa prej këtyre pyetjeve janë: Përse kërkojnë azil shqiptarët në vend të migracionit të rregullt në vendet e BE-së? Cili është profili i azilkërkuesve shqiptarë dhe çfarë i dallon nga migrantët e rregullt? Cilat janë shkaqet dhe historiku i migracionit dhe kthimit? A funksionon riintegrimi dhe (në mungesë të tij), cila është alternativa që zgjedhin të kthyerit? Përgjigjet e këtyre pyetjeve duhet të përbëjnë bazën e politikave efikase, që riintegrimi i të kthyerve të jetë i qëndrueshëm.

Tabela 1: Numri i azilkërkuesve dhe përqindja e romëve (Gjermani), 2015–2016

Vendet	Viti	Të gjithë azilkërkuesit	Azilkërkuesit romë	
			Numri	Përqindja
Shqipëria	2015	54 762	3 118	5,7
	2016	17 236	1 116	6,5
Bosnje-Hercegovina	2015	7 473	3 979	53,2
	2016	3 190	1 827	57,3
Kosova ¹⁴	2015	37 095	4 758	12,8
	2016	6 490	1 744	26,9
Maqedonia e Veriut	2015	14 131	8 284	58,6
	2016	7 015	4 334	61,8
Mali i Zi	2015	3 635	735	20,2
	2016	1 630	431	26,4
Serbia	2015	26 945	23 338	86,6
	2016	10 273	8 484	82,6

Burimi: World Bank Group (2019) Mbështetja e riintegritit efektiv të të kthyerve romë në Ballkanin Perëndimor. Washington DC: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Banka Botërore

Studimi është organizuar në rubrika e nënrubrika. Ka tri rubrika paraprake. Pas kësaj hyrjeje (Rubrika 1) dhe një panorame të përgjithshme të kontekstit të migracionit shqiptar që është në themel të flukseve të azilit (Rubrika 2), ne shpjegojmë metodologjinë kërkimore dhe teknikën që kemi përdorur (Rubrika 3). Rubrika 4 ofron një profilizim socio-ekonomik dhe demografik të azilkërkuesve shqiptarë. Në Rubrikën 5, ne përqendrohemi posaçërisht te faktorët shtytës, shkaqet historiku dhe mënyrat e arritjes në vendin pritës. Rubrika 6 trajton përvojën në vendin pritës. Në Rubrikën 7, vëmendja kryesore përqendrohet te kthimi dhe riintegrimi i të kthyerve në Shqipëri dhe shqyrton punësimin/papunësinë, formimin profesional, arsimin, kujdesin shëndetësor, strehimin, mbrojtjen sociale, dokumentet zyrtare etj. Rubrika 8 trajton dilemat kryesore të të kthyerve, që gjenden midis riintegritit dhe riemigrimit. Rubrika 9 paraqet gjetjet dhe përfundimet kryesore, si dhe disa rekomandime për politikëbërësit.

informacion, shih: Gëdeshi, I. dhe Jorgoni, E. (2012) *Mapping Roma Children in Albania*. New York: UNICEF). Në vitin 2014, një studim i Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë vlerësoi se në Shqipëri jetonin rreth 18 276 (për më shumë informacion, shih Fondacion Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (2014), *Censi i banesave dhe popullsisë rome në Shqipëri*. Tiranë: Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë). Pavarësisht ndryshimeve në të dhëna, popullsia rome dhe egjiptiane nuk është më e madhe sesa 2 për qind e popullsisë së shumicës.


13 Përbërja etnike e azilkërkuesve nga Serbia dhe, në shkallë më të ulët, nga Maqedonia e Veriut dhe Bosnje-Hercegovina tregon se ata janë kryesisht nga komuniteti rom (për më shumë informacion, shih: World Bank Group (2019) *Mbështetja e riintegritit efektiv të të kthyerve romë në Ballkanin Perëndimor*. Washington DC: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Banka Botërore; EASO (2013) *Aplikuesit për azil nga Ballkani Perëndimor. Analizë krahasuese e prirjeve, faktorët tërheqës dhe shtytës dhe përgjigjet – Përditësim*. Bruksel, Zyra Evropiane e Mbështetjes për Azilin, pp. 21–25)

14 Referencat për Kosovën do të kuptohet se janë në kontekstin e rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

2. Sfondi i migracionit shqiptar

Afro tri dekada pas fillimit të tranzicionit post-socialist, migracioni ndërkombëtar dhe ndikimet e tij ekonomike, politike dhe sociale mbeten një çështje thelbësore në Shqipëri. Aktualisht, më shumë se 1,5 milionë shtetas shqiptarë, më shumë sesa gjysma e popullsisë së vendit, kanë emigruar kryesisht në Itali dhe Greqi dhe në një shkallë më të ulët, në ShBA, Mbretërinë e Bashkuar dhe Gjermani.¹⁵ Këto shifra e renditin Shqipërinë mes vendeve të para në botë për shkallën (si përqindje e popullsisë aktuale) dhe intensitetin e migracionit ndërkombëtar. Në botimin e saj periodik, “Raport mbi migracionin dhe dërgesat”, Banka Botërore e rendit Shqipërinë mes 20 vendeve të para në botë (vendi i nëntë në 2011¹⁶ dhe i 17-të në vitin 2016¹⁷).¹⁸

Figura 1: Vendet kryesore të emigracionit (përqindja e popullsisë banuese)



Burim: Banka Botërore (2016a) Raporti për migracionin dhe remitancat 2016. Washington DC: Banka Botërore.

Secila prej tri dekadave të migracionit shqiptar ka pasur intensitetin e saj specifik e karakteristika dalluese. Në dekadën e parë, migracioni ishte mjaft intensiv, spontan dhe i parregullt. Ai përbëhej kryesisht nga meshkuj në moshë të re në kërkim të punës dhe që përpqeshin t'u shpëtonin pasojave të reformave drastike të tranzicionit, si dhe kaosit politik e shoqëror gjatë këtyre viteve në Shqipëri. Në fund të kësaj dekade, skemat e legalizimit, së pari në Itali e më vonë në Greqi, i lejuan shumë migrantë ta formalizonin situatën e tyre dhe të merrnin me vete familjarët e tyre në vendin pritës. Në fund të viteve '90, vlerësohej se rreth 800 000 shqiptarë jetonin e punonin jashtë, kryesisht në Greqinë e Italinë fqinje.¹⁹

Dekada e dytë e migracionit shqiptar u karakterizua nga pjekuria e ciklit migrator. Procesi i legalizimit të imigrantëve shqiptarë në vendet pritëse, që nisi në fund të viteve '90, u ndoq nga bashkimi familjar, integrimi dhe përmirësimi i

15 Republika e Shqipërisë, Këshilli i Ministrave (2018), *Strategjia Kombëtare e Diasporës dhe Migracionit 2018–2024 dhe Plani i Veprimit*, Tiranë, Këshilli i Ministrave.

16 Banka Botërore (2011), *Raporti për migracionin dhe dërgesat në para 2011*, Washington DC, Banka Botërore.

17 Banka Botërore (2016a), *Raporti për migracionin dhe dërgesat në para 2016*, Washington DC, Banka Botërore.


18 Nëse i shohim me kujdes këto renditje, konstatojmë se shumica e vendeve të renditura më lart se Shqipëria në botimin e Bankës Botërore 2016 (Monako, Dominika, Antigua-Barbuda, Guajana, Samoa, Sint Maarten, St Vincent dhe Grenadinet, Grenada, Tonga, St Kitts-Nevis, Kuracao, Surinam), me përjashtim të dy vendndodhjeve (Bregu Perëndimor dhe Gaza, 4 milionë dhe Puerto Riko, 3.2 milionë), kishin popullsi më të vogël (më pak se 1 milion) dhe një historik të gjatë migracioni. Ndërkohë, dy vende të Ballkanit Perëndimor, Bosnje-Hercegovina dhe Mali i Zi, renditen më sipër Shqipërisë, pasi, për këto vende, pjesë e migracionit ndërkombëtar mund të konsiderohet gjithashtu si migracion i brendshëm, brenda ish-Jugosllavisë.

19 Barjaba, K. (2000) Contemporary patterns in Albanian migration. *South-East Europe Review*, 3(2): 57–64.

statusit ekonomik e shoqëror i imigrantëve. Flukset vazhduan, por, si rrjedhojë e një qëndrueshmërie më të madhe ekonomike në Shqipëri dhe për shkak të shkallës së lartë të të larguarve në vitet '90, me intensitet më të ulët, pa episode ekstreme dhe ishin kryesisht legal. Edhe pse Greqia dhe Italia mbeten dy vendet kryesore pritëse për migrantët shqiptarë, gjeografia e destinacionit u diversifikua, duke përfshirë vende të tjera evropiane dhe të Amerikës së Veriut.²⁰

Dekada e tretë e emigracionit u karakterizua nga një intensitet i përsëritur dhe diversifikim i flukseve ndërkombëtare migratore, i cili mori tipare dhe destinacione të reja. Kulmi i këtyre flukseve arriti në vitin 2015, kur rreth 67 000 u regjistruan si azilkërkues në vendet e BE-së (kryesisht, në Gjermani), për të rënë më tej, pas pranimi të një numri të vogël kërkesash (Figura 2).²¹ Kthimi i migrantëve shqiptarë, kurba e kthimit të të cilëve arriti kulmin në vitet 2010–2013 (kriza greke) dhe në 2016–2017 (kërkesat e refuzuara nga Gjermania), ishin një tjetër karakteristikë e këtij dhjetëvjeçari. Ndërkohë, u vu re gjithashtu një lloj fluksi refugjatësh (sirianë, iranianë, afganë etj.), që u përpoqën ta shfrytëzonin Shqipërinë si kalim tranzit drejt vendeve të BE-së.²² Kështu, dekada e tretë e migracionit shqiptar karakterizohet nga kombinimi i këtyre tri flukseve (emigracion, kthim, imigracion).

Figura 2: Kurba e azilkërkuesve për herë të parë dhe prirja e përgjithshme (2010–2019)



Burimi: EASO (2019).

Shënim: Figura tregon se numri i azilkërkuesve shqiptarë, sidomos pas vitit 2016, është paksa më i lartë sesa ai i azilkërkuesve për herë të parë, çka tregon se disa prej tyre kanë aplikuar dy ose tri herë.

Këto flukse të rigjallëruara të migracionit janë shprehje e potencialit të lartë migrator të popullsisë shqiptare, i cili është rritur gjatë viteve të fundit. Një studim i vitit 2018 mbi migracionin e mundshëm zbuloi se 52 për qind e shqiptarëve të grupmoshës 18–40 vjeçe dëshironin të migronin jashtë Shqipërisë. Krahësuar me një anketë të ngjashme të zhvilluar më parë nga Fondacioni Evropian i Trajnimeve (ETF) në vitin,²³ studimi i vitit 2018 tregon se dëshira e popullsisë shqiptare për të migruar është rritur me 8 pikë përqindje në 11 vjet dhe se karakteristikat kanë ndryshuar krejtësisht. Në vitin 2007, shumica e atyre që dëshironin të migronin ishin të papunë, të pakualifikuar dhe me arsim të ardhura të ulëta.²⁴ Në të kundërt, ata që dëshirojnë të migrojnë aktualisht kanë një punë, janë të kualifikuar e të arsimuar dhe, sipas standardeve shqiptare, kanë të ardhura të mesme dhe të larta. Përveç këtyre tipareve, gjeografia e destinacioneve të dëshiruara ka ndryshuar po ashtu. Ndërkohë që në vitin 2007 shqiptarët ishin më të prirur të emigronin në Itali e Greqi, tashmë ata dëshirojnë të emigrojnë në Gjermani dhe ShBA. Ekonomia vijoi të mbizotëronte te faktorët shtytës në vitin 2018 (56 %), edhe pse në shkallë më të ulët sesa në vitin 2007 (65 %). Përveç kësaj, janë shfaqur faktorë të rinj, si 'dëshira për të shkolluar fëmijët' (12 %) dhe se 'nuk ka të ardhme' në Shqipëri (11 %).²⁵ Këto të dhëna konfirmohen edhe nga anketa botërore e Gallup, që e vlerëson potencialin migrator nga Shqipëria në 56 për qind për periudhën 2013–2016. Për më tepër, duke vërtetuar të dyja periudhat (2013–2016 kundrejt 2010–2012) dhe krahasuar me 20

20 King, R. (2003) Across the sea and over the mountains: documenting Albanian migration. *Scottish Geographical Journal*, 119(3): 283–309.

21 Eurostat News release (2016) Azili në shtetet anëtare të BE-së: numër rekord me mbi 1,2 milionë azilkërkues për herë të parë regjistruar në 2015, *Eurostat News release*, 4 mars.

22 Republika e Shqipërisë, Këshilli i Ministrave (2018) *Strategjia Kombëtare e Diasporës dhe Migracionit 2018–2024 dh Plani i Veprimit*.

23 Fondacioni Evropian i Trajnimit (2017), *Kontributi i zhvillimit të burimeve njerëzore në politikën e migracionit në Shqipëri*. Torino: ETF.

24 Sabadie, J.A., Avato, J., Bardak, U., Panzica, F. dhe Popova, N. (2010) *Migration and Skills. The Experience of Migrant Workers from Albania, Egypt, Moldova, and Tunisia*. Washington DC: Banka Botërore; Fondacioni Evropian i Trajnimit (2007) *Kontributi i zhvillimit të burimeve njerëzore në politikën e migracionit në Shqipëri*. Torino: ETF.

25 Gëdeshi, I. dhe King R. (2018) *Prirjet e reja në migracionin e mundshëm nga Shqipëria*. Tiranë: Fondacioni "F. Ebert"; King, R. dhe Gëdeshi, I. (2019) *New trends in potential migration from Albania: the migration transition postponed? Migration and Development*. Marrë në janar 2020 nga www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/21632324.2019.1608099?journalCode=rmad20.

vendet e tjera të renditura në krye në nivel global, Shqipëria ka parë rritjen më të madhe të migracionit të mundshëm (+20 pikë).²⁶

Ky ndryshim sasior dhe cilësor i migracionit real e të mundshëm nga Shqipëria gjatë dhjetëvjeçarit të fundit ngre pyetje të rëndësishme mbi shkaqet në themel të rishfaqjes së kësaj dukurie. Këto mund të shpjegohen kryesisht përmes faktorëve të jashtëm (kriza ekonomike greke, kërkesa për krah pune nga Gjermanisë), por është gjithashtu e nevojshme që të kryhet një analizë e plotë e faktorëve të brendshëm. Për këtë qëllim, ne paraqesim disa prirje ekonomike të përgjithshme që mund të mbështetin në nivel makro fluksin e rritur të migracionit. Në studimin tonë, kemi përmendur gjithashtu shkaqe të tjera që i shtyjnë shqiptarët të migrojnë.

Në grupin e faktorëve të brendshëm, kushtet ekonomike kanë qenë sigurisht kryesoret përgjatë tri dekadave të migracionit shqiptar. Kriza ekonomike globale që nisi në gjysmën e dytë të vitit 2008 pati në ndikim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në ekonominë shqiptare.²⁷ Pasoja e parë ishte ngadalësimi i ritmit të ekonomisë dhe rritje e papunësisë. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, në periudhën 2009–2017, rritja mesatare e PBB-së në Shqipëri ra në 2,6 për qind, nga 5,7 për qind në periudhën 2000–2008.²⁸ Ndërkohë, norma zyrtare e papunësisë u rrit në 17,5 për qind në vitin 2014 (32,5 për qind për grupmoshën 15–29 vjeçe)²⁹, nga 13 për qind në vitin 2008 dhe ra sërish në 12,3 për qind në vitin 2018 (28,3 për qind për segmentin 15–24 vjeç).³⁰

Përveç kësaj, kriza ekonomike globale uli me një të tretat dërgesat në para nga emigrantët shqiptarë, që kanë qenë nga kontribuueset kryesore për zbutjen e gjendjes së varfërisë në shumë familje shqiptare. Ndërsa në vitin 2007 dërgesat arritën kulmin me 952 milionë euro, që përbënin 12,3 për qind të PBB-së, në vitin 2015, ato ranë në 597 milionë euro ose 5,8 për qind të PBB-së.³¹ Kjo, nga ana tjetër, kontribuoi për rritjen e shkallës së varfërisë në familjet shqiptare, një fenomen që ishte thujse përgjysmuar në periudhën 2000–2008.³²

Ndërkohë, emigracioni ndërkombëtar sezonal dhe afatgjatë, kryesisht në Greqi dhe Itali, që kishin qenë një mekanizëm kyç për familjet shqiptare që të përballonin varfërinë gjatë dy dekadave të para, nuk mund ta luante më këtë rol. Normat e larta të papunësisë së emigrantëve shqiptarë në këto dy vende pritëse (24,7 për qind në Greqi dhe 12,1 për qind në Itali në vitin 2010) ngadalësuan flukset e reja migratore.³³ Për rrjedhojë, lindi një situatë e re paradoksale. Nga njëra anë, faktorët shtytës të emigracionit në Shqipëri u shtuan, ndërsa, nga ana tjetër, kanalet tradicionale të emigracionit u ngushtuan. Në vijim, migracioni i mundshëm i popullsisë shqiptare nën efektin e krizës ekonomike globale, në mungesë të zgjidhjeve të brendshme dhe duke pasur parasysh perceptimin e njerëzve për të ardhmen e tyre, pati rritje.

Faktorët ekonomikë dhe hendeku i madh në të ardhura me ekonomitë e përparuara në BE dhe Amerika e Veriut nuk janë faktorët e vetëm që shpjegojnë dëshirën e njerëzve për të migruar nga Shqipëria. Të dhënat e anketës EVS³⁴ për Shqipërinë tregojnë se njerëzit në përgjithësi dhe migrantët e mundshëm janë të pakënaqur me sistemin arsimor, të sigurimeve shoqërore, kujdesin shëndetësor, shërbimin civil, sistemin e drejtësisë dhe partitë politike (për të përmendur vetëm disa prej tyre).

26 Esipova, N., Ray, J. dhe Pugliese, A. (2017), *Number of potential migrants worldwide tops 700 million*, Gallup News, 8 qershor.

27 Gëdeshi, I. dhe de Zwager, N. (2012), *Effects of the global crisis on migration and remittances in Albania*, në: Sirkeci, I., Cohen, J.H. and Ratha, D. (eds) *Migration and Remittances during the Global Financial Crisis and Beyond*. Washington DC: Banka Botërore, f. 237–254.

28 Banka Botërore (2018), *Higher but Fragile Growth: Western Balkans Regular Economic Report No. 14*. Washington DC: Banka Botërore.

29 INSTAT (2015b) *Tregu i punës 2014*. Tirana: INSTAT.

30 INSTAT (2018) *Tregu i Punës 2018*. Marrë në janar 2020 nga www.instat.gov.al/media/5576/tregu-i-punes-2018-njoftim-per-media.pdf.

31 Të dhëna nga Banka e Shqipërisë.

32 Sipas të dhënave nga Banka Botërore, në periudhën 2002–2008, varfëria në Shqipëri u përgjysmuar në 12,4 për qind, por, në vitin 2012, u rrit sërish në 14,3 për qind. Shih: Banka Botërore (2016b), *South-East Europe Regular Economic Report, Resilient Growth and Rising Risks*. Washington DC: The World Bank.

33 Arslan, C., Dumont, J.-C., Kone, Z., Moulan, Y., Ozden, C., Parsons, Ch. and Xenogiani, T. (2014) *A New Profile of Migrants in the Aftermath of the Recent Economic Crisis*. Paris: OECD, Social, Employment and Migration Working Paper No. 160.

34 Studimi i Vlerave Evropiane kryhet njëherë në 10 vjet në të gjitha vendet evropiane. EVS-ja është një program kërkimor anketimi në shkallë të gjerë, i shtrirë në kohë për vlerat njerëzore bazë, si jeta, familja, puna, besimi fetar, politika dhe shoqëria. Ai ofron një vështrim në thellësi tek idetë, besimet, preferencat, qëndrimet, vlerat dhe opinionet e qytetarëve në mbarë Evropën.

3. Objektivi dhe metodologjia

Objektivi kryesor i këtij studimi është për të kuptuar më mirë dinamikat e kthimit dhe riintegrit, përfshi jo vetëm sfidat me të cilat përballen migrantët individualë kur kthehen dhe gjatë riintegrit në lidhje me shëndetin, arsimin, strehimin, punësimin dhe shërbime të tjera, por edhe sfidat me të cilat hasen komunitetet pritëse kur një numër i madh migrantësh të kthyer kanë nevojë për t'u integruar në tregun e punës, si dhe përfitim të mbështetjes financiare, arsimit, kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve sociale.

Kërkimet për këtë studim përfshinë analizimin e të dhënave parësore dhe dytësore. Kjo analizë përfshiu një studim të literaturës përkatëse mbi azil kërkuesit e kthyer si dhe përdorimin e metodave cilësore (intervista dhe diskutime në grupe të fokusuara).

Metodat cilësore përfshinë: a) 12 diskutime në grupe të fokusuara me të kthyerit (një në çdo prefekturë të vendit); b) 30 intervista gjysmë të strukturuar me informues kyç (kryesisht, në Shkodër, Kukës dhe Elbasan) me përfaqësues të institucioneve, ekspertë të arsimit, shëndetësisë, punës, ndihmës sociale, sporteleve të migracionit, skemave të formimit profesional dhe të qeverisjes vendore dhe c) 45 intervista të gjysmë-strukturuar me azilkërkues të kthyer (kryesisht nga Gjermania, Franca dhe Holanda).

Në disa prefektura, grupet e fokusuara u realizuan në qendrat e qarqeve (Gjirokastra, Vlora, Fieri, Berati, Shkodra, Kukësi, Peshkopia), ndërsa në të tjera u zgjodhën qytete të vogla (Kamza në Tiranë, Belshi në Elbasan, Maliqi në Korçë, Fushë-Kruja në Durrës dhe Laçi në Lezhë). Çdo grup i fokusuar ishte i përbërë prej 7–12 pjesëmarrësish të moshave, gjinive dhe niveleve socio-ekonomike të ndryshme. Në Fushë-Krujë (Qarku Durrës) dhe Berat u organizuan dy grupe të fokusuara me përfaqësues nga komunitetet rome dhe egjiptiane. Asnjë familje apo individ nuk morën pjesë në më shumë sesa një metodë kërkimore. Të gjitha intervistat dhe diskutimet në grupet e kufizuara u regjistruan dhe u përgatit zbardhja e tyre e plotë. Emrat e përmendur në intervistat e raportuara dhe grupet e fokusuara janë ndryshuar dhe janë ndjekur procedurat standarde për të ruajtur anonimatin e pjesëmarrësve.

Familjet dhe individët e kthyer u identifikuan nga informacioni i marrë nga vizitat/takimet në shkolla, qendrat e kujdesit shëndetësor, zyrat e ndihmës ekonomike, OJF të ndryshme që punojnë me të kthyerit, si edhe me persona të takuar në mënyrë rastësore (në bare, dyqane etj.). Shumë zyrtarë të lartë dhe punonjës të këtyre institucioneve apo persona rastësorë na ndihmuan me informacione fillestare mbi të kthyerit dhe adresat e tyre dhe, më tej, ata u kontaktuan dhe u intervistuan nga ekipi i anketës. Po kështu, ne përdorëm teknikën e ashtuquajtur kampionim “top dëbore”, përmes së cilës, individët e përzgjedhur fillimisht rekomanduan të afërmit miqtë dhe fqinjët që kishin aplikuar për azil në vendet e BE-së dhe ishin kthyer në Shqipëri.

Në përgjithësi, azilkërkuesit e kthyer ishin të gatshëm të intervistoheshin dhe të merrnin pjesë në grupe të fokusuara. Nga intervistat dhe seancat e grupeve të fokusuara ne mblodhëm dhe analizuam të dhënat cilësore lidhur me shkaqet dhe historikun e migracionit, përvojën e të kthyerve në vendin pritës dhe me kthimin e riintegrit e tyre në Shqipëri, si dhe planet për të ardhmen.

Ndërkohë, u intervistuan edhe përfaqësues të institucioneve kryesore vendore që merren me integrimin si aktorë kyç dhe ekspertë. Në përgjithësi, u përzgjedhën dhe u intervistuan personat me një përvojë të gjatë në institucionet përkatëse. Intervistat me informuesit kyç u hartuan për të bërë të mundur që të kuptoheshin në mënyrë më gjithëpërfshirëse çështjet kryesore, kufizimet dhe mundësitë për të përmirësuar riintegrimin e azilkërkuesve të kthyer. Informacioni u mblodh në bazë të këtyre intervistave dhe më pas, u analizua.

4. Profili i të kthyerve që morën pjesë në grupet e fokusuara

Gjatë intervistave dhe grupeve të fokusuara që u organizuan si pjesë e këtij studimi, ne u takuam dhe folëm me shumë të kthyer, të cilët kishin kërkuar azil më parë, që përfaqësonin grupe të ndryshme etnike (përfshi një numër të madh romësh dhe egjiptianësh), të cilët, duke iu përgjigjur një sërë pyetjesh gjysmë të strukturuar dhe të hapura, dhanë informacion dhe shprehën mendimet e tyre për çështje që kishin të bënin me jetën e përditshme.

Por cilat janë karakteristikat kryesore të këtij grupi? Pavarësisht disa dallimeve të brendshme, grupi kishte disa karakteristika të përbashkëta dalluese nga profili i përgjithshëm i shoqërisë shqiptare.

Mbi të gjitha, ky është segmenti më i varfër i shoqërisë shqiptare, renditur në fund të shkallës së të ardhurave.³⁵

Thuajse 24 për qind e familjeve shprehen se marrin 'ndihmë ekonomike' dhe 61 thonë se blejnë 'me listë'³⁶ në një ose më shumë dyqane ushqimore. Rreth 65 për qind e tyre thonë se gjendja financiare e familjes është 'e pamjaftueshme' ose 'shumë e pamjaftueshme' për të përmbushur nevojat e përditshme.³⁷ Dy burimet kryesore të jetesës për familjet e të kthyerve janë puna e anëtarëve të familjes dhe ndihma sociale – ndihma ekonomike, pensionet dhe pagesat e aftësisë së kufizuar.³⁸ Po kështu, ka edhe disa familje që kanë si burim të vetëm të ardhurash 'ndihmën ekonomike' ose pensionin e prindërve. Ky është rasti i Endritit nga një fshat i Peshkopisë:

Jemi pesë veta në familje dhe jetojmë vetëm me pensionin e babait, që është 16 000 lekë në muaj. Gruaja dhe unë jemi të papunë (...).

Qëkur janë kthyer nga vendi pritës pas aplikimit për azil, gjenda financiare për shumë familje azilkërkuese 'nuk ka ndryshuar' ose 'është përkeqësuar'.³⁹

Faktori kryesor që shpjegon këtë situatë është norma e lartë e papunësisë, nën-punësimi dhe të ardhurat e ulëta nga çdo punë në sektorët formalë dhe joformalë. Thuajse 36 për qind e popullsisë në këtë grup janë të papunë, shpesh, afatgjatë. Papunësia është më e lartë te të rinjtë dhe dukshëm më e lartë sesa norma zyrtare e papunësisë në Shqipëri.⁴⁰ Nga ata që punojnë, 34 për qind bëjnë punë të pakualifikuar në sektorin joformal, që jo vetëm është e keqpaguar, rastësore dhe e pasigurt, por edhe, shkakton stres emocional dhe pasiguri për të ardhmen.

Niveli arsimor i të kthyerve është shumë më i ulët sesa mesatarja e popullsisë së përgjithshme. Edhe pse disa anëtarë të këtij grupi kanë arsim të mesëm ose universitar, shumica kanë përfunduar vetëm arsimin e detyrueshëm nëntëvjeçar. Edhe niveli i aftësive profesionale i tyre është i ulët. Rreth 53 për qind e tyre nuk kanë një profesion dhe bëjnë punë që nuk duan kualifikim. Disa prej të kthyerve kanë pasur disa përvoja të mëparshme në migracion, kryesisht në Greqi.

35 Të intervistuarit u pyetën: Kjo është një listë të ardhurash dhe do të donim të dinim në cilin grup hyn familja juaj, duke marrë parasysh të gjitha pagat, shpërblimet, pensionet dhe të ardhura të tjera që hyjnë. Na thoni vetë, shkronjën e grupit tek i cili hyn familja juaj, pas tatimeve dhe zbritjeve të tjera.

36 'Lista' është një sistem huaje pa interes që mbahet nga pronarët e dyqaneve, zakonisht, ushqimore, që i lejon klientët 'të blejnë tani, por të paguajnë më vonë'.

37 Të intervistuarit u pyetën: Në përgjithësi, a është gjendja financiare e familjes tuaj e mjaftueshme për të mbuluar nevojat kryesore? Çdo i intervistuar mund të zgjidhte një prej alternativave në vijim: më se e mjaftueshme; e mjaftueshme; herë e mjaftueshme, herë jo; e pamjaftueshme; shumë e pamjaftueshme.

38 Të intervistuarit u pyetën: A keni të ardhura apo fitime që vijnë nga burimet e mëposhtme: pronë me qira, bujqësi, interes nga depozitat bankare, ndihmë sociale/pension, puna e familjarëve në Shqipëri, dërgesat dhe të tjera. Secili prej tyre mund të zgjidhte një ose më shumë nga këto alternativa.

39 Të intervistuarit u pyetën: Krahasuar me periudhën përpara se të aplikoni për azil, pas kthimit, do ta konsideroni situatën e familjes suaj si më mirë apo më keq? Alternativat ishin: shumë më mirë sesa përpara azilit; më mirë sesa përpara azilit; njësoj; më keq sesa përpara azilit; shumë më keq sesa përpara azilit.

40 Në tremujorin e dytë të vitit 2019, norma zyrtare e papunësisë në Shqipëri për popullsinë 15 vjeç e sipër ishte 11,5 për qind, por ishte 20,9 për qind për grupmoshën 15-29 vjeç (për më shumë informacion, shih: INSTAT (2019) *Anketa Tremujore e Forcave të Punës*. Tiranë: INSTAT).

Grupi i azilkërkuesve të kthyer karakterizohet nga një moshë mesatarisht më e re sesa e popullsisë së përgjithshme, pasi familjet e reja me fëmijë të vegjël ose meshkujt në moshë të re janë ata që kryesisht kanë kërkuar azil në Gjermani ose vende të tjera të BE-së.⁴¹ Shumë prej tyre kanë lënë prindërit e moshuar në atdhe, pasi të vjetrit nuk e përballojnë dot udhëtimin dhe kushtet e vështira të jetesës në kampe. Shumica prej tyre janë të martuar; vetëm pak janë të pamartuar dhe kanë migruar vetëm dhe të pashoqëruar. Po ashtu, ka raste kur familja bërthamë është ndarë, kryesisht për shkak të mungesës së mjeteve financiare për udhëtimin – ndaj burrat kanë shkuar të parët në vendin pritës, duke i lënë gratë dhe fëmijët në Shqipëri ose e anasjellta. Në shumë raste, këto ndarje të familjeve sjellin stres të fortë emocional, sidomos te fëmijët dhe gratë.

Nga pikëpamja etnike, shumica i përket grupit etnik shqiptar, me një numër gjithashtu të konsiderueshëm të romëve dhe egjiptianëve. Në shumë pak raste (në Shishtavec, Kukës) ka edhe familje e individë nga etni të tjera.

41 Disa të dhëna të pjesshme të botuara nga Pew Research Centre tregojnë karakteristikat demografike të azilkërkuesve shqiptarë që hynë në vendet BE-së në 2015. Thuajse gjysma (46 %) ishin të grupmoshës 18–34 vjeç dhe rreth 34 për qind ishin fëmijë nën 18 vjeç. Meshkujt mbizotëronin (61 %) dhe ishin më së shumti në moshë të re (thuajse gjysma e tyre ishin 18–34 vjeç). Për më shumë informacion, shih: Connor, P. (2016) *Number of Refugees to Europe Surges to Record 1.3 Million in 2015*. Washington DC: Pew Research Centre.

5. Gjetjet nga intervistat në grupet e fokusuara

5.1 Migracioni nga Shqipëria

Për shumë familje shqiptare, gjatë thujse tri dekadave, migracioni ndërkombëtar ka qenë një portë drejt një jete më të mirë përmes punësimit jashtë, të ardhura më të larta, për fëmijët dhe mundësi më të mira karriere. Edhe në rastet kur pjesë e familjes (zakonisht, prindërit e moshuar dhe në më pak raste, bashkëshortja dhe fëmijët) qëndronte në Shqipëri, ata përfitonin nga dërgesat në para për të përmirësuar cilësinë e jetës materiale apo për të investuar në biznese të vogla familjare.

5.2 Përse azili?

Migracioni ndërkombëtar ka qenë dhe mbetet mekanizmi kryesor për përballimin e varfërisë dhe përjashtimit social në Shqipëri. Kur papunësia rritet dhe të ardhurat nga sektori joformal bien, rriten flukset ndërkombëtare migratore. Më tej, pyetja që ngrihet është se përse po kërkojnë shqiptarët azil në vendet e BE-së. Përgjigja nga intervistat dhe diskutimet në grupet e fokusuara është e qartë. Gjatë dy dekadave të para, pas fillimit të tranzicionit post-socialist, flukset migratore nga Shqipëria u përqendruan kryesisht te vendet fqinjë, Greqia dhe Italia. Ekzistenca e rrjeteve shoqërore të formuara me shpejtësi gjatë viteve të para shërbeu si shtysë për migracionin në shkallë masive dhe uli kostot e rreziqet e migracionit. Të ardhurve të rinj shpesh u jepej ushqim dhe strehim, si dhe ndihmë për të gjetur punë. Sektori informal, sidomos në Greqi, kërkonte punëtorë të pakualifikuar (në ndërtim, shërbime dhe bujqësi), që ishin të gatshëm të punonin në këmbim të një page të ulët. Kështu, një numër i madh migrantësh arritën të gjenin punë. Që nga kriza ekonomike e financiare e vitit 2008, papunësia e migrantëve në të dyja vendet ka qenë e lartë dhe shumë shqiptarë nisën të ktheheshin në Shqipëri.⁴²

Për pasojë, shqiptarët priren të synojnë vende të tjera ku mundësitë për punësim dhe potenciali i përfitimit të të ardhurave janë më të mëdha. Përveç tyre, kur kërkojnë azil, azilkërkuesit shqiptarë besojnë se do të gjejnë strehim, ushqim dhe formim profesional, kontrata pune dhe leje qëndrimi në vendin pritës. Ndriçimi, i cili jeton në Kukës, shpjegon:

...meqë nuk kemi të drejtë të punojmë në Gjermani dhe rregullat e punësimit atje janë shumë të rrepta. Për më tepër, mundësitë për të punuar në mënyrë joformale janë gati zero. (...) Të penalizojnë po të kapën të punosh, kur nuk ke të drejtë ta bësh (...) Greqia, nga ana tjetër, ishte më liberale; kishim mundësi të punonim 'në të zezë' [d.m.th. në rrugë joformale]. E di nga përvoja kur punoja atje. Në Gjermani, kjo është e pamundur.

42 Një studim i përbashkët i kryer nga INSTAT-i dhe IOM-i tregoi se gjatë periudhës 2009–2013, 133 544 emigrantë shqiptarë të moshës 18 vjeçe u kthyen në Shqipëri, të nxitur kryesisht nga humbja e punës në Greqi dhe Itali (për më shumë informacion, shih: INSTAT dhe IOM (2014) *Migracioni i kthimit dhe riintegrimi në Shqipëri*. Tiranë: INSTAT/IOM).

Arjani, një ish-azilkërkues nga Peshkopia, ndan të njëjtin mendim:

Në Greqi, gjetja e punës ishte shumë e lehtë. Edhe vendi është më afër dhe udhëtimi kushton më lirë. Në Gjermani nuk gjen dot punë pa dokumente të rregullta. Gjermania ka ligjet e veta. Është më e lehtë për ne të integrohemi në Greqi.

Këto flukse azilkërkuesish, si ato nga vendet e Ballkanit Perëndimor, arritën kulmin në vitin 2015, duke iu bashkuar flukseve masive të azilkërkuesve nga Lindja e Mesme, që u nxitën e u lehtësuan nga një kombinim faktorësh. Faktori i parë ishte se, që nga fundi i dhjetorit 2008, shqiptarët mund të udhëtonin pa viza për në vendet e BE-së. Kjo mundësoi udhëtime me kosto të ulët (një kursim prej disa qindra eurosh për person) dhe lehtësoi udhëtimin për në vendin pritës. Faktori i dytë ishin zërat që u përhapën nga rrjetet personale shoqërore lidhur me shanset e punësimit në Gjermani ose në vende të tjera të BE-së.⁴³ Përveç kësaj, historitë individuale të suksesit të përcjella nga kanalet e komunikimit shërbyen si katalizatorë të procesit. Afatet e gjata procedurale, fitimet materiale e financiare dhe shërbimet më të mira sociale (p.sh. kujdesi shëndetësor, arsimi për fëmijët) që ofroheshin në vendin pritës patën po ashtu një ndikim të madh.

5.3 Arsyet e migracionit

Faktorët që i kanë shtyrë shqiptarët të kërkojnë azil në vendet e BE-së janë të ndryshëm. Mes të tjerave, mund të përmendim faktorë si gjendja e keqe ekonomike, shëndeti, arsimi, familja, strehimi, mbrojtja sociale, siguria dhe perceptimi pesimist i së ardhmes së tyre dhe fëmijëve të tyre. Le t'i shpjegojmë me hollësi secilin prej tyre.

Kushtet ekonomike – përfshi varfërinë, papunësinë dhe nën-punësimin, të ardhurat e ulëta nga sektori formal dhe joformal, kushtet e vështira të jetesës, mbrojtja e kufizuar sociale dhe borxhet – janë faktorët kryesorë shtytës për azilkërkuesit shqiptarë. Përveç këtyre faktorëve themelorë, e ardhmja e fëmijëve të tyre është një tjetër nxitës. Shumë pjesëmarrës në intervista dhe grupe të fokusuar e shohin këtë të ardhme nga këndvështrimi i cilësisë së shkollimit dhe mundësive të punësimit. Genci, një baba i papunë nga Kamza, thotë:

Arsyeja kryesore se përse shkova në Gjermani ishte gjendja ekonomike. Edhe gruaja, edhe unë jemi të papunë. Shkuam atje edhe për një të ardhme më të mirë për fëmijët tanë. Njeriu mendon ç'është më e mirë për fëmijët. (...) Të gjitha këto të shtynë. Papunësia dhe një e ardhme më e mirë. Kur e sheh që mundësitë këtu janë zero, do të bësh atë që është më e mira. Ne e provuam për më mirë.

Mimoza, një nënë nga Kukësi, shprehet:

Nuk ka punë, nuk gjen dot punë. Edhe po të kesh diplomë universiteti, nuk gjen dot punë. Për shembull, në shtëpinë time, ka tre veta me diplomë universiteti dhe asnjëri nuk ishte në punë.

Të tjerë thonë se pagat në sektorët formalë dhe joformalë janë të ulëta, nuk i motivojnë njerëzit të punojnë dhe nuk sigurojnë as minimumin e përditshëm të nevojave jetike. Enrieta, një grua nga Belshi, thotë:

Në qytet është hapur një fabrikë e re dhe mund të thuash që është mundësi punësimi, por duhet të marrësh parasysh rrogën. Aty [në fabrikë] njerëzit punojnë për 8–9 orë në ditë dhe paguhen vetëm gjysmën e asaj që duhet. Të punosh gjithë ditën për 400–500 lekë [rreth 3–4 euro] nuk është të punosh, nuk ia vlen.

⁴³ Barjaba, K. and Barjaba, J. (2015) *Embracing Emigration: The Migration-Development Nexus in Albania*. Bruksel dhe Nju Jork: Instituti për Politikë Migratore. Marrë më nëntor 2019 nga www.migrationpolicy.org/article/embracing-emigration-migration-development-nexus-albania.

Mungesa e infrastrukturës sociale dhe kushtet e vështira të punës janë arsye të tjera që i shkurajojnë njerëzit të punojnë. Majlinda, punonjëse e bashkisë së Cërrikut, thotë:

Në qytetin tonë nuk ka punë për gratë. Ka disa mundësi në Elbasan [që është afër]. Po është e vështirë për gratë që të shkojnë atje, se nuk ka as çerdhe dhe kopshtet nuk ofrojnë kujdes për gjithë ditën në Cërrik. Përveç kësaj, ato shpesh detyrohen të punojnë jashtë orarit dhe iu duhet shumë kohë të udhëtojnë. Kush do të kujdeset për fëmijët, pastaj?

Mbrojtja e kufizuar sociale është një faktor tjetër shtytës që nxit familjet e varfra të kërkojnë azil në vendet e BE-së. E ashtuquajtura 'ndihmë ekonomike' në Shqipëri nuk i mbulon të gjithë pjesëtarët e shtresës së varfër të popullsisë dhe është me vlerë shumë të vogël. Kësisoj, ajo nuk mund të ulë në mënyrë domethënëse varfërinë, pabarazinë dhe nxitës të tjerë të migracionit. Mira, një grua e divorcuar nga Puka që jeton me dy vajzat, tregon përvojën e saj:

Përpara se të ikja në Gjermani, merrja ndihmë ekonomike rreth 5 000 lekë. Tani është ulur në 2 500 lekë. Çfarë mund të bëj me 2 500 lekë?! Kam dy vajza, njëra në shkollë të mesme e tjetra në nëntëvjeçare. Nuk e di çfarë do bëjmë.

Persona të tjerë në diskutime dhe intervista theksojnë se borxhet ose 'listat' e gjata nëpër ushqimore dhe detyrimet e mëdha të energjisë elektrike i kanë shtyrë të kërkojnë azil në vendet e BE-së. Entela, një grua nga Maliqi, përshkruan rastin e saj:

Kisha 50 000 lekë fatura energjie pa paguar dhe më prenë dritat. Drita jo, me borxhe faturash energjie të papaguara, lista e gjatë e borxheve në dyqanet ushqimore (...). Kjo është arsye për të ikur.

Në të gjitha intervistat dhe diskutimet në grup, azilkërkuesit e kthyer theksuan se, nëse do të kishin një punë të qëndrueshme në sektorin formal dhe të ardhura të mjaftueshme, asnjëri nga ata nuk do të donte të largohej nga vendi. Fatmiri nga Kamza, një i kthyer nga Gjermania, thotë:

Vetëm kushtet ekonomike më bënë të kërkoja azil. Asgjë tjetër. (...) Jam pa punë (...) e gjithë familja është pa punë. Fëmijët i kam të vegjël, janë në shkollë. Do na duhet të ikim përsëri, të emigrojmë. Nuk kemi asnjë zgjidhje tjetër. Kjo është arsyeja e parë dhe e fundit. Nuk kam arsye të tjera. Vendi ynë është shumë i bukur. Ne duam të jetojmë në Shqipëri me njerëzit tanë (...), po në këtë situatë ekonomike, nuk kemi rrugë tjetër, nuk kemi zgjidhje.

Një tjetër pjesëmarrës në diskutimet në grupin e fokusuar, Luani nga Laçi, thotë:

Ne nuk presim standardet e Gjermanisë në Shqipëri. Shqiptarët duan minimumin e kushteve të jetesës. Të paktën, çdo familje duhet të ketë nga një të punësuar, për të siguruar jetesën minimale. (...) Po kërkojmë punësim. Nëse çdo qytetari shqiptar i jepet mundësia të gjejë punë këtu, nuk mendoj që njerëzit do të donin të largoheshin. Por nuk ka fare shpresë për punësim. (...) Jemi në kushte të mjeruara. Ka humbur shpresa.

Të kthyer të tjerë rrëfyan se problemet shëndetësore dhe mungesa e kujdesit të duhur shëndetësor në Shqipëri përbënte faktor shtytës. Erveheja, një nënë nga Kukësi, thotë:

Kam një fëmijë autik, me aftësi të kufizuara mendore dhe epilepsi. Fëmija është kuruar këtu për tetë vjet dhe nuk pashë asnjë ndryshim; përkundrazi, gjendja u bë gjithnjë e më keq. Prandaj u largova nga Shqipëria. Nuk kisha para që të nisesha me vizë dhe dokumente. Pashë që të gjithë po iknin, kështu që u ika edhe unë. Atje [në Gjermani] deklarova se kisha shkuar vetëm për fëmijën dhe, pasi t'i bëja të gjitha vizitat, do të kthehesha në Shqipëri.⁴⁴

Një numër i konsiderueshëm familjesh që morën pjesë në intervista dhe diskutimet në grupet e fokusuara, sidomos në veri të Shqipërisë, theksojnë mungesën e mjekëve specialistë dhe cilësinë e keqe të shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Avnii, një burrë 50 vjeç nga Kukësi, përshkroi rastin e tij:

Unë kisha një fëmijë që vuante nga një formë kanceri dhe isha i detyruar, si pasojë, meqë nuk mundesha të merrja mjekimin e duhur në Shqipëri, të ikja në Gjermani. Atje pata mundësi të merrja të gjitha mjekimet.

Shpesh, për të financuar udhëtimin e personave të sëmurë drejt vendit pritës për trajtim mjekësor, angazhohet e gjithë familja dhe rrethi shoqëror. Ka gjithashtu raste kur udhëtimi për azilkërkuesit e sëmurë është jo vetëm i shtrenjtë, por edhe i vështirë. Naimi, baba i dy fëmijëve të sëmurë nga Kamza, e pohon sa më sipër:

Unë kam dy fëmijë të paralizuar, paraplegjik dhe tetraplegjik. Njëri është 29 vjeç, kurse tjetri 20 vjeç. Të dy rrinë në shtrat. Mora borxh para, ika nga Shqipëria në Greqi, nga Greqia në Gjermani. Rruga kushtoi 1 600 euro. M'u desh t'i merrja me avion, se nuk do të mund ta përballonin rrugën me autobus apo makinë.

Disa të kthyer, kryesisht romë dhe egjiptianë, përmendën problemin e strehimit ose shembjes së shtëpive të tyre.⁴⁵ Kështu ishte rasti i Seitit, një rom nga vendbanimi i njohur si Pallati me Shigjeta në Tiranë, shtëpia e të cilit ishte prishur, pasi aty do të kalonte rruga.⁴⁶ Ai tha: 'Kishim shumë arsye për të kërkuar azil në Gjermani, po shtysa më e fortë për të ikur ishte shtëpia'.

Romë dhe egjiptianë të tjerë thanë se jetonin në shtëpi të mbipopulluara, çka i kishte nxitur shumë prej tyre të linin Shqipërinë dhe të migronin. Mimoza, një nënë e re rome nga Tirana, tha:

Kushtet e banimit janë shumë të vështira dhe jetoj në një familje të madhe. Për shkak të kushteve të këqija, zihemi shumë. Kam disa vite që jam martuar dhe jam shumë e stresuar (...). Po të kisha shtëpinë time, ndoshta nuk do të kisha ikur në Gjermani.

Pasiguria fizike për anëtarët e familjes dhe stresi i vazhdueshëm psikologjik që vjen nga kjo situatë e rrezikshme është një tjetër faktor shtytës pse disa shqiptarë kërkojnë azil në vendet e BE-së.

44 Mungesa e trajtimit për fëmijët autistë, sipas intervistave dhe diskutimeve në grupe të fokusuara, është një shkak për të cilin prindërit përpiqen të gjejnë zgjidhje duke kërkuar azil në Gjermani.

45 Sipas një studimi të PNUD-it, mbi 38 për qind e familjeve rome dhe 45 për qind e familjeve egjiptiane jetojnë në banesa të vjetra të rrënuara dhe një tjetër 21 përqindësh i familjeve rome dhe 11 përqindësh i familjeve egjiptiane jetojnë në baraka (për më shumë informacion, shih: Gëdeshi, I. dhe Miluka, J. (2013) *Needs Assessment Study*. New York: UNDP).

46 Sipas intervistave, për ndërtimin e kësaj rruge duhet të shembeshin 53 shtëpi rome dhe egjiptiane. Shumë prej tyre kërkuar azil në Gjermani ose Francë.

Lindita, një nënë nga periferia e Tiranës, ndan historinë e saj dramatike:

Kërkova azil në gjermani për shkak të gjakmarrjes. Burri im është në burg, i dënuar për vrasje. Kam dy fëmijë; djali është 14 vjeç. Në mos sot, nesër djali do të largohet nga vendi për t'i shpëtuar gjakmarrjes. Kërkoj mbrojtje për djalin. (...) Burri është dënuar për vrasje, por familja e viktimës nuk na ka falur. Jam e detyruar të emigroj, në mos sot, nesër. Në fund të botës, në mos në Gjermani ose Evropë, do të shkoj në fund të botës. Jetoj me qira, nuk kam asnjë të ardhur, asgjë. Punoj sipas rastit si pastruese, tri orë këtu, tri orë atje. Kam mbaruar arsimin e mesëm, por nuk gjej dot punë.

Kushtet e vështira të jetesës, papunësia, varfëria e skajshme dhe izolimi në rritje në lagjet periferike prodhon pa dyshim konflikte (midis familjeve, brenda familjes, divorce, pamundësi për të paguar borxhet etj.). Këto kushte të kombinuara përbëjnë një shtysë të fortë për të migruar për disa familje.

Ndërkohë, romët dhe egjiptianët në Shqipëri, më të varfrit e të varfërve, të karakterizuar nga tregues shumë më të ulët social-ekonomik sesa pjesa tjetër e popullsisë,⁴⁷ theksojnë një tjetër faktor nxitës: diskriminimin. Skënderi, një rom nga qarku i Korçës, tha:

Nuk janë vetëm arsyet ekonomike që më bënë të largohesha nga vendi. Është edhe diskriminimi. Askush nuk na e dëgjon zërin ne romëve.

Arjani, një i kthyer egjiptian nga Shkodra, i cili kishte kërkuar azil në Gjermani, pohoi një situatë të ngjashme:

Ika në Gjermani dhe Holandë për të ndërtuar një jetë më të mirë, pasi këtu ka diskriminim. Kur kemi probleme sigurie, policia nuk ndërhyr; kur kemi urgjencë shëndetësore, ambulanca nuk vjen.

5.4 Kush migron?

Pavarësisht shkallës dhe intensitetit të lartë të migracionit në Shqipëri, jo të gjithë ata që duan të migrojnë janë në gjendje ta bëjnë. Diskutimet në grupet e fokusuara dhe intervistat tregojnë se vetëm familjet dhe individët me kapital të mjaftueshëm njerëzor, financiar dhe social për një nismë të tillë janë në gjendje të migrojnë. Familjet dhe individët që nuk e kanë këtë kapital (ose vetëm pjesë të tij) e kanë të vështirë të migrojnë. Kështu, familjet rome që vrojtuan në Shkodër e kishin shumë të vështirë të migronin, për shkak të nivelit të lartë të varfërisë dhe kapitalit të kufizuar njerëzor e social. Myrvetja, një grua e varfër rome nga qyteti verior, u shpreh:

Na duhen para për të ikur nga Shqipëria. Po ne nuk kemi para as për të blerë pasaportat. Katër pasaporta kushtojnë 24 000 lekë (rreth 190 euro) plus shpenzimet e udhëtimit. (...) Po unë nuk kam para as për të ngrënë. Blejmë në dyqane me listë.

Duke pasur parasysh rëndësinë e llojeve të ndryshme të kapitalit të nevojshëm për të migruar, ne do t'i trajtojmë më poshtë individualisht, duke e nisur me kapitalin financiar.

5.4.1 Familjet me të ardhura të disponueshme

Kostot fillestare të migracionit janë të larta për shumë familje shqiptare dhe vetëm disa prej tyre mund t'i përballojnë. Duhet gjetur para për pajisjen me pasaportë biometrike të udhëtimit, për të paguar udhëtimin drejt vendit të destinacionit dhe për të mbuluar kostot rastësore. Në intervistën e saj, Mariola shpjegoi:

Ne shitëm makinën, jo për shpenzimet e udhëtimit, se ato i kishim, po për të pasur para shtesë mënjane. Babi tha se, përveç shpenzimeve të udhëtimit, na duhen ca para shtesë, sido që të jetë; asnjëherë nuk i dihet ç'ndodh dhe ai nuk donte që të mbeteshim pa para në mes të rrugës.

Disa familje shqiptare mbledhin fonde për të paguar udhëtimin nga kursimet e mëparshme apo puna që anëtarët e familjes kanë bërë më parë në emigracion (kryesisht në Greqi). Kështu ishte për Agronin, kryefamiljar nga Peshkopia, i cili tha:

Unë punoja në Greqi dhe paguhesha mirë. Përveç kësaj, deri para se të ikja për në Gjermani, isha në punë. Kështu që kisha para të mjaftueshme për udhëtimin.

Shumë familje të tjera e kompensojnë mungesën e parave duke u mbështetur te solidariteti i të afërmeve. Ato marrin hua para nga të afërmit, si dhe nga familjarët në emigracion në Greqi dhe Itali. Në mungesë të burimeve financiare, shumë familje mbështeten në rrethet e gjera familjare për të siguruar paratë e nevojshme. Luani, një i kthyer në Kukës, mori hua paratë që i duheshin nga i vëllai. Shumë të tjerë marrin hua nga të afërmit e bashkëshortit/bashkëshortes dhe dukuria është e dukshme në jug dhe në veri të vendit. Familje të tjera mbështeten te marrëdhëniet dhe besimi që kanë krijuar më parë. Zakonisht, këto janë marrëdhënie biznesi. Kështu, disa familje i marrin paratë hua, por me një kamatë prej 10 për qindësh në muaj. Sanija, një nënë nga Korça, thotë:

Ne morëm para borxh për udhëtimin e djalit nga një i njohur. Kamata ishte deri në 10 për qind në muaj. (...) Më pas, djali dërgoi lekët nga Gjermania dhe unë pagova edhe borxhin edhe kamatën.

Në shumë raste, marrja hua me interes të lartë shkakton stres për huamarrësit që ta shlyejë në kohë. Përveç kësaj, jo të gjithë mund të përfitojnë nga kjo lloj marrëdhënie biznesi. Skënderi, një kryeplak rom nga Fushë-Kruja shpjegon:

Disa njerëz që kanë e miq të mirë nga 'të bardhët' morën hua me interes dhe u larguan. Pastaj, për dy-tre muaj dërguan paratë që kishin marrë nga Gjermania. (...) Duhej të dërgonim paratë ndryshe do rritej kamata. Romët nuk japin para borxh me interes, kështu që ne marrim borxh vetëm nga 'të bardhët'.

Familje të tjera kanë marrë hua nga bankat tregtare me pretekstin se iu duhen për të financuar biznesin e tyre të vogël. Arbeni, një rom nga qarku i Korçës, shpjegoi:

Shumë nga azilkërkuesit morën hua në bankë (...) Nuk të jep njeri 1 000 euro po të dijë që do migrosh për azil dhe nuk është e sigurt nëse do kthehesh të shlyesh borxhin. Shumë njerëz i kanë dërguar paratë me agjencitë e transferimit të parave nga Gjermania për të shlyer kreditë bankare, përndryshe banka do t'u merrte shtëpitë.

Në mungesë të kursimeve, për të mbuluar udhëtimin drejt vendit të destinacionit, disa familje shitën një pjesë të tokave bujqësore, bagëti, pajisje elektro-shtëpiake, mjete pune apo vendin e tyre të shitjes në tregun e rrobave të përdorura. Kjo është ajo që bëri Luani nga Malësia e Madhe:

Udhëtimi në Gjermani kushtonte 1 500 euro, po unë nuk mora borxh. Kisha disa dhi dhe i shita për të bërë paratë. Një burrë tjetër nga fshati ynë, që erdhi me mua në Gjermani, shiti bagëtitë.

Në disa raste, njerëzit shitën edhe shtëpitë, për të mbledhur paratë. Kështu ndodhi edhe me Shpresën, një nënë rome nga Tirana e kthyer nga Franca:

Familjes sonë i duheshin 3,000 euro për të shkuar në Francë. Për këtë vlerë, shitëm të gjitha ato që kishim, madje edhe morëm borxh disa para (...) Tani që jemi kthyer, po jetojmë te shtëpia e vjehrrës. Banojmë 10 veta në një dhomë.

Disa familje nga Tirana përdorën bonusin e qirasë nga bashkia pas shembjes së shtëpive për të financuar udhëtimin për në Gjermani.⁴⁸ Astriti, një rom nga vendbanimi i Pallatit me shigjeta, tha:

Vitin e parë, qeveria na tha 240 000 lek [rreth 1 800 euro] për qiranë. Por, meqë nuk po shihnim shpresë, vendosëm bashkë me djalin t'i përdornim paratë për të emigruar. Paguam për pasaportat e fëmijëve, paguam për biletën dhe ikëm. I përdorëm 240 000 lekët që na dha qeveria për të shkuar në Gjermani.

5.4.2 Familjet me kapital njerëzor

Familjet anëtarët e të cilave kanë një nivel të caktuar arsimor e kanë më të lehtë të zbulojnë rrugën për të emigruar dhe qëndruar në vendin pritës. Disa prej tyre kanë pasur përvoja të mëparshme migracioni, kryesisht në Greqi, çka i ndihmon të përshtaten më lehtë në destinacionin e ri. Genci, një i kthyer në Gjirokastrë, tha:

Unë punoja si shofer kamioni dhe transportoja mallra nga Shqipëria për në vendet e BE-së. Punova në Greqi për disa vite. Për pasojë, ishte shumë e lehtë për mua të përshtatesha në Gjermani.

Migracioni drejt një vendi të BE-së perceptohet nga shumica prej tyre edhe si mundësi për të marrë formim e për të mësuar një profesion të ri. Agroni, një fshatar nga Rrësheni dhe ish-azilkërkues në Gjermani, foli për aspiratat e tij:

Nuk shkova atje për azil, në Gjermani. Shkova me shpresën që do të ishte disi më mirë, e do të mund të përfitoja nga disa të drejta, të mësoja një profesion, të punoja dhe jetoja atje.

Mosha e re dhe gjendja e mirë shëndetësore e anëtarëve të familjes janë parakushte për migracionin, me përjashtim të rasteve të përmendura më sipër, kur fëmijët e sëmurë ishin motivi kryesor. Jo të gjithë ia dalin të përballojnë udhëtimin e vështirë dhe kushtet e kampit të azilit. Shumë azilkërkues lënë pas prindërit e moshuar dhe të sëmurë, si edhe dikë nga familja për t'u kujdesur për ta. Ky është rasti i Ermirës nga Tirana, e cila tha:

Unë jetoj me prindërit dhe vëllain. Të dyja motrat e mia janë martuar dhe janë me familjet e tyre në Gjermani. (...) Po ne nuk mund të ikim, se prindërit janë sëmurë dhe vëllai vuan nga depresioni.

48 Kjo u referohet banesave rome të shkatërruar, për të lejuar ndërtimin e autostradës së re; shih Shënimin 41 më sipër. Bashkia pagoi qiranë për banorët për një periudhë ta caktuar kohe. Disa familje e përdorën kështu e parë për të financuar udhëtimin në Gjermani.

5.4.3 Familjet me kapital social

Pasja e një rrethi miqsh dhe të afërmish ndihmon në shumë mënyra, që nga mbulimi i kostos së udhëtimit, deri në dhënie të informacioneve të nevojshme për kushtet, procedurat dhe mundësitë e migracionit. Kapitali social është i rëndësishëm në të gjitha fazat e migracionit ndërkombëtar, nga jetesa dhe puna jashtë dhe dërgesat me para në shtëpi, deri te kthimi.

Së pari, azilkërkuesit e mundshëm mbështeten te kapitali social për të marrë informacionin përkatës për koston e udhëtimit, itinerarin më të mirë drejt destinacionit, institucionet të cilave duhet t'u drejtohen dhe kampin e azilit që duhet të zgjedhin sipas kushteve (p.sh. mbipopullimi, ushqimi, mundësia e strehimit në vendbanim të veçantë, vlera e ndihmë financiare që jepet dhe mundësia për qëndrim afatgjatë). Arbeni, i cili jeton në Pogradec, shpjegoi se:

Në Gjermani kishte edhe kampe me kushte të këqija, si, për shembull, njerëzit nuk mund të laheshin, kishte vetëm një sanduiç për të ngrënë (...). Po kështu, kishte kampe në kushte të mira, si ato pranë Berlinit, pranë Frankfurtit dhe Hanoverit (...). Ne i merrnim këto informacione, pasi komunikim me shokët tanë në kampe të ndryshme.

Ky kapital social është i nevojshëm për t'i ndihmuara ata gjatë udhëtimit dhe kur mbërrijnë në vendin e destinacionit. Këto rrethe shoqërore ulin rrezikun, kostot materiale dhe psikologjike të migracionit. Në shumë raste, dërgimi i parave në shtëpi për të shlyer borxhet apo për të ndihmuar familjet bëhet duke u mbështetur te kapitali social.

Drini nga Gjirokastra thotë:

'I dërgova paratë me një shokun tim nga Elbasani, i cili transporton mallra me kamion nga Gjermania në Shqipëri'.

Po kështu, ka edhe raste kur azilkërkuesit nuk kanë kapital social dhe janë tërësisht të humbur. Ky është rasti i Almës, një nënë e re nga Belshi, e cila udhëtoi e vetme me fëmijët e saj. Ajo tha:

U largova me katër fëmijët dhe s'kisha ku të shkoja (...). Disa shqiptarë në të njëjtin autobus po shkonin në Frankfurt. Edhe unë qëndrova atje.

Shumë azilkërkues mbështeten te kontributet nga familja e zgjeruar që të kujdesen për prindërit e moshuar ose anëtarë të tjerë të familjes në atdhe, kur ata janë në vendin e azilit. Anëtarët e moshuar të familjes që qëndrojnë në shtëpi, shpesh, mbështeten te besimi i bizneseve lokale që t'i lënë të blejnë mallrat dhe t'i shënojnë në listën e dyqanit ndërkohë që anëtarët më të rinj të familjes janë jashtë.

Familjet që nuk e kanë këtë kapital social kanë më pak të ngjarë të migrojnë ose kthehen shpejt nga vendi pritës, pa prituri të marrin rezultatin e aplikimit.

Myrvetja, një nënë nga Kukësi, e cila kishte migruar në Gjermani për të kuruar djalin e sëmurë, thotë:

'U kthyem se nuk kishte kush të ndihmonte burrin; ishte vetëm në shtëpi'.

5.5 Vendimet familjare

Vendimi për të kërkuar azil në një vend të BE-së është zakonisht rezultat i një diskutimi të gjatë e të thelluar familjar, në të cilin financat janë aspekti më i diskutuar dhe më i vështirë.

Sonila, një vajzë rome nga Tirana, e cila aplikoi bashkë me familjen për azil në Luksemburg, tha:

‘Ne e diskutuam në familje (...) Diskutua për afro dy muaj dhe pastaj vendosëm të iknim’.

Përgjithësisht, nismën për të kërkuar azil në një vend të BE-së e marrin burrat, por ata e diskutojnë me bashkëshortet dhe anëtarët e tjerë të familjes. Udhëtimi dhe kushtet e jetesës në vendin pritës mund të jenë të vështira dhe plot të papritura, për rrjedhojë, duhet të bjerë dakord e gjithë familja. Edi, kryefamiljar nga Puka, tha:

Më parë, e diskutova çështjen vetëm me gruan, pa fëmijët. Më vonë folëm me fëmijët. U thamë për kushtet e vështira, mundësitë e kufizuara që kishim [në Shqipëri] për të financuar shkollimin e tyre (...) dhe kështu vendosëm së bashku dhe u nisëm.

Konsensusi familjar duhet edhe për të rinjtë që migrojnë vetëm. Fatmiri, një i ri, që jeton me prindërit në Kukës, thotë:

Kur vendosa të emigroj, e diskutova më parë me familjen. Ata thjesht më thanë se nuk shihnin një alternativë më të mirë në Shqipëri dhe më dhanë leje. ‘Provo çfarë të duash’, më thanë.

Ka edhe raste kur janë gratë që e marrin iniciativën. Majlinda, një vajzë nga Tirana, thotë:

Idea për të kërkuar azil në Gjermani erdhi nga tezja ime. Ajo foli me mamën dhe babin. (...) Djali i dajës, i cili u nxit nga ne që do të iknim, edhe me ne.

Në raste të tjera, vendimi është edhe strategji afatgjatë e familjes së zgjeruar, që anëtarët e saj të migrojnë me radhë njëri pas tjetrit, duke u bashkuar me pjesën tjetër të familjes në vendin pritës. Erveheja, një nënë nga Maliqi, thotë:

Më parë u largua djali im i madh, i cili ka familje me pesë veta. Kishim ca para dhe morëm borxh edhe disa të tjera me interes nga një i njohur. Nuk kishim para që të shkonim të gjithë menjëherë. Në Gjermani, djali i madh filloi të merrte ca para dhe na i dërgonte ne. Kështu, të gjithë fëmijët u larguan njëri pas tjetrit.

Petriti nga Dibra tregon një histori të ngjashme:

Në familjen tonë jemi pesë veta, por babanë 77-vjeçar e lamë në Shqipëri, se nuk e përballonte rrugën e gjatë me makinë dhe kushtet e vështira të kampit. Unë shkova atje me idenë që të rregullohesha vetë njëherë dhe pastaj, të sillja babanë.


Shumë familje e organizojnë së bashku udhëtimin, ndajnë kostot, shkëmbejnë informacion dhe rrinë së bashku në vendin e azilit, duke rritur sigurinë dhe mbështetjen për veten. Anila, e cila jeton në Tiranë, e përshkroi kështu:

E diskutuam gjerësisht me familjen dhe pastaj vendosëm të ikim. (...) U larguam me familjen e djalin të xhaxhait. Familjet e hallës dhe xhaxhait ishin nga katër veta secila. Ishim 12 veta në fugon.

5.6 Vendet pritëse

Sipas të dhënave të OECD-së, shumica e azilkërkuesve shqiptarë kanë shkuar në Gjermani dhe Francë; më pak në Mbretërinë e Bashkuar, Greqi, Suedi, Belgjikë, Holandë, Itali, Norvegji, Luksemburg, Austri dhe vende të tjera të BE-së.⁴⁹ Edhe pse të shpërndarë në më shumë se 15 vende të BE-së, rreth 70 për qind gjatë periudhës 2010–2018 ishin në Gjermani (47 %) dhe Francë (23 %). Sipas të intervistuarve, Gjermania dhe Franca ishin destinacionet e preferuara për shkak të strehimit dhe shërbimeve më të mira (kujdesi shëndetësor, shkollimi për fëmijët, trajnimi gjuhësor, formimi profesional etj.), vlerë më të lartë të ndihmës financiare mujore për frymë dhe procese të gjata aplikimi.

Figura 3: Shpërndarja e azilkërkuesve sipas vendeve të destinacionit, 2008–2018



Burimi: OECD (2019) Parashikimi Ndërkombëtar i Migracionit 2019. Paris: OECD Publishing.

Në varësi të kushteve, preferenca e azilkërkuesve për Gjermaninë ose Francën ndryshonte. Luani, një rom nga Fushë-Kruja, shpjegoi:

Familjet rome nga Fushë-Kruja migruan në fillim të vitit 2014 në Francë. (...) Fillimisht, ndihma financiare mujore ishte 350 euro për person në muaj, por, më vonë, u përgjysmua. Ndërkohë, katër a pesë familje rome që kishin ikur në Gjermani në maj 2014 na thanë se ishin paguar 310–330 euro për person në muaj dhe fëmijët paguheshin rreth 200 euro në muaj. Për më tepër, strehimi dhe kushtet e jetesës ishin më të mira (...). Atëherë, shumica e njerëzve ikën në Gjermani.

Po kështu, pas kthimit nga njëri vend, disa azilkërkues (kryesisht romë dhe egjiptianë) migrojnë drejt një tjetri. Artani, një rom nga Berati, pasi u kthye nga Gjermania, iku në Francë për të kërkuar azil. Ai tha:

Shumë familje në qytetin tonë janë kthyer nga Gjermania dhe pastaj kanë ikur në Francë ose anasjelltas, janë kthyer nga Franca dhe pastaj kanë ikur në Gjermani. Këtu [në Shqipëri] nuk kanë çfarë bëjnë.

49 OECD (2019) *International Migration Outlook 2019*. Paris: OECD Publishing.

5.7 Itineraret

Familjet azilkërkuese kanë ndjekur itinerare të ndryshme për të shkuar në Gjermani ose Francë, në varësi të vendit ku jetojnë në Shqipëri, informacionin që marrin nga rrethi shoqëror dhe kostoja e udhëtimit. Ata që janë nga Tirana, Durrësi, Fieri, Vlora dhe, në një shkallë më të vogël, nga Berati (e gjithë Shqipëria perëndimore) morën tragetin për në Itali (Bari, Brindisi ose Trieste) dhe, më pas, vazhdojnë me autobus ose tren për në Milano e më tej në Gjermani. Dhurata, një nënë e tre fëmijëve nga Tirana, thotë:

Ne jemi pesë veta. U nisëm nga Vlora. Morën tragetin për në Bari, Itali dhe, më pas, autobusin në Gjermani. (...) Kostoja e rrugës ishte rreth 1 600 euro, që i kishim marrë borxh.

Familjet nga Shkodra dhe, në një shkallë më të vogël, nga Lezha në veri kanë marrë përgjithësisht taksi ose furgon përmes Malit të Zi, Kroacisë dhe Hungarisë për në Gjermani. Në shumë raste, udhëtimi është i vështirë, sidomos kur udhëtohet së bashku me fëmijë të vegjël. Kështu ishte edhe rasti i Shpresës, një nënë e re nga fshati i thellë i Shkodrës, e cila thotë:

Na u desh tri ditë të shkonim në Gjermani. Kushtoi 2 000 euro. Kishim me vete tre fëmijët dhe më i vogli ishte me pak se një vjeç. Rrugës na u desh të ndalonim shpesh, çdo dy-tri orë, sepse i vogli qante dhe kishte uri. (...) Kishim marrë ushqim me vete dhe e kaluam gjithë natën në makinë. Në Berlin arritëm ditën e tretë, vonë natën dhe shkuam te komisarati i policisë.

Shumë familje azilkërkuese nga Korça, në juglindje të Shqipërisë dhe disa nga Berati dhe Elbasani, udhëtuan me autobus në Selanik, Greqi dhe prej andej morën avionin për në Gjermani – kryesisht në Frankfurt, Dyseldorf, Berlin, Hanover dhe Dortmund. Ndërkohë, azilkërkuesit nga Gjirokastra, në jugperëndim, morën avion nga Athina. Fluturimet janë më të lira nga Selaniku dhe Athina, por duhet të kalosh një natë atje. Pasja e një kapitali social të pasur (të afërm ose të njohur që kanë migruar në Greqi) nënkuptonte që ata mund të rrinin për një ose dy ditë në shtëpitë e tyre. Ermira, një nënë e re nga Elbasani, konfirmoi:

Në Selanik, kaluam një natë në shtëpinë e vëllait tim, që është emigrant atje. Pastaj morëm avionin nga Selaniku në Berlin, ku shkuam në polici dhe bëmë kërkesë për azil.

Shumë azilkërkues nga Kukësi dhe Dibra, në verilindje të Shqipërisë, kishin udhëtuar përmes Kosovës⁵⁰ për në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi, e më pas në Hungari. Ky udhëtim ishte më i gjatë dhe më i kushtueshëm, çka pasqyron sa e thellë është kjo zonë malore. Kjo është ajo që na tha Pranvera, një nënë e re nga Peshkopia:

Udhëtimi për gjithë familjen kushtoi rreth 1 400 euro. Shkuam me autobus, por premë edhe biletën e kthimit, ndryshe nuk do të na linin të kalonim. Udhëtua nga Kosova në Maqedoni dhe Serbi dhe pastaj në Hungari. (...) Na u desh të jepnim 'ndonjë lek' në dogana.

Arturi, një 25-vjeçar i diplomuar nga Kukësi, ndoqi të njëjtin itinerar:

Në pikën e kalimit kufitar në Hungari, paguam 50 euro secili, ndryshe asnjë nga ne në autobus nuk do lejohej të kalonte. Po deshe të vazhdohej, paguaj paratë ose rri. Kështu, na u desh të japim paratë.

50 Referencat për Kosovën do të kuptohet se janë në kontekstin e rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Disa familje patën mundësi të fluturonin direkt nga Tirana. Udhëtimi me avion nënkupton më pak të papritura, por kostoja nga Tirana është më e lartë dhe shpesh, duhet blerë edhe një biletë kthimi. Petriti, i cili udhëtoi me familjen, na thotë një histori të ngjashme:

‘Udhëtuam me avion nga Tirana, po na u desh të blinim biletën e kthimit, ndryshe nuk do të na pranonin’.

Në raste të tjera, disa romëve dhe egjiptianëve u është kërkuar të tregojnë se kanë para me vete, përndryshe do ta kishin të vështirë të kalonin në kufi. Kjo është historia e Fatmirit, një rom nga Korça:

Një familje (...) u kthye në aeroportin e Tiranës, sepse autoritetet u kërkuar të tregonin 600 euro si provë për veten dhe gruan. Ai kishte edhe garanci, që ia kishin dërguar, edhe biletën e kthimit. Po nisja e tyre duhet të ketë ngjallur ndonjë dyshim në [aeroportin] e Rinasit – romët njihen lehtë, se janë me tipare të errëta – dhe i kthyen. Nga 30–40 veta që ishin në radhë, vetëm çifti rom u kthye.

Azilkërkues të tjerë fluturojnë nga Prishtina ose Shkupi, ku çmimet janë më të lira.

Gjithsej, kostoja e udhëtimit ishte rreth 1 050 euro për familje, në varësi edhe të numrit të pjesëtarëve, vendit të destinacionit dhe mjeteve të transportit.⁵¹

51 Të intervistuarit u pyetën: Sa kushtoi udhëtimit përafërsisht nga vendi ku jetoni në vendin pritës?

6. Përvoja në vendin pritës

Sipas intervistave dhe diskutimeve në grupet e fokusuara, shumë nga të kthyerit ndiheshin të kënaqur me përvojën në vendet e BE-së (kryesisht në Gjermani, por edhe në Francë) sa i takon strehimit, përmbushjes së nevojave materiale, kujdesit shëndetësor dhe shkollimit të fëmijëve. Koha e kaluar në këto vende ka kontribuar për t'u pasuruar jetën me vlera të reja dhe për të ndryshuar mënyrën e të menduarit.

6.1 Strehimi

Azilkërkuesit shqiptarë mund të ndahen në dy grupe të mëdha sa i takon përvojës së tyre në vendet kryesore pritëse. Grupi i parë përfshin ata që kanë migruar kryesisht gjatë periudhës janar 2014-tetor 2015.⁵² Pasi kanë qëndruar për disa ditë ose javë në kampe, ata janë transferuar në banesa, hotele, shkolla dhe mjedise të tjera publike të përshtatura për këtë qëllim. Të gjitha vendbanimet kishin pajisjet e nevojshme elektro-shtëpiake. Faturat e energjisë, ujit dhe ngrohjes paguheshin nga qeveria gjermane. Luljeta, një nënë e re nga Tirana, tha:

Qëndruam 10 ditë në kamp dhe pastaj na transferuan në një shtëpi që, për mua, ishte përrallë. (...). Çdo gjë ishte fringo e re, televizori, frigoriferi, lavatrica, krevatet... i nxora vetë nga kutia. Akull të reja. Fëmijët ishin të lumtur.

Grupi i dytë përbëhet nga familje që kanë migruar në Gjermani pas tetorit 2015. Sipas të intervistuarve, ata kishin qëndruar kryesisht në kampe dhe për një kohë më të shkurtër.

Këto kushte strehimi ishin shpesh ndryshe nga ato në Francë. Isufi, një rom nga Fushë-Kruja, tha:

'Standardet e jetesës në Gjermani ishin shumë më të larta, po në Francë të linin në çadër'.

Edhe Fatmiri, një egjiptian nga Berati, ndau të njëjtën përvojë:

Kur shkuam në Francë, ndenja për tre muaj jashtë. Nuk isha i vetmi, edhe të tjerët ashtu ndenjën. Qëndruam në një apartament bosh. Pas tre muajsh nga dhanë një shtëpi.

6.2 Të ardhurat

Shumë azilkërkues në Gjermani morën një pagesë për të mbuluar shpenzimet ditore. Kjo vlerë ndryshonte sipas vendndodhjes dhe periudhës së aplikimit për azil. Gjithsej, vlera mujore shkonte 300–400 euro për person për të rriturit (18 vjeç e sipër); më pak ishte për fëmijët. Të ardhurat mjaftonin për të mbuluar nevojat e përditshme (ushqim, veshmbathje, transport dhe ilaçe). Ata që jetonin në kampe merrnin më pak, po ushqimi iu jepej falas.

⁵² Në vitin 2015, BE-ja i kategorizoi Shqipërinë, Kosovën dhe Malin e Zi si 'vende origjine të sigurta'. Ligjet për azilin, që u miratuan nga qeveria gjermane në tetor 2015 dhe shkurt 2016, ulnin përfitimet që merrnin migrantët shqiptarë dhe shkurtoi kohëzgjatjen e procedurës së azilit.

Kështu, Endri, i cili qëndroi në kamp, morri shumë më pak para. Ai tha:

Në kamp na jepnin ushqim dhe një vlerë të vogël në para, rreth 3-4 euro në ditë, sa për të blerë cigare. Asgjë më shumë.

Nëse familjet përfitonin apo jo në para nga azilkërkimi varej nga fakti nëse rrinin në kamp apo transferoheshin në një shtëpi dhe nga kohëzgjatja e qëndrimit të tyre në vend.

Të ardhurat rriteshin kur anëtarët e familjes punonin në sektorët formalë dhe joformalë. Disa azilkërkues kanë punuar me kontratë në Gjermani, po këta ishin pak. Të tjerë punonin në sektorin joformal (mbledhja e rrobave të përdorura, riciklim, ndërtim, ngarkim-shkarkim, pastrim, punë të ndryshme në ferma) dhe fitonin të ardhura shtesë. Kështu ndodhi edhe me Besimin, i cili ishte azilkërkues në Marsejë, Francë. Ai tha:

Unë punoja në tregun e zi, në koshat e mbetjeve. Mbledhja rroba të përdorura. Merrja diçka dhe e shisja. Bëja rreth 700 euro në muaj, plus 510 euro që na jepte për familjen qeveria franceze. Gjendja ekonomike e familjes u përmirësua.

Në këto rrethana, pjesë e të ardhurave përdorej për shpenzimet e përditshme, si ushqimi, veshjet, barnat dhe transporti. Pjesa tjetër kursehej dhe dërgohej në Shqipëri.

6.3 Kursimet

Shumica e të intervistuarve thanë se kishin kursyer para në vendin pritës. Kursimi është një nga objektivat e migracionit për familjet azilkërkuese, që iu jep mundësi të shlyejnë borxhet dhe të zgjidhin disa probleme kur kthehen në Shqipëri. Linda, një grua nga Tirana, thotë:

Në Gjermani doja të kurseja, se kishim borxhe për të paguar në Shqipëri. Kështu, hanim kryesisht në vendet për azilkërkuesit, se ushqimi ishte i shtrenjtë. Ne mund të blinim ushqime, po ashtu nuk do të ishim në gjendje të kursenim shumë. Në Shqipëri kisha një borxh për të shlyer. Mendova se një ditë do të kthehesha dhe kisha një borxh të madh për të paguar këtë.

Kursimet ishin një pjesë e konsiderueshme e diskutimeve mes azilkërkuesve. Kujtimi, një rom nga Fushë-Kruja, kujtoi:

'Flisnim përditë me të afërmit në kampe të tjera në Gjermani dhe u thoshim që të kursenin, se një ditë do ktheheshin'.

Kursimi është po ashtu një element thelbësor që bën dallimin midis familjeve që kanë përfituar ose jo nga azilkërkimi në vendin pritës. Ky është rasti i Anilës, një grua nga Durrësi, e cila u shpreh:

Në Gjermani, qëndruam tre muaj në një kamp, pastaj na kthyen. Nuk e di pse, po na kthyen shpejt. Nuk patëm mundësi të kursenim. Qemë pa fat.

Vlera e kursimeve varet nga të ardhurat e migrantëve, numri i anëtarëve të familjes, perioda e qëndrimit në vendin pritës, mundësia e gjetjes së një pune në sektorët formalë ose joformalë, sjellja kursyese dhe nëse kthimi ishte i detyruar ose vullnetar.

Arbeni, i cili është një i kthyer nga Gjermania, thotë:

Në Gjermani, merrnin 300 euro në muaj për person dhe një familje me pesë veta merrte 1 200–1 300 euro në muaj. Familja shpenzonte 400–500 euro në muaj dhe pjesa tjetër kursehej, për t'u dërguar në shtëpi në Shqipëri.

Shumica e migrantëve të intervistuar thanë se kishin kursyer rreth gjysmën e të ardhurave të përgjithshme. Megjithatë, disa prej kursimeve u dërguan në shtëpi, si dërgesa për të shlyer borxhet ose u përdorën për të paguar avokatët në Gjermani.

Në përgjithësi, familjet shqiptare kursyen mesatarisht rreth 2 000 euro, nëse qëndruan një vit në Gjermani. Kursimet rriten sa më i gjatë të jetë qëndrimi dhe sa më mirë të njohësh vendin pritës dhe sistemin e tij. Skënderi, një i kthyer nga Gjermania, shpjegoi:

Disa familje rome dhe egjiptiane përfituan po ashtu nga institucionet bamirëse. Ata që qëndruan tre vjet në Gjermani e dinin se ku ishin institucionet e bamirësisë, si Caritas-i apo Kryqi i Kuq dhe merrnin ushqime atje. Kështu, kursyen më shumë para. Ata që qëndruan vetëm një vit, nuk mund ta dinin.

Megjithatë, ka përjashtime. Familja e Mimosës, azilkërkuese nga Maliqi, që në gjendje të kursente rreth 10 000 euro gjatë qëndrimit të saj në Gjermani. Ajo tha:

Burri im punonte në një servis makinash dhe fitonte 60 euro në ditë. Si azilkërkues nuk kishim të drejtë të punonim, po ai punonte në të zezë. Gjatë 11 muajve që qëndruam në Gjermani, ai punoi (...). Përveç kësaj, merrnim edhe 600 euro në muaj si ndihmë ekonomike.

Kjo sjellje kursyese ishte shumë e theksuar te azilkërkuesit romë dhe egjiptianë. Artani, një i ri rom nga Tirana, tha:

Gjermania ishte vend shumë i bukur dhe kishte shumë ngjarje kulturore e sportive dhe shumë festa ku mund të kisha shpenzuar para. Por, duke e ditur varfërinë e familjes, kursyem dhe i dërguam paratë në Shqipëri.

Konsumi i duhanit, kafesë dhe alkoolit ishte një tjetër përcaktues në vlerën e kursyer nga familjet. Artani e vazhdoi historinë tij: 'Ata që pini duhan kursyen më pak, se cigaret në Gjermani ishin shtrenjtë'. Të tjerë, për të kursyer më tepër, e përgatitnin kafënë në shtëpi ose e bënë vetë bukën.

6.4 Dërgesat në para

Dërgesat në para janë nga aspektet më të studiuar në migracionin pas viteve '90 në Shqipëri. Bazuar në vlerësimet e Bankës së Shqipërisë, dërgesat në para nga migrantët shqiptarë patën një rritje të shpejtë në periudhën 1991–2007 dhe, më pas, duke filluar nga viti 2008, u ulën si rezultat i pasojave të krizës ekonomike globale dhe maturimit të ciklit të dërgesave.⁵³ Që nga viti 2014, fluksi i dërgesave në para nga migrantët shqiptarë ka pësuar sërish një rritje të lehtë dhe dërgesat nga azilkërkuesit kanë luajtur sigurisht rol në këtë rritje, sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë. Sidoqoftë, ato që konsiderohen si dërgesa nga azilkërkuesit, në të shumtën e rasteve përdoren për shlyerje të borxheve dhe huave bankare që migrantët kanë marrë në Shqipëri për të financuar udhëtimin në vendin pritës.

53 Gëdeshi, I. and de Zwager, N. (2012) Effects of the global crisis on migration and remittances in Albania, in: Sirkeci, I., Cohen, J.H. dhe Ratha, D. (eds) *Migration and Remittances during the Global Financial Crisis and Beyond*. Washington DC: Banoka Botërore, f. 237–254.

Donika, një grua nga Belshi, thotë:

Paratë që na jepnin ishin vetëm për konsum, vetëm në vendin pritës. Nuk duhet t'i dërgonim diku tjetër. Po ne dërguam para në Shqipëri, duhej ta bënim, kishim borxhe për të shlyer. Dërgonim shuma të vogla herë pas here për të shlyer borxhet dhe për të kursyer ndonjë gjë, pasi e dinim që do të ktheheshim në Shqipëri.

Mosshlyerja e borxheve, sidomos bankave ose të njohurve, ishte një burim i vazhdueshëm stresi dhe shqetësimi për individët dhe familjet e tyre. Edvini, një egjiptian nga Shkodra, tha:

Pasi u ktheva nga Gjermania, shkova në Prishtinë për të mbledhur kanoçe. Me duhej të fitoja para, që të paguaja borxhin. Nuk mund të kthehesha në Shqipëri, se kisha borxhe. Qëndrova për gjashtë muaj në Prishtinë, derisa bëra paratë.

Po ashtu, ka raste të familjeve shqiptare që nuk kanë mundur t'i shlyejnë borxhet. Genti, një baba nga Kamza, thotë:

'Kam 1 000 euro borxh për të shlyer në Shqipëri. Nuk e di kur apo nëse do të jem në gjendje ta paguaj.'

Një tjetër arsye për dërgesat në para ishte ndihma për familjarët (kryesisht, të moshuar ose të sëmurë) në shtëpi. Besimi, një i ri nga Tirana që kishte qenë azilkërkues në Gjermani bashkë me prindërit, thotë:

Vëllai im qëndroi në Shqipëri, sepse nuk vinte dot me ne, se ishte i sëmurë. Ne e ndihmuam vëllain. I dërgonim para me MoneyGram.

Të tjerë i dërguan kursimet e tyre në shuma të vogla, nga frika se mos i humbnin po t'i kontrollonte policia. Monika, një nënë e re nga Belshi, thotë:

Ata [azilkërkuesit e tjerë] thanë se, po të vinte policia për kontroll në banesë dhe të gjente një shumë të caktuar parash, e merrnin. Kështu, i dërguam paratë me shuma të vogla në Shqipëri.

Dërgesat u transferuan kryesisht përmes kanaleve formale (bankat dhe agjencitë e transfertave), por, ndonjëherë, edhe përmes atyre joformale. Përmes kanaleve formale, ato u transferuan përmes personave të tretë, të cilët kishin dokumente identifikimi të ligjshme. Merita, një grua nga Belshi, foli për përvojën e saj:

Ne i dërgonim paratë me një ndërmjetës, në shumicën e rasteve ishin kosovarë. E bëmë kështu, që të shmangnim problemet. Në Gjermani jetonim me asistencë sociale dhe po ta merrnin vesh autoritetet se kishim dërguar para, do të mendonin se paratë që kishim ishin 'më shumë se mjaftueshëm', meqë kishim dërguar ca në Shqipëri.

Ndërmjetësuesit e dërgesave i ofronin falas këto shërbime ose me një tarifë të vogël. Edlira, një grua nga Tirana, thotë:

Ne i dërgonim paratë me anë të disa kosovarëve që kishin dokumente. Ata i dërgonin paratë përmes bankës, po donin bakshish. (...) I dërguam para vjehrrit, që pastaj ia dha personit të cilit ia kishim marrë borxh.

Ndonjëherë, paratë dërgoheshin përmes kanaleve joformale, si azilkërkuesit që ktheheshin vullnetarisht në Shqipëri, njerëz që shkonin të vizitonin të afërmit ose shoferë autobusi. Arbeni, një baba nga Përmeti, i dërgoi paratë në Shqipëri me anë të një shoku, që ishte shofer kamioni. Ai tha: 'Kisha një shok nga Berati, që blinte materiale ndërtimi dhe i transportonte në Shqipëri. I dërgova paratë me të'. Ervin, nga Gjirokastra, tregon për një taktikë më ndryshe:

I dërgova paratë me postë. Herë pas here, dërgoj pako të vogla me veshje për vajzën time. Brenda veshjeve fusja 200–300 euro.

Të tjerë i morën me vete paratë kur u kthyen vullnetarisht në Shqipëri.

Ka, po ashtu, familje që i humbën kursimet kur policia i ktheu me forcë. Kështu ndodhi me Altinin, një i kthyer nga Tirana:

Na ktheu policia (...). Kishim kursyer 1 000 euro, po nuk e di pse m'i morën kursimet. Na kontrolluan dhe gjetën paratë.

6.5 Punësimi

Gjetja e një pune në vendin pritës është objektivi kryesor i azilkërkuesve shqiptarë. Arturi, kryefamiljar në Kamëz, e pohon këtë:

'Aplikuam për azil (...) me shpresën se do të mund ... të punonim dhe jetonim atje'.

Gjatë qëndrimit në vendin pritës, disa azilkërkues shqiptarë punuan në sektorin formal ose jo formal ose bënë punë sociale. Përveç të ardhurave, ata përfituan edhe përvojë të re pune, një kapital social dhe mendësi të re. Kapitali i ri social e njerëzor që fituan, siç do e shohim, i ndihmoi shumë prej tyre të fitonin kontrata pune dhe të mund të migronin ligjërisht në të ardhmen.

Shumë pak azilkërkues shqiptarë punuan në sektorin formal të vendit pritës.⁵⁴ Ata që e bënë, patën kontrata të rregullta pune dhe punuan në industrinë e ndërtimit dhe në shërbime. Flamuri, kryefamiljar nga Kukësi, tha:

Në Gjermani, punova në ndërtim dhe fitoja 1 800 euro në muaj. Paguaja taksat, sigurimet, shkollën e fëmijëve dhe qiranë.

Në shumë raste, njerëzit gjenin kënaqësi kur punonin, sepse ishin në gjendje të siguronin jetesën e tyre. Ky ishte rasti i Ervinit, egjiptian nga Berati, i cili thotë:

E mora vonë lejen e punës dhe punova për gjashtë muaj në një fabrikë që prodhonte pije (...) Ambalazhoja pijet dhe paguhesha 1 400 euro në muaj, por ndihesha i lumtur, sepse punoja dhe përballoja jetesën time atje.

Në raste të tjera, punët kishin lidhje me profesionin dhe arsimin që kishin marrë në Shqipëri, të cilit i shtuan një përvojë të re pune jashtë vendit.

54 Hackaj dhe Shehaj (2017) theksojnë se, edhe pse 'qeveria federale gjermane ka hapur 100 000 vende të vogla pune me kualifikim të ulët për azilkërkuesit në sektorin publik', asnjë prej shqiptarëve që intervistuan 'nuk kishin dijeni për këtë mundësi' (për më shumë informacion, shih: Hackaj, A. dhe Shehaj, A. (2017) *Jashtë sistemit: Kthimi nga Gjermania dhe riintegrimi i azilkërkuesve shqiptarë*. Tiranë: Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Dokument Pune – Seritë e Procesit të Berlinit).

Gëzimi, një i ri nga Pogradeci, e përshkruan punën e tij në Gjermani:

Punova një vit në profesionin për të cilin kisha studiuar, mekanik makinash. Punova me kohë të pjesshme. Edhe gruaja punonte si ndihmëskuzhinieri në një restorant, se këtë formim kishte.

Disa të tjerë bënë punë sociale në kampe ose institucione publike, si pastrimi i hapësirave të përbashkëta dhe mirëmbajtja e kopshtit. Donika, një nënë e re nga Belshi, përshkroi punën e saj:

Punova në kopsht fëmijësh. Më ndihmoi një fqinj gjerman. (...). Më çoi në një kopsht fëmijësh dhe punova atje si vullnetare. Punoja rreth dy orë pasdite për të pastruar kopshtin.

Në shumë raste, këto punë paguheshin shumë pak, shpesh, 1 euro në orë, por, megjithatë, u shtonin diçka të ardhurave dhe kursimeve familjare. Elvira, një grua tjetër nga Belshi, ndau përvojën e saj:

'Punoja si ndihmëse në një azil pleqsh në Gjermani dhe merrja rreth 200 euro në muaj'.

Të tjerë punuan në sektorin joformal (p.sh. në ndërtim, ngarkim-shkarkim në magazina, riciklim, kopshtari, bujqësi, shërbime), po rreziku ishte i madh, po të kapeshin nga autoritetet. Luani, banor i Bashkisë së Tiranës, u shpreh:

Punoja aty-këtu; për shembull, laja xhamat dhe paguhesha 40 euro në ditë. Punoja në ndërtim dhe paguhesha mirë. Kur kishte punë, punoja edhe në kopshtari.

Të tjerë bënë punë të rastit, si riciklimi i shisheve plastike. Petriti, një burrë në moshë të mesme nga Gjirokastra, tha:

Sa herë kishte festa, ne mblidhnim shishet plastike, të gjithë, kush të mundej. Kushtonin 25 centë secila, kështu që katër bënin 1 euro. Nga një ngarkesë e plotë mund të fitonim rreth 100 euro. (...) Gjermanët pinin dhe i hidhnin shishet (...). Megjithatë, ishin më shumë romët ata që i mblidhnin shishet.

Azilkërkues të tjerë, kryesisht të rinjtë, punonin në ndërtim, si bojaxhinj ose në bare dhe restorante. Arturi, një i ri nga Vlora, thotë për të njohurit e tij:

Afër vendit ky jetoja kishte disa bare dhe restorante greke dhe një italian. Secili kishte punësuar azilkërkues shqiptarë për të larë pjatat. I paguanin 1 000 euro në muaj. Pronari përfitonte dhe ata përfitonin. Punonin në të zeze, në mënyrë të paligjshme.

Disa azilkërkues treguan se kishin ndjekur kurse profesionale dhe kishin kryer disa praktika pune në vendin pritës. Artani nga Korça tha:

'Gruaja ime ndoqi një kurs gjermanishteje. Ajo mësoi ca gjermanisht. Ishte si shkollë profesionale, ofronin kurse për kuzhinier, parukier e kështu me radhë'.

Emini, një rom nga Tirana, shkonte dy herë në javë në një restorant në Francë, që të mësonte punën:

'Isha çirak në një restorant. Punoja dy herë në javë, nga mëngjesi deri në drekë dhe ishte falas.'

6.6 Kujdesi shëndetësor

Për disa azilkërkues shqiptarë, kujdesi shëndetësor ishte faktori kryesor shytës. Shumë prej tyre përfituan nga shërbimet e kujdesit shëndetësor të ofruara në vendin pritës. Në intervista dhe diskutimet në grupet e fokusuara, thuajse të gjithë të kthyerit folën për cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor falas në Gjermani dhe Francë. Majlinda, një nënë e përkushtuar nga Kukësi, na thotë për të birin:

'Im bir u trajtua për tetë vjet në Shqipëri dhe asnjë ndryshim. U bë më keq. Nuk kishim mjete financiare për ta kuruar jashtë. Për këtë arsye, kërkuam azil (...) Në Gjermani, ai u kurua, u operua dhe u çua në një shkollë për fëmijët me aftësi të kufizuara. (...) Atje pati një ecuri të dukshme, mori hov në zhvillim dhe mësoi gjermanisht. (...) Pas një viti e gjysmë, kur u kthyem në Shqipëri, njerëzit nuk e njihnin. Kishte ndryshuar kaq shumë.'

Personat që emigruan për arsye shëndetësore në Gjermani u shtruan dhe u kuruan në spitale. Disa prej tyre e vazhdojnë trajtimin dhe lejohen të qëndrojnë në vendin pritës, edhe pas kthimit të familjes në Shqipëri. Florenti, një baba nga një fshat i Kukësit, ndan historinë e tij:

'Kur shkua në Gjermani, kontaktua menjëherë mjekun e familjes dhe morëm të gjitha shërbimet e nevojshme për djalë për një periudhë rreth tre vjet. Tani ai është më mirë dhe vazhdon të mjekohet. Ne jemi kthyer, por ai vazhdon të qëndrojë në Gjermani (...) dhe shkon në shkollë. Tani po ndjek vitin e parë në një kolegji dhe studion informatikë.'

Edhe të tjerë që u sëmurën rëndë gjatë qëndrimit në Gjermani u kuruan në spitale. Kështu ndodhi edhe për Agronin nga Fushë-Kruja:

Për fat të keq, u sëmura në Gjermani, por u shtrua në spital dhe pata një ndërhyrje. Herën e parë qëndrova 18 ditë në spital dhe herën e dytë 21 ditë. Mjekët më dhanë të gjitha dokumentet dhe më thanë të vizitohesha te mjeku specialist në Shqipëri çdo gjashtë muaj.

Në raste të tjera, mjekët gjermanë rekomanduan spitalet në Shqipëri, ku duhej vazhduar terapia.

Azilkërkuesit shqiptarë ishin shumica të rinj dhe disa prej tyre u bënë prindër kur ishin në Gjermani. Vjollca, një nënë 26-vjeçare rome, ndau përvojën e saj:

Kur linda vajzën, qëndrova dy ditë në spital. Mjekët dhe infermieret u kujdesën maksimalisht. (...) Përveç kësaj, në shtëpi më vizitoi Caritas-i dhe më solli rroba për veten dhe foshnjën.

Të intervistuarve u kishte lënë mbresë të veçantë kujdesi shëndetësor për fëmijët. Shumë prej tyre theksuan se fëmijët e tyre ishin vaksinuar në Gjermani dhe u ishte dhënë kartela përkatëse.

6.7 Arsimi

Arsimi dhe një e ardhme më e mirë për fëmijët është një tjetër shtysë pse shumë familje shqiptare kanë kërkuar azil apo dëshirojnë të migrojnë në vendet e BE-së. Sipas intervistave dhe diskutimeve, thuajse të gjithë fëmijët e azilkërkesve ishin regjistruar menjëherë në shkolla ose kurse gjuhe në Gjermani dhe Francë. Tekstet shkollore, baza materiale dhe transporti ishin falas.

Fëmijët më të vegjël nisën menjëherë shkollën, pa u dashur të studionin gjuhën më parë. Megjithatë, mësuesit gjermanë i ndihmonin më shumë gjatë orës së mësimit. Avniu, një baba nga Berati, foli për fëmijët e tij:

Tri vajzat e mia filluan menjëherë shkollën, sipas moshës. Më e madhja nisi klasën e katërt, e mesmja klasën e dytë dhe më e vogla klasën e parë 1. Vajza e madhe nuk bëri kurs gjermanishteje, po e mësoi shumë shpejt gjuhën. Mësuesit ishin shumë të mirë me fëmijët dhe i mësuan mirë. I mbanin fëmijët edhe dy orë shtesë jashtë klase dhe i ndihmonin. Ndërkohë që përparonin, fëmijët rrinin më pak pas mësimit. (...) Fëmijët e ndoqën shkollën për 17 muaj. Ato flasin dhe shkruajnë gjermanisht mirë.

Kujdesi i mësuesve gjermanë u kishte bërë përshtypje shumë prindërve azilkërkes, që i kishin dërguar fëmijët në kopsht, ku mësonin 'bashkë me fëmijët gjermanë'.

Nxënësit që ndiqnin klasat më të larta në arsimin publik, u regjistruan më parë në kurse gjuhe dhe pastaj, vazhduan të ndiqnin mësimin e rregullt. Agroni, një i ri rom nga Tirana, tha për përvojën e tij:

Shkolla për mua ishte falas. Transporti për në shkollë ishte falas, gjithashtu. Nuk e fillova menjëherë shkollën, se m'u desh të bëja kurse gjermanishteje në fillim (...). E mësova mirë gjuhën dhe fillova klasën e 10-të. Në Shqipëri kisha përfunduar klasën e nëntë dhe atje vazhdova klasën e dhjetë, pasi studiova gjermanisht për një vit.

Mësimi i një gjuhe të huaj (gjermanishte, frëngjishte) vlerësohej shumë nga prindërit, të rinjtë dhe vetë fëmijët. Disa prej të rinjve ndoqën shkolla profesionale, ku, përveç lëndëve mësimore, mësonin edhe një zanat. Mondit tha:

Ishte një shkollë formimi profesional, por, më parë, më duhej të mësoja gjuhën, pastaj të shkoja në shkollë. Zanati që do të mësoja ishte lyerja e makinave.

6.8 Kapitali i ri social

Ashtu si të gjithë migrantët, shqiptarët që lëvizin kanë mundësinë të përfitojnë nga kapitali i tyre social, të cilin mund ta përdorin në të gjitha fazat e migracionit. Në vendin pritës, ata fitojnë kapital social të ri. Në kampe, në apartamentet ku kanë qëndruar, në kurse gjuhe apo profesionale, në vendet ku kanë punuar apo institucione të ndryshme ku kanë marrë shërbime, janë bërë miq me shqiptarë të tjerë dhe migrantë nga Kosova⁵⁵ e vende të tjera, si dhe me njerëz nga vendi pritës. Ermiona, një grua nga Belshi, thotë:

'Kur u transferoheshin nga kampi në apartament, ndonjëherë, fqinjët ishin gjermanë. Ishim në kontakt të përditshëm me ta'.

Sipas intervistave dhe të dhënave të grupeve të fokusuara, këto lidhje të reja të vendosura gjatë qëndrimit në vendin

55 Referencat për Kosovën do të kuptohet se janë në kontekstin e rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara..

pritës ruhen dhe ushqehen përmes rrjeteve sociale (Facebook, Skype, e-mail).

Afërdita, një edukatore kopshti nga Elbasani, ndan një përvojë të ngjashme:

Kur isha në Gjermani, u miqësova me mësuesen e vajzës dhe një edukatore kopshti, ku punoja si ndihmëse. Kam disa vite që jam kthyer [në Shqipëri], po vazhdoj të rri në kontakt me to. Flasim shpesh në Skype.

Pyetje që lind, për rrjedhojë, është “për çfarë shërben ky kapital i ri social”. Sigurisht, për shumë shqiptarë të kthyer, interesi i parë është punësimi në vendin pritës. Agimi nga Peshkopia e përdori këtë kapital social për të fituar një kontratë pune në Gjermani. Ai thotë:

Kam shumë miq gjermanë. Isha në Gjermani dhe kam dy ditë që jam kthyer. Shkova si turist, të takoja miqtë e mi. Pata mundësi gjithashtu të gjeja një kontratë pune dhe tani kam aplikuar për vizë pune.

Arbeni, një rom nga Tirana, ndan një përvojë të ngjashme:

Pasi u ktheva, shkova sërisht në Gjermani dhe punova në të zezë, në magazinën e një turku. Ai më ofroi një punë dhe unë ngarkoja e shkarkoja mallra. E takova në Gjermani, kur shkova herën e parë. (...) Përveç tij, njoh edhe të tjerë gjermanë, turq e shqiptarë dhe komunikoj me ta përmes medias sociale.

Të tjerë mendojnë t'i përdorin këto lidhje në të ardhmen, pasi të kenë mësuar një zanat në Shqipëri. Rrjedhimisht, informacioni i tregut të punës, mundësitë e punësimit dhe gjetja e një kontrate pune në Gjermani janë të nevojshme për migrantët e mundshëm. Arshi, një rom nga një fshat i Fierit, shpreson të emigrojë duke shfrytëzuar këto lidhje të reja:

Unë dua të migroj sërisht në Gjermani, po, kësaj here, jo për të kërkuar azil. Kam disa miq kosovarë që jetojnë e punojnë atje në Gjermani prej vitesh. (...) Ata më thonë vetëm të shkoj dhe do më gjejnë kontratë pune. I krijova lidhjet me ta në Gjermani. Komunikojmë përmes rrjeteve sociale.

Të kthyerit e tjerë i përdorin njohjet e krijuara në Gjermani për të zhvilluar tregti me pakicë. Petriti, drejtues i një organizate rome në Tiranë, shpjegoi:

‘Disa romë kanë krijuar kontakte me disa njerëz në Gjermani dhe ata u dërgojnë mallrat për shitje me autobusë.’

Në intervista dhe grupe të fokusuar, të kthyerit thonë se kanë shfrytëzuar kontaktet e tyre shoqërore edhe për të marrë dokumente të rëndësishme nga Gjermania (dëftesa shkolle etj.) ose për të gjetur barna që nuk janë në Shqipëri.

7. Kthimi dhe riintegrimi në vendin e origjinës

Mundësitë që një azilkërkues nga Shqipëria të marrë përgjigje pozitive për aplikimin e tij/saj janë shumë të vogla. Në vitet 2015 dhe 2016, vetëm një nga 50 azilkërkues nga Shqipëria mori përgjigje pozitive.⁵⁶ Kjo shpjegohet me faktin se Shqipëria dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor konsiderohen që prej fundit të vitit si “vende të sigurta të origjinës”, çka e bëri edhe më të vështirë dhënien e azilit.⁵⁷

7.1 Arsyet e kthimit

Azilkërkuesit shqiptarë mund të ndahen në dy grupe lidhur me kthimin e tyre në Shqipëri. Grupi i parë përbëhet nga ato familje ose individë që kthehen vetë në Shqipëri, pa njoftuar dhe pa marrë orientime nga autoritetet e vendit pritës. Ky është një grup i vogël (më pak se 10 %) dhe arsyet që japin për kthimin janë të ndryshme. Disa prej tyre nuk i përballonin dot më kushtet e vështira dhe ushqimin në kampe dhe pjesëtarët e familjes donin të ktheheshin. Ermira, një studente që aplikoi për azil bashkë me familjen, tregoi historinë e saj:

Rrinim në një çadër dhe nuk na pëlqeu ushqimi në kamp. Kjo na bëri të ktheheshim. Nuk e përballonim dot të jetonim në ato kushte.

Të tjerë u kthyen në Shqipëri për shkak të fatkeqësive familjare (p.sh. humbja e një familjari, sëmundja). Drita nga Korça ndau përvojën e saj:

U kthyem në prill 2016, se m'u sëmur babai. Akoma nuk na kishin dhënë përgjigje [për kërkesën për azil]. Paguam vetë për udhëtimin me paratë e muajit.

Po kështu, kishte raste kur largimi i një pjese të familjes krijonte pasiguri dhe shqetësim për të qëndruar më gjatë. Shpresa, një nënë e vetme nga Korça, përshkroi situatën e saj:

Isha në Gjermani me vajzën dhe familjen e motrës. Jetonim në të njëjtën shtëpi. Kisha një dhomë dhe një kuzhinë; po kështu edhe motra. Familjes së motrës i erdhi vendimi për t'u larguar, kurse mua më lanë të qëndroja, se duhej të kurohesha... Kërkova të largohem nga Gjermania vullnetarisht. Pasi motra ime dhe shqiptarë të tjerë që jetonin në të njëjtën banesë u larguan, më thanë se do të sillnin sirianë dhe u tremba. (...) U ktheva nga frika.

Grupi i dytë, (më shumë se 90 %) përbëhet nga ato familje ose individë që u kthyen në Shqipëri, pas marrjes së vendimit negativ nga autoritetet e vendit pritës. Disa prej tyre e ankimuan vendimin dhe morën një avokat, por rezultati mbeti i

56 World Bank Group (2019) *Mbështetja e riintegritit efektiv të të kthyerve romë në Ballkanin Perëndimor*. Washington DC: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Banka Botërore.

57 Komisioni Evropian e konsideron një vend si të sigurt, nëse është demokraci dhe nuk ka persekutim të përgjithshëm apo të përhershëm, torturë, trajtim dhe çnjerëzor; kërcënim për dhunë apo konflikt të armatosur.

njëjtë. I vetmi përfitim i ishte zgjatja e qëndrimit, po pagesa e avokatit nuk ishte e papërfillshme, krahasuar me buxhetin e tyre. Gjergji, një azilkërkues i kthyer nga Tirana, tregoi për përvojën e tij:

'Pas përgjigjes negative të kërkesës për azil, vazhduam të përpiqeshim. Kishim dëgjuar se duhej të merrnim një avokat dhe ta paguanim. (...) Avokati ishte optimist dhe tha, meqë ishim nga komuniteti rom, kishim shanse të mira për të fituar. Na kërkoi 400 euros. Përdorëm të gjitha paratë që kishim kursyer për ta paguar. Shpresuam që avokati të na ndihmonte me rastin, po as ai nuk ia doli. Pas dy muajsh morëm një letër dhe avokati na tha që nuk bënte dot gjë, se ato ishin ligjet.'

Brenda këtij grupi ka dy nëngrupe. I pari përbëhet nga ato familje apo individë që janë kthyer vullnetarisht pas refuzimit të kërkesës. Ata e dinin që nuk qëndronin dot më gjatë në vendin pritës dhe nuk donin të merreshin masa (nga frika se do t'u merrej pasaporta). Artani, një baba që jeton në periferi të Peshkopisë, thotë:

Bëra gjithçka për të qëndruar në Gjermani; nuk doja të kthehesha. Shkova atje për të ardhmen e fëmijëve (...). Megjithatë, e kuptova që nuk i realizoja dot planet e mia. U ktheva vullnetarisht. Erdha në Shqipëri.

Disa prej familjeve të kthyer vullnetarisht morën edhe ndihmë materiale e financiare kur u larguan. Ndihma synonte të stimulonte kthimin vullnetar, të nxiste një kthim të qëndrueshëm për azilkërkuesit dhe të parandalonte rrimigrimin.⁵⁸ Vendet e BE-së e japin këtë ndihmë vetë ose në bashkëpunim me organizata, si Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM). Ndërkohë, shumë OJF që veprojnë në këto vende ofrojnë ndihmë për kthimin. Një numër pjesëmarrësish në diskutimet e grupeve të fokusuara dhe në intervista raportuan lidhur me këtë ndihmë për kthimin, efektiviteti i së cilës mbetet për t'u vlerësuar. Marjeta, një nënë e re nga Kamza, tha:

Në Gjermani, përpara sesa të largoheshim, na dhanë rroba të reja për të gjithë familjen. Na dhanë edhe 300–400 euro mua dhe 300–400 burrit, si dhe nga 200 fëmijëve.

Të tjerë u shprehën se kishin marrë rreth 250 euro, plus biletën e udhëtimit për në Shqipëri. Në disa raste të veçanta, familja mund të kishte përfituar pas kthimit në Shqipëri, duke marrë ndihmë financiare edhe për disa muaj. Nazmiu nga Kamza, i cili ka dy fëmijë të paralizuar, thotë:

Pasi u ktheva në Shqipëri, mora ndihmë financiare për katër muaj. Një muaj më dërguan 250 euro, një muaj tjetër 300, tjetrin 150 dhe një muaj 100 euro. I mora paratë kur isha në Shqipëri dhe dërgova e-mail për të konfirmuar marrjen.

Nëngrupi i dytë, i cili është sigurisht më i vogël, përbëhet nga ata që janë kthyer me forcë nga policia. Në këtë rast, autoritetet e vendeve të BE-së mund të ndërmarrin sanksione ose masa shkurajuese, si ndalimin e hyrjes së një personi në BE për një afat të caktuar, mosdhënien e ndihmës për kthimin, etj. Shumë familje dhe individë të këtij grupi shpresonin se do ishin në gjendje të zgjatnin qëndrimin në vendin pritës. Bledari nga Gjirokastra, i cili njezh shumë familje që janë kthyer forcërisht, thotë:

'Ne shpresuam deri në fund (...). Ndoshta për të fituar pesë euro më shumë apo për të marrë një kontratë pune.'

58 Vlera e ndihmës ndryshon sipas vendit dhe në përputhje me përkufizimin e tyre të grupeve në nevojë. Përgjithësisht, këto grupe përfshijnë të miturit e pashoqëruar, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, gratë kryefamiljare etj. Gjermania dhe Franca, për shembull, mbulojnë kostot e udhëtimit dhe japin para për shpenzime. Në raste të veçanta, ofrohet edhe një sasi ndihme financiare.

Të tjerë shpresonin se avokati që kishin marrë do të arrinte të bënte që vendimi të rishikohej apo të zgjatej qëndrimi në vendin pritës, por, zakonisht, pa sukses, siç pamë në rastin e Gjergjit, më sipër.

Eksperiencat e kthimit me forcë nga policia janë të ndryshme. Rajmonda, një nënë nga një fshat i Belshit, na thotë për përvojën e saj:

'Policia erdhi në gjashtë të mëngjesit dhe na tha të bëheshim gati. Na pritën derisa u bëmë gati dhe u nisëm për në aeroport. Fëmijët u trembën pak, po nuk pati asnjë dhunë nga policia.'

Megjithatë, disa të intervistuar kishin kaluar përvoja traumatike, sidomos fëmijët, nga kthimi i detyruar në Shqipëri. Drita, një mësuese nga Durrësi që punon në një qendër sociale, ndau përvojën e saj:

'Në rastin e kthimeve me forcë, fëmijët kalojnë traumë dhe e kanë të vështirë ta marrin veten, se janë trembur shumë. Janë trembur kur kanë parë oficerë policie në 4 të mëngjesit në derë, nga mënyra si janë nxjerrë nga shtëpitë e tyre...'

7.2 Kthimi në atdhe

Kthimi në atdhe i azilkërkuesve shqiptarë – të cilët mund të kenë kaluar muaj ose edhe vite në vendin pritës – shoqërohet me stres të fortë emocional.

Kontakti i parë për migrantët e kthyer me forcë është me policinë në pikën e hyrjes kufitare të vendit (aeroporti ose pikat tokësore të kalimit kufitar). Pjesëmarrësit thanë se ndërveprimet e tyre me policinë kufitare ishin të gjitha siç duhet. Avniu, një kryefamiljar nga Berati, e përshkroi me fjalë të thjeshta:

Kur erdha në aeroport, policia [shqiptare] na kishte marrë pasaportat. Më thirrën emrin, mora pasaportën dhe u ktheva me familjen në Berat.

Të tjerë theksuan se nuk i kishin ndihmuar. Valbona, një grua e moshuar nga Korça, foli për përvojën e saj:

Kur erdha në Tiranë, nuk kisha para. I thashë policisë se, në Gjermani, na kthyen vetëm me rrobat e trupit dhe nuk kemi gjë me vete. Unë lashë edhe kartën e identitetit dhe paratë në Gjermani. Na dhanë vetëm pasaportën, asgjë tjetër. Për t'u kthyer në Korçë, vajta te një i afërm dhe mora borxh ca para për të paguar shoferin.

Ndërkohë, migrantët e kthyer vullnetarisht, hynë si qytetarët normalë.

Shumica e të intervistuarve janë kthyer në vendbanimet e mëparshme, ku, përgjithësisht, i presin të afërmit, fqinjët dhe komuniteti. Sipas pjesëmarrësve në grupet e fokusuara, marrëdhëniet shoqërore rivendosen shpejt dhe anëtarët e komunitetit tregojnë interes për eksperiencën e të kthyerve në vendin pritës. Andra, një grua e re nga Belshi, përshkruan përvojën e saj të kthimit:

Marrëdhëniet me komshinjtë kur u kthyem ishin edhe më të mira. Meqë u kthyem nga jashtë, ata ishin kureshtarë dhe donin të dinin më shumë. (...) Më pyetën nëse kisha mundur të bëja para apo të kurseja (...). Po ne, si ikëm, erdhëm.

Tilla marrëdhënie të mira ekzistojnë edhe në komunitetet rome dhe egjiptiane. Elona, një drejtuese informale në një vendbanim rom në Tiranë, e përshkroi si:

I sheh bashkë për kafe ose duke shkuar për vizitë te njëri-tjetri (...). Shumë banorë të komunitetit janë të interesuar të dëgjojnë për përvojën e tyre jashtë.

Riintegrimi i shpejtë i familjeve të kthyer në komunitet mund të shpjegohet nga qëndrimi i shkurtër në vendin pritës dhe nga ruajtja e komunikimit dhe marrëdhënieve miqësore me anëtarët e komunitetit në atdhe. Sidoqoftë, në disa raste, ka xhelozë (për shkak të kursimeve financiare) ose mund shihet rishfaqje e konflikteve të vjetra.

Solidariteti dhe ndihma që anëtarët e komunitetit u japin familjeve të kthyer është e konsiderueshme. Fuati, nga Fushë-Kruja, i cili pati një ndërhyrje kirurgjike në Gjermani dhe për shkak të sëmundjes, nuk punon dot, merr mbështetje financiare nga anëtarët e komunitetit. Në raste të tjera, Enveri nga Tirana, shtëpia e të cilit u shemb për të lejuar ndërtimin e rrugës, tha se, për disa javë pasi u kthye, u strehua nga të afërmit. Megjithatë, ky kapital social shteron dhe duhet ndërhyrja e institucioneve, që këto probleme të zgjidhen në mënyrë të qëndrueshme.

7.3 Riintegrimi

Shqiptarët e kuptojnë riintegrimin në atdhe në shumë përmasa. Ata bien dakord se riintegrimi i tyre lidhet me punësimin në sektorin formal dhe mundësitë e tregut, me sigurimin e mbrojtjes sociale, shkollimin për fëmijët, kujdesin shëndetësor, strehimin, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe infrastrukturës, sigurinë, mungesën e diskriminimit dhe pjesëmarrjen në jetën shoqërore. Ata theksojnë se pushteti qendror dhe vendor, organizatat ndërkombëtare dhe shoqëria civile duhet të angazhohen të gjitha në një fushatë të përhershme për të përmirësuar kushtet e tyre të jetesës.

Për shumë të kthyer, koncepti i riintegritimit është dinamik dhe është pasuruar (d.m.th. janë bërë më kërkesë) pas kthimit nga vendi i azilit. Ata krahasojnë elemente të ndryshme të jetës ekonomike dhe shoqërore të dy vendeve dhe kërkojnë ndryshime thelbësore. Ismaili, një rom nga Korça, e tha me fjalë të thjeshta:

‘Së pari, duam të kemi një punë, një jetë më të kulturuar. Le të marrim atë që bëjmë gjermanët dhe ta zbatojmë këtu. Ky është integrimi për mua.’

7.4 Punësimi

Papunësia dhe mungesa e të ardhurave janë sfidat kryesore me të cilat përballen shumica e azilkërkuesve të kthyer shqiptarë. Më shumë se gjysma e tyre janë pa punë, ndërkohë që shumë të tjerë gjejnë vetëm punë rastësore, të pakualifikuara në sektorin joformal. Mimoza, një punonjëse e vjetër e zyrës së punës në Kukës, tha:

‘Kur kthehen, vijnë te zyra e punësimit dhe regjistrohen si të papunë. Ata rifuten në skemat e ndihmës ekonomike. Më parë, kërkojnë punësim, po ne nuk kemi shumë mundësi punësimi për t’iu ofruar (...). Shkalla e papunësisë është shumë e lartë në qytetin tonë.’

Këto përshtypje konfirmohen edhe nga të dhënat zyrtare që tregojnë se, pavarësisht përmirësimeve të lehta gjatë viteve të fundit, papunësia te të rinjtë (mosha 15–24 vjeçe) në Shqipëri është 27,3 për qind.⁵⁹

Mes kësaj shkalle kaq të lartë papunësie, të kthyerit janë regjistruar në zyrat e punësimit për të gjetur punë, por rezultatet kanë qenë mjaft shkrajuese, për shkak të mungesës së vendeve ekzistuese dhe të reja të punës. Për punët që janë të vlefshme, pagat janë aq të ulëta sa të demotivojnë.

Ndriçimi, kryefamiljar nga Berati, përshkroi përvojën e tij në zyrën e punës:

'Problemi i parë që pata kur u ktheva ishte të gjeja një punë. Nuk kam asnjë perspektivë punësimi. Shkova te zyra e punës, po nuk ka punë. Gruaja dhe unë vajtëm bashkë atje dhe na thanë se, për momentin, nuk kishte vende pune, por do të telefononin. U bënë shtatë muaj, po asnjë telefonatë deri tani. Kur i pyeta për ndihmën ekonomike, më thanë se isha i ri e duhej të punoja. (...) Arsytim është ky?!: Nuk ka punë dhe nuk të japin as ndihmë ekonomike.'

Genti, i cili ka qenë azilkërkues në Gjermani, tregoi një përvojë të ngjashme:

Pasi u ktheva, shkova në zyrën e punësimit dhe më thanë që do më telefononin. Shkova edhe pesë herë të tjera, po, deri tani, asnjë telefonatë. Nuk më japin ndihmë ekonomike, se më thonë që jam në gjendje të punoj. Megjithatë, kam katër fëmijë për të ushqyer. I vetmi burim të ardhurash për mua është ndonjë punë rastësore në të zezë. Kur gjej punë, sjell bukë në shtëpi; kur nuk kam, nuk kam ç'të sjell.

Shumë të kthyer nga azili janë të pakënaqur me mungesën e efikasitetit dhe sjelljen e keqe të burokracisë në shërbimin civil, konkretisht, të zyrave të punës. Ata citojnë shembuj nga institucione të ngjashme në Gjermani, duke i krahasuar të dyja. Edlira, një nënë nga Kukësi, thotë e indinjuar:

Pse duhet të shkoj te zyra e punës? Emrin e kam të regjistruar në sistem si e papunë. Ata më kërkojnë të regjistrohem prapë si e papunë. Duhet të shkoj çdo muaj. Në Gjermani ishte ndryshe. Për shembull, kur je pa punë në Gjermani, sistemi nxjerr të dhënat. (...) Kur regjistrohesh në zyrën e punës, brenda javës të marrin në telefon dhe ti fillon punë. (...) Këtu, zyra e punës është si teatër.

Të zhgënjyer nga institucionet e punësimit formal, shumë azilkërkues të kthyer përdorin rrethet shoqërore (të afërmit dhe të njohurit) për të gjetur një punë. Këto rrjete janë më efikase, edhe pse, shpesh, rezultati është i njëjti. Reshiti, kryefamiljar nga Berati, përshkroi përvojën e tij:

Kam një muaj e gjysmë që jam kthyer nga Gjermania dhe nuk gjej dot një punë. Pyes vërdallë njerëzit, po më japin vetëm punë me pagë shumë të ulët. Më thonë që nuk më paguajnë dot më shumë se 15 000 lekë në muaj [rreth 120 euro]. Është më keq se më parë. Edhe gruan e kam pa punë.

Të kthyer të tjerë përpiqen të gjejnë punë përmes shpalljeve ose vizitave të drejtpërdrejta te punëdhënësit e mundshëm, zakonisht, me pak sukses.

Të kthyerit e vetëpunësuar përballen gjithashtu me vështirësi të mëdha. Shumë prej tyre kanë humbur vendin në treg, klientët dhe furnitorët e tyre dhe e kanë të vështirë të përshtaten me kushtet e reja të tregut. Entela, një e re nga Tirana, tregoi historinë e saj:

Kur u kthyem në Shqipëri, ishim në kushte shumë të vështira ekonomike. Prindërit e mi, që shisnin rroba në treg më parë, i kishin humbur të gjitha lidhjet. U desh kohë që t'i rivendosnin.

Ndërkohë, të kthyer të tjerë, në varësi edhe të vendit dhe kohëzgjatjes së migracionit, duan të ngrenë biznese të vogla, kryesisht në shërbime dhe infrastrukturë. Duke mos pasur fonde të mjaftueshme për të nisur një biznes, financimi përmes kredisë bankare apo donatorëve ndërkombëtarë do të ishte një zhvillim i mirëpritur.

Situata është shumë më e vështirë për romët dhe egjiptianët – më të varfrit e më të varfërve⁶⁰ – për shkak të nivelit përgjithësisht të ulët arsimor dhe profesional, kapitalit social të kufizuar me popullsinë e shumicës dhe diskriminimit. Arturi, një i ri rom nga Tirana, shprehet:

‘Kur u kthyem nga Gjermania, familja ime qëndroi pa punë për tetë muaj, derisa babi gjeti punë’.

Nga të gjithë të kthyerit, papunësia te romët dhe egjiptianët është dukshëm më e lartë dhe ata janë më të ekspozuar sesa shumica e popullsisë.⁶¹

Arsyet pse azilkërkuesit e kthyer nuk mund të gjejnë punë janë të ndryshme. E para, ka në përgjithësi një mungesë të mundësive të punësimit në Shqipëri dhe kjo konfirmohet nga shumica e të kthyerve. Edlira, një nënë nga Kukësi, tha:

Është e pamundur të gjejsh punë këtu (...). Edhe po të kesh diplomë universiteti, nuk mund të gjejsh punë. Unë, për shembull, kam tre veta në familje me universitet dhe asnjë prej tyre nuk ka gjetur punë asnjëherë.

Ndërkohë, të tjerë theksojnë se e kanë të vështirë t’u përshtaten kërkesave të tregut të punës në Shqipëri, pasi u mungon arsimimi dhe kualifikimet dhe ekspertiza profesionale e nevojshme. Një faktor tjetër shtesë janë pagat e ulëta dhe kushtet e vështira të punës (orari i zgjatur, largësia nga shtëpia, puna e vështirë etj.) të cilat demotivojnë shumë njerëz dhe i bën të mos punojnë në industrinë mbizotëruese fason apo në shërbime. Avniu, i cili jeton në Belsh, thotë:

Në qytetin tonë ka vetëm dy mundësi për punë: ose të punosh në një nga këto fabrikat ose si kamerier në bar apo restorant. Po ata të paguajnë vetëm 500 lekë në ditë (rreth 4 euro). Çfarë të blesh me aq?!

Mungesa e infrastrukturës sociale (çerdhe, kopshte etj.) është një tjetër faktor që nuk i lejon shumë gra dhe nëna të reja të marrin pjesë në proceset prodhuese. Merita, një nëpunëse në bashkinë e Cërrikut, thotë:

Në territorin e bashkisë sonë është e vështirë të gjejsh një punë. Shumë gra e nëna të reja mund të shkojnë në Elbasanin fqinj, ku disa fabrika kërkojnë punëtorë të rinj. (...) Por në qytezën tonë nuk ka kopshte ose çerdhe. Si rezultat, nuk ka kush të kujdeset për të vegjlit kur nënat janë në punë.

Duke e gjetur veten pa punë, shumë të rinj shqiptarë migrojnë për periudha të shkurtra në BE, duke shfrytëzuar vizat Shengen për të punuar në sektorin informal. Këto viza, siç u përmend më sipër, i lejojnë mbajtësit e pasaportave nga Shqipëria të lëvizin brenda zonës së Shengenit për 90 ditë brenda një afati 180-ditor. Në disa raste, ky është migracion ciklik (migro për 90 ditë, kthehu në Shqipëri, migro sërish), që mund të kthehet në migracion afatgjatë në të ardhmen (shih Rubrikën 8). Ka raste kur këto migrame ciklike janë të mirëorganizuara dhe të bashkërenduara. Altini, një nëpunës i pushtetit vendor në një qytet në veri të Shqipërisë, thotë:

Në qytetin tonë, gratë punojnë si dado fëmijësh në familjet kosovare në një vend të BE-së. Ato i njohën këto familje gjatë kohës që aplikonin për azil. Në fund të periudhës 90-ditore, një kthehet dhe tjetra shkon te kjo familje. Ndërrohen me njëra-tjetrën.

60 De Soto, H., Gordon, P., Gëdeshi, I. and Sinoimeri, Z. (2002) *Poverty in Albania: A Qualitative Assessment*. Washington DC: Dokumenti Teknik i Bankës Botërore Nr. 520; De Soto, H., Beddies, S. dhe Gëdeshi, I. (2005) *Roma and Egyptians in Albania: From Social Exclusion to Social Inclusion*. Washington DC: Banka Botërore.

61 Një studim i Bankës Botërore tregon se papunësia në popullatën rome dhe egjiptiane (grupmosha 15–64 vjeçe) në vitin 2017 ishte 56 për qind, kundrejt 38 për qind për popullsinë e shumicës. Krahësuar me vitin 2011, papunësia për këto grupe pakice ishte 34 pikë përqindje më e lartë. Për informacione të mëtejshme, shih: Robayo-Abril, M. dhe Millán, N. (2019) *Breaking the Cycle of Roma Exclusion in the Western Balkans*. Washington DC: The World Bank.

Të tjerë të kthyer (kryesisht egjiptianë) shkojnë në Stamboll, ku punojnë në kushte të vështira (orare të zgjatura, pa sigurime shoqërore etj.) në industrinë prodhuese (prodhim tekstile, këpucë, çanta dhe valixhe etj.), si dhe në ndërtim, shërbime etj.⁶² Megjithatë, aty paguhen më shumë se në Shqipëri dhe me pagat që marrin përballojnë kushtet minimale të jetesës. Në shumë raste, fëmijët e grupmoshës 8–15 vjeçe punojnë me orë të zgjatura bashkë me prindërit, që, sigurisht, i mbajnë larg shkollës.. Fatmira, një grua e divorcuar egjiptiane nga Korça, e cila jeton me vajzën në shtëpinë e prindërve, e përshkruan kështu:

Kur u ktheva nga Gjermania, nuk gjeja dot punë. (...) Qëndrova ca në Shqipëri dhe, pastaj, migrova në Turqi. (...) Më duhej të punoja për 12 orë (...). Vajza punonte bashkë me mua. (...) Shkova në Turqi vetëm me vajzën dhe doja të punoja.

Ka edhe përvoja më pozitive. Për të rinjtë e kthyer që kanë ndjekur shkollën dhe kurset profesionale, që kanë marrë pjesë në praktika profesionale, kanë mësuar një gjuhë dhe kanë ndryshuar mendësinë në vendin e migracionit, është më e lehtë të gjejnë punë në sektorin formal. Fatosi, një i ri nga Tirana, tha:

Kur u ktheva, shkova në zyrën e punësimit të kërkoja punë (...), por e gjeta vetë përmes Facebook-ut. (...) Punoj në një *call center* në gjermanisht.

Këto aftësi të reja janë të theksuara mes të rinjve që kanë kaluar një kohë të gjatë jashtë dhe kanë mundur të përfitojnë nga mundësitë e arsimit dhe formimit në BE.

Formimi profesional dhe ndihma nga organizatat ndërkombëtare u ka dhënë gjithashtu mundësi disa të kthyerve të gjejnë punë në sektorin formal. Kështu ka ndodhur me Altinin, i cili përshkruan eksperiencën e tij:

Më mbështeti një organizatë ndërkombëtare për të gjetur punë. Më parë, kërkoja formim profesional, që është falas për ne. Kur mbarova kursin, organizata ndërkombëtare më ndihmoi të gjeja punë për dy javë. Punoj në një restorant.

Shumë të intervistuar thanë se dëshironin të bënin kurse profesionale në Shqipëri. Ata mendonin se këto kurse do t'i ndihmonin të gjenin punë në vendin e tyre ose jashtë. Sidoqoftë, duhet theksuar se kurset e formimit profesional shpesh nuk përputhen me nevojat e tregut të punës. Shpresa, një nëpunëse lokale nga veriu i Shqipërisë, tha:

Në qytetin tonë ofrohen dy kurse profesionale, një për rrobaqepëse dhe tjetri për hidraulik. Megjithatë, edhe po ta mbarosh kursin, nuk ka mundësi punësimi. Këtu nuk ka ndërmarrje rrobaqepësie.

7.5 Strehimi

Situata socio-ekonomike është edhe më e rëndë për familjet që shitën shtëpitë dhe pasuri të tjera për të financuar udhëtimin në vendin e destinacionit. Pas kthimit, ato u vendosën tek të afërmit, po situata është shumë e keqe. Ky është rasti i Zanës, një grua rome nga Tirana, që u kthye nga Franca:

Familja jonë shpenzoi 3 000 euro për të shkuar në Francë. Për të bërë paratë, i shitëm të gjitha ç'kishim dhe morëm edhe borxh. (...) Pas kthimit, jetojmë në shtëpinë e vjehrrës. Jemi 10 veta në një dhomë.

62 Gëdeshi, I., Mykërezi, P. dhe Danaj, E. (2016) *Caktimi i hartës së aftësive, mundësive të punësimit dhe sipërmarrjes për romët dhe egjiptianët në sonat e projektit në Tiranë, Durrës, Berat dhe Shkodër*. Tiranë:PNUD.

Situata është e vështirë edhe për familjet rome që jetojnë në zonën e njohur si 'Pallati me Shigjeta' në Tiranë, shtëpitë e të cilave u shembën. Avniu, një kryefamiljar rom i kthyer nga Gjermania, tha:

Kur ishim në Gjermani, na u prish shtëpia, bashkë me mobiljet. Vëllai ishte në qytet dhe nuk mundi të shpëtonte asgjë, përveç një televizori. Të gjitha mobiljet e tjera u shkatërruan me shtëpinë. (...) Kur u kthyem në Shqipëri, nuk kishin ku të rrinim. Gjatë tre muajve të parë vuajtëm; shkua nga një vend në tjetrin, na ndihmuan të afërmit. Qëndruam te secili prej tyre për ca kohë. Djali ndenji diku tjetër, se nuk mund të rrinim dot shtatë njerëz bashkë në një vend. Kjo vazhdoi derisa morëm këstin e dytë të qirasë. Pastaj, morëm një vend me qira. (...) Deri tani, shteti ka paguar qiranë. Megjithatë, [së shpejti], nuk do e paguajmë më dhe nuk e dimë ç'do të bëhet me ne. Gjendja po bëhet më keq.

Familje të tjera i kanë gjetur shtëpitë në rrënoja ose të dëmtuara rëndë pas kthimit dhe nuk kanë burime të mjaftueshme financiare për punimet e nevojshme të riparimit. Disa prej tyre, sidomos ato që janë kthyer pas një qëndrimi të gjatë në BE, i kanë përdorur kursimet për të rinovuar shtëpitë. Ermira, një nënë e vetme nga Rrësheni, na tregon:

Kur u kthyem në Shqipëri, shtëpia ishte katastrofë. Çdo objekt ishte prishur. U përpoqëm t'i rregullonim duke përdorur 2 000 euro që kishim kursyer.

Mospasja e një shtëpie ose një shtëpi në gjendje të keqe mund të shërbejë si faktor nxitës për disa familje për të riemigruar. Ky është rasti i Hamdiut, një i kthyer që jeton në bashkinë e Kamzës, i cili thotë:

Unë nuk marr ndihmë sociale dhe shtëpia më është shkatërruar, thuajse e pabanueshme. Nuk kam asnjë zgjidhje. Çfarë të bëj këtu?

Familje të tjera të kthyer janë përballur me faturat e dritave dhe ujit për kohën që kanë qëndruar në vendin pritës. Në mungesë të burimeve financiare, këto familje jetojnë me shumë stres. Hasani, kryefamiljar në Kamëz, përshkruan situatën e tij:

Kur u ktheva në Shqipëri, dritat i kishin prerë. Më kishin faturuar gabimisht 30,000 lekë (...). Ishte gabim. M'u desh të shkoja nga një zyrë në tjetrën, që ta zgjidhja.

Fiqiriu, një tjetër banor i Kamzës, tregoi një histori të ngjashme:

Kur u ktheva në Shqipëri, pashë që fatura e ujit kishte ardhur 40 000 lekë. I kisha paguar faturat përpara se të largohesha. Megjithatë, ma kishin sjellë faturën 40 000 lekë, edhe pse nuk kisha konsumuar asnjë pikë ujë. Shkova disa herë në bashki, po, prapë, fatura duhej paguar. Shkova sërish, gjeta paratë, pagova faturën, po, ngaqë ishte e prapambetur, m'u desh të paguaja më shumë.

Strehimi është veçanërisht problem për shumë të kthyer romë dhe egjiptianë në Shqipëri. Shumë prej tyre jetojnë në baraka ose në banesa të rrënuara e të mbipopulluara në zona të izoluara periurbane ose rurale me infrastrukturë të pamjaftueshme (pa ujë, kanalizime dhe rrugë).⁶³

63 Robayo-Abril, M. dhe Millán, N. (2019) *Breaking the Cycle of Roma Exclusion in the Western Balkans*. Washington DC: Banka Botërore.

Sonila, një nënë e re rome nga Tirana, u ankua:

‘Ne jetojmë siç ishim, 10 veta në një shtëpi. Po fëmijët janë rritur tani dhe është shumë e vështirë për ne...’

Ka po ashtu raste kur të kthyerit, me paratë që kanë kursyer nga qëndrimi në vendin pritës, kanë rinovuar ose ndërtuar shtëpinë ose kanë blerë një apartament të vogël. Në vendbanimin e romëve në Fushë-Krujë, disa familje po ndërtojnë shtëpi me kursimet e fituara në Gjermani. Emini, një drejtues informal i komunitetit nga Fushë-Kruja, thotë:

Kursimet në Gjermani ishin kaq të mira (...) sa arritëm të ndërtonim një shtëpi. Familjet tona qëndruan tre vjet dhe disa edhe katër vjet (...). Kur filluan të ktheheshin, ekonomia u mëkëmb, sepse po bëjnë punime ndërtimi.

7.6 Mbrojtja sociale

Fondi shtetëror i sigurimeve shoqërore përbëhet nga katër elemente: (i) ndihma ekonomike shtetërore; (ii) përfitimet e pensionit; (iii) ndihma e papunësisë dhe (iv) pagesat e aftësisë së kufizuar. Për shkak të një sistemi të ri vlerësimi që po zbatohet që nga fillimi i vitit 2018, disa familje të kthyer janë përjashtuar nga skema shtetërore e ndihmës ekonomike. Për më tepër shumë nga azilkërkuesit e kthyer kanë thënë se ndihma ekonomike që iu jep shteti familjeve të tyre është shumë pak për të mbuluar shpenzimet e përditshme. Valbona, një grua e moshuar nga Korça, tha:

Me paratë që marr nga ndihma ekonomike blej miell dhe e bëj bukën vetë. Po jam e sëmurë, kam nevojë edhe për fruta. Në Gjermani haja ushqim të mirë, kurse këtu jo.

Në mungesë të ndihmës së mjaftueshme ekonomike, shumë të kthyer bëjnë punë të rastësishme në sektorin informal (ndërtim, mbledhin metal për skrap etj.). Disa prej tyre (kryesisht romë dhe egjiptianë) kanë tricikla dhe makina të vjetra për të transportuar hekurin për skrap. Megjithatë, kjo përdoret shpesh si pretekst për t'i përjashtuar nga ndihma ekonomike shtetërore. Sonja nga Korça foli për përvojën e saj:

Familja ime nuk përfiton ndihmë ekonomike. Kur u kthyem nga Gjermania, me disa para që kishim kursyer atje blemë një makinë të vjetër, me të cilën burri im mbledh hekur për skrap nëpër fshatra. Makina është e vjetër, por në dokumentet e regjistrimit është makinë, që na përjashton për pasojë nga e drejta për ndihmë ekonomike. Po ata duhet të vijnë e të shohin më parë si jetojmë, pastaj ta presin ndihmën ekonomike.

Disa familje të tjera të kthyer nuk marrin ndihmë ekonomike shtetërore, pasi ligji parashikon se familjet që nuk janë të regjistruara në bashki nuk kualifikohen për ta përfituar atë.

Shumë familje të kthyerish thanë se ishin hasur me pengesa burokratike për marrjen e ndihmës ekonomike shtetërore. Sokoli, drejtuesi i një shoqate rome në Tiranë, na tha:

Lidhur me ndihmën ekonomike, ka shumë burokraci për dokumentet. Disa shoqata i kanë ndihmuar romët me dokumentacionin. (...) Megjithatë, edhe kur shkojnë në zyrat e gjendjes civile, i largojnë, duke iu thënë, ‘ikni, se nuk kualifikoheni’. Disa romë nuk shkuan fare të aplikojnë.

Po ashtu, Fatmiri, një egjiptian nga Shkodra, u shpreh:

Kur shkojmë te zyra e ndihmës ekonomike, na thonë: 'Ik, gjej punë!' Po ku ta gjejmë punën. Sa na çojnë nga një zyrë në tjetrën.

7.7 Kujdesi shëndetësor dhe ndihma psiko-sociale

Sipas intervistave dhe diskutimeve në grupet e fokusuara, shumë azilkërkues të kthyer përfitonin kujdes shëndetësor falas në vendin e migracionit (kryesisht në Gjermani). Ndërkohë, të kthyerit nga azili përballen me dy sfida kryesore.

E para është marrja dhe cilësia e shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Disa të kthyer që janë të papunë ose punojnë në sektorin informal nuk kanë kartë shëndeti ose nuk kanë të drejtë të marrin shërbime shëndetësore falas. Sipas legjislacionit shqiptar, fëmijët nën 18 vjeç, gratë shtatzëna, personat me aftësi të kufizuara, pensionistët, punonjësit në sektorin formal dhe personat e papunë të regjistruar në zyrat e punësimit kanë të drejtë të kenë kartën e shëndetit. Të gjitha grupet e tjera duhet të paguajnë për ta. Skënderi, një i kthyer nga Berati, u shpreh:

Ata nuk të japin kartë shëndeti, se duhet të kesh punë. As unë, as gruaja nuk kemi kartë shëndeti. Problemi është se, nëse njëri prej nesh sëmuret, ku të shkojmë? Na duhet karta e shëndetit.

Për personat e papunë dhe ata që punojnë me të ardhura të ulëta në sektorin joformal, kurat mjekësore mund të jenë të papërbalueshme dhe ky është natyrisht edhe rasti i azilkërkuesve të kthyer, që janë nga grupet më të varfra në Shqipëri. Arbeni, një i kthyer në Berat, flet për eksperiencën e tij:

Vajza ime duhet të shkojë të vizitohet njëherë në tre muaj. Po këtu më duhet të paguaj; në Gjermani, vizitat ishin falas. (...) Të shkosh te doktori, duhet ta paguash nga xhepi, po unë nuk kam para se jam i papunë.

Cilësia e shërbimeve të kujdesit shëndetësor është shpesh e ulët dhe ka raste kur mjekët nuk janë në gjendje të përcaktojnë diagnozën dhe kurën përkatëse. Kjo i shtyn shumë familje të varfra ta kërkojnë zgjidhjen në vendet e BE-së, duke aplikuar për azil. Këtë na tha Majlinda, një nënë e re nga Korça:

Motra ime emigroi në Gjermani, për shkak të papunësisë këtu. Po ajo duhet të shkojë prapë, për shkak të djalit të sëmurë (...) dhe mjekët këtu nuk ia gjejnë dot diagnozën. Ajo do të kthehet në Gjermani vetëm që të kurojë djalin, por nuk ka para. Këtu kemi shumë vështirësi.

Disa të kthyer të tjerë që janë kuruar në vendet e BE-së duhet të vazhdojnë trajtimin mjekësor, sipas rekomandimit të mjekëve, në spitale private. Megjithatë, pamundësia e marrjes së kujdesit të specializuar shëndetësor, për shkak të kostos së lartë, vijon të jetë një shqetësim i madh për familjet e kthyer azilkërkuese. Elvira, një azilkërkuese e kthyer, tha:

Unë dhe djali ishim sëmurë dhe u kuruam në një spital në Gjermani. Tani na duhet të shkojmë çdo muaj për kontroll te spitali amerikan në Tiranë, po nuk e çoj dot djalin atje. Ndihma ekonomike që marrim nuk del as për shpenzimet e udhëtimit.

Sfida e dytë është stresi psikologjik që përjetojnë të kthyerit, sidomos ata që jetojnë në kushte të papërshtatshme ose që janë kthyer nga policia.⁶⁴ Ky stres psikologjik, sipas intervistave dhe diskutimeve në grupet e fokusuar, është më i theksuar te gratë dhe fëmijët. Ka një numër arsyesh për këtë situatë psiko-sociale, disa prej të cilave renditen më poshtë.

Kushtet e jetesës dhe shkollimit në vendin pritës kanë një kontrast të thellë me varfërinë dhe rrethanat e vështira që ata gjejnë kur kthehen në atdhe, duke shkaktuar një ndikim negativ te kushtet sociale dhe ekonomike për shumë fëmijë të kthyer. Sipas intervistave me mësues dhe psikologë, ata fëmijë që jetojnë në kushte më të këqija kanë zakonisht përvojën më të keqe emocionale kur kthehen në atdhe. Kjo është ajo që dëshmoi Mimoza, një punonjëse sociale në Fushë-Krujë:

Unë besoj se ajo që i prek më shumë fëmijët është ndryshimi i kushteve ekonomike. Ishin mësuar të kishin gjithçka atje: një strehë të sigurt, ushqim, pagesë mirëqenieje që prindërit i merrnin çdo muaj. Kur vijnë këtu, nuk ka asnjë nga këto. Kjo është një lloj tronditjeje, si për prindërit, ashtu edhe për fëmijët. (...) Kjo ndikon veçanërisht në situatën emocionale të fëmijëve, që e kanë të vështirë të përshtaten. Si rezultat nuk janë më kaq të hapur, nuk flasin shumë dhe nuk shoqërohen menjëherë me shokët në shkollë.

Mungesa e ngjarjeve dhe aktiviteteve shoqërore, kulturore dhe sportive është një tjetër faktor që thellon kontrastin midis vendit pritës dhe atij të origjinës. Entela, psikologe në një shkollë në Durrës, thotë:

Ka një kontrast shumë të madh, pasi flasin për aktivitetet e shumta që bënin atje, në shkollë dhe jashtë saj. Për shembull, përveç mësimeve, kishin shumë aktivitete që mund t'i bënin pasdite. Këtu nuk kanë as shesh lojërash që të luajnë, jo më park zbavitjeje.

Për këtë arsye, në të gjitha intervistat dhe grupet e fokusuar, fëmijët theksojnë se shpresojnë të migrojnë sërisht me familjet e tyre.

Megjithatë, ka edhe raste kur vështirësitë dhe aspektet negative të jetesës në vendin pritës, sidomos për ato familje të cilave iu është dashur të rrinë në mjediset pritëse gjatë gjithë procedurës së azilit, i kanë traumatizuar fëmijët. Të rrish në kamp për një kohë të gjatë apo të ndryshosh banesë shpesh shkakton më shumë stres dhe ofron më pak shanse integrimi, sidomos për fëmijët e vegjël. Teuta, mësuese nga Durrësi, u shpreh:

Edhe disa fëmijë që pyeta nuk e pëlqenin jetën atje [në kampe]. Iu duhej të ndanin kuzhinën, banjat (...).

Ata jetojnë në një mjedis të pasigurt dhe kanë krijuar marrëdhënie të pakta shoqërore. Elvira, punonjëse sociale në Durrës, përshkruan përvojën e saj me një nxënëse rome:

Mimoza, një 10-vjeçare rome, e cila vjen në qendrën tonë, është shpesh e trembur (...). Kur jetonte në një kamp në Gjermani, nëna e saj e shoqëronte kudo që shkonte, edhe në banjë. Në kamp kishte pasur raste dhune nga të rriturit ndaj fëmijëve. Prindërit e saj kishin frikë se mos Mimosës i ndodhte diçka e keqe.

Fëmijët që kanë jetuar për një kohë të gjatë në kushte të papërshtatshme në vendin pritës ka më shumë gjasë të zhvillojnë probleme të shëndetit mendor. Për rrjedhojë, shumë nga fëmijët që kanë jetuar në kampe ose në kushte të papërshtatshme nuk duan të emigrojnë sërisht.

64 Për një panoramë të këtij problemi, shih Vathi, Z. dhe King, R., eds. (2017) *Return Migration and Psychosocial Wellbeing: Discourses, Policymaking and Outcomes for Migrants and their Families*. London: Routledge.

Në raste të tjera, fëmijët janë shkëputur nga njëri prind ose kanë përjetuar ndarjen e prindërve, që u ka shkaktuar stres dhe ankth të pashmangshëm. Fatmiri, një prind nga Korça, foli për rastin e tij:

Kur njerëzit filluan të migronin në Gjermani, ne menduam se edhe ne mund të shkonim, po nuk kishim para për udhëtimin. Kështu, në fillim iku grua dhe djali 10-vjeçar dhe unë qëndrova në Shqipëri me djalin e vogël. Po i vogli ishte i paqetë dhe donte nënën. (...) Kështu mora ca para borxh dhe u largova me djalin 8-vjeçar. (...) Por në Gjermani nuk më çuan në të njëjtin vend me gruan. Ndenja një muaj pa mundur të bashkohesha me gruan dhe djalin tjetër. Djali i vogël qante vazhdimisht, qaja edhe unë (...). Vetëm pas një muaji arrita të bashkohesha me gruan.

Ndërkohë, ndarja e prindërve në vendin pritës mund të shkaktojë situata edhe më problematike për fëmijët. Roven, mësuese nga Durrësi që punon në qendrën sociale, thotë:

Prindërit e një fëmije tjetër që vjen në qendrën tonë janë të ndarë dhe kjo ndodhi gjatë qëndrimit në vendin pritës. Babai u kthye me djalin, kurse nëna ka një vajzë me një burrë tjetër dhe jeton në Gjermani. Fëmija e ka përjetuar shumë keq divorcin dhe ende nuk e ka kaluar traumën. E mban përbrenda, është i mbyllur.

Disa fëmijë kanë kaluar përvoja traumatike nga kthimi i detyruar i familjeve të tyre në Shqipëri. Sjelljet e traumatizuara të fëmijëve të kthyer me forcë nga vendi pritës vihen re në qarqe të ndryshme. Drita, një mësuese nga Durrësi, ndan përvojën e saj:

Kur erdhën në qendrën tonë, fëmijët tregonin historitë e tyre sesi i kishin marrë me forcë mamin dhe babin; ishin larguar nga shtëpia pa asgjë, vetëm me rrobat e trupit (...). Ishin ndjerë shumë keq; e kishin përjetuar si dhunë psikologjike. Pas kthimit, ishin ndihmuar shumë nga mësuesit e tyre për ta tejkaluar atë përvojë. Edhe ne kemi punuar ngushtë me ta e u kemi folur, jemi bërë si psikologë me ta.

Në shumë raste, prindërit, të cilët kanë formim të pakët, nuk janë në gjendje të kuptojnë stresin psikologjik të fëmijëve të tyre dhe ndërhyrjet përkatëse.

7.8 Arsimi

Riintegrimi i qëndrueshëm i fëmijëve të kthyer në Shqipëri është një proces kompleks dhe përfshin një sërë elementesh, si përmirësimi i kushteve ekonomike të familjeve të tyre (punësimit dhe të ardhurave të prindërve), strehimi, qasja në arsim dhe mbrojtja sociale. Vështirësitë në riintegrim mund të shkaktojnë probleme sociale, emocionale dhe psikologjike të fëmijët, çka mund t'i bëjë të braktisin shkollën. Edhe kjo mund të shërbejë si faktor nxitës për prindërit që të emigrojnë. Në këtë nënrubrikë, do të përqendrohemi vetëm te riintegrimi i fëmijëve në shkollë, duke trajtuar njohuritë e tyre të gjuhës shqipe, regjistrimin në shkollë, veçimin, bullizmin nga bashkëmoshatarët etj.

Ka një sërë problemesh që kanë lidhje me integrimin e fëmijëve të kthyer në shkollë. I pari ka të bëjë me regjistrimin dhe vërtetimin e diplomave apo të klasave të përfunduara. Disa fëmijë të kthyer nuk kanë asnjë dokument shkollor (listë notash, certifikata etj.) nga vendi i destinacionit dhe për pasojë, kur janë kthyer, kanë hyrë në klasa më të ulëta. Mungesa e dokumentacionit shkollor është më e theksuar në rastin e fëmijëve nga familje që janë kthyer me forcë nga autoritetet e vendit pritës. Në këtë rast, iu mungojnë të gjitha dokumentet e nevojshme shkollore.

Në ato raste kur fëmijët e kthyer kanë dëftesat e shkollës që vërtetojnë nivelin arsimor, ato janë në gjuhën e vendit pritës të BE-së. Kësisoj, ato duhen përkthyer e noterizuar, çka është kosto shtesë për shumë familje të kthyer.

Edvini, prind nga Dibra, thotë:

I regjistrova me shumë vështirësi fëmijët në shkollë. (...) Më kërkuan të përktheja dokumentet gjermane, të dhënat nga shkolla, po e gjitha ishte shtrenjtë (...). Megjithatë, prapë donin të m'i regjistronin një klasë më poshtë.

Fëmijë të tjerë janë kthyer në mes të vitit shkollor dhe rrezikojnë ta humbin.

Sipas të dhënave tona, rreth 20 për qind e fëmijëve të kthyer kanë humbur një ose më shumë vite shkolle dhe kjo është perceptuar negativisht nga shumë prindër. Ervin, një baba nga Kamza, ankohet për regjistrimin e fëmijëve të tij në shkollë:

Në Gjermani shkuam pa dokumente (...). Megjithatë, erdhën tri ekipe për tre fëmijët e mi. 'Fëmija yt është në këtë moshë dhe do ta çojmë në këtë shkollë'. Menjëherë morën më të voglin që ishte në moshë për shkollë dhe e çuan me makinë, deri sa morëm këto bileta (...). Ata ishin të organizuar, për 15 ditë i rregulluan fëmijët që të mund të ndiqnin shkollën në Gjermani. (...) Kur u ktheva, hasa një mijë probleme, deri në pikën që bëra debat me njerëzit në zyrën arsimore. Fëmijët humbën një vit shkollë.

Regjistrimi i fëmijëve në klasa më të ulëta shkakton shpesh stres dhe i izolon në raport me ish-shokët e klasës. Në shumë raste, ky është shkak që çon në braktisje. Kjo është ajo që thekson Anila, psikologe në një shkollë në Durrës:

Ka fëmijë, për shembull, që janë 12 vjeç dhe janë ende në klasën e dytë. Ata ndihen keq, sepse janë më të mëdhenj se nxënësit e tjerë. E kanë të vështirë të përshtaten: mësuesi është i ri, nxënësit e tjerë janë më të vegjël, varet se si i pret klasa. (...) Ky mund të jetë faktor nxitës për braktisjen e shkollës.

Disa fëmijë të cilët kanë kaluar një kohë të gjatë jashtë vendit, përfshi ata që kanë përfunduar disa vite shkollë në vendin pritës, kanë probleme me gjuhën shqipe. Dritan, një baba nga Rrësheni, shpjegon:

Vajza shkoi në klasë të parë në Gjermani dhe kur u kthye e kishte përfunduar klasën e tretë. Kur erdhëm në Shqipëri, kishte probleme, se nuk njihje shkronjat e alfabetit, i ngatërronte; por mund të fliste rrjedhshëm shqip.

Shpëtimi, një prind i ri nga Berat, foli për të njëjtin shqetësim:

Vajza ime u largua në mes të klasës së parë nga Gjermania dhe këtu e nisi nga fillimi. Ka vështirësi me gjuhën shqipe.

U vërejtën disa probleme edhe me lëndët shkencore, duke qenë se kurrikula në Shqipëri ndryshon shumë nga ajo e vendit pritës. Elvira, drejtoreshë shkolle në Fier, tha:

Kurrikula e matematikës dhe disa lëndëve të tjera shkencore është ndryshe nga ajo në Gjermani. Për pasojë, disa nxënës të kthyer përballen me vështirësi. Bashkë me një grup mësuesish, kemi punuar shumë me këta studentë të kthyer.

Bullizmi është një tjetër faktor që ndikon negativisht te fëmijët. Miranda, një e re aktiviste nga Kamza, tha:

Ka raste kur fëmijët e kthyer përballen me bullizmin e shokëve të klasës. Iu thuhet se ata që kërkojnë azil në BE janë 'trokë'. Kjo çon në izolim për fëmijët e kthyer dhe iu shkakton stres emocional.

Megjithatë, panorama e përgjithshme e përfutur nga intervistat dhe materiali nga grupet e fokusuar është se shumë fëmijë kanë përfituar nga qëndrimi dhe studimi në vendet e BE-së, duke rritur kështu kapitalin e tyre njerëzor dhe social. Ata kanë një mendësi ndryshe, flasin gjuhë të huaja, përdorin teknologjitë, janë më aktivë në klasë dhe i shijojnë diskutimet e lira. Këtë e pohon edhe Denisa, një drejtoreshë shkolle me përvojë në Fier:

Fëmijët e kthyer nuk kanë pasur asnjë vështirësi. Ata janë integruar. Marrin pjesë aktivisht në veprimtaritë shkollore (...), njohin teknologjitë e reja, flasin shumë lirshëm, pasi ashtu janë edukuar.

Disa donatorë dhe organizata ndërkombëtare, si Terre des Hommes, Save the Children, World Vision etj., kanë ofruar ndihmë të konsiderueshme për riintegrimin e fëmijëve të kthyer. Ato kanë ndihmuar me dokumentacionin e nevojshëm, orët pas shkolle, detyrat e shtëpisë dhe organizimin e veprimtarive të ndryshme.

8. Synimet për të ardhmen

Dëshira dhe planet e të kthyerve për të migruar sërish janë një tregues i qëndrueshmërisë së procesit të riintegrit në Shqipëri. Në mungesë të mekanizmave mbështetëse për riintegrimin e të kthyerve, shumë prej tyre mund ta gjejnë veten më keq seç ishin përpara se të migronin. Si rrjedhojë, riemigrimi mund të jetë alternativë për shumë azilkërkues të kthyer. Një studim mbi migracionin e mundshëm, i realizuar në vitin 2018, tregoi se migrantët e grupmoshës 18–40, që ishin kthyer për shkak të krizës ekonomike globale (kryesisht nga Italia dhe Greqia), kishin një prirje më të madhe për të migruar (71 %), sesa ata që nuk kishin migruar asnjëherë më parë (48 %).⁶⁵ Midis faktorëve themelorë për këtë dukuri është fakti që nuk arrijnë të riintegrohen në atdhe. Pra, çfarë ndodh me grupin e azilkërkuesve të kthyer në Shqipëri?

Në diskutimet në grupet e fokusuara dhe intervistat, i pyetëm të kthyerit nëse kishin në plan të emigronin sërish nga Shqipëria në të ardhmen. Shumica u përgjigjën se e kishin në plan të migronin ‘brenda vitit’, ‘dy vitet e ardhshme’ ose ‘në një fazë të mëvonshme’.⁶⁶ Disa bashkëbisedues thanë se kishin gjetur kontrata pune dhe po pritnin nxjerrjen e vizës nga ambasada e vendit përkatës. Altini, një i kthyer që tani jeton në Gjirokastrë, thotë:

Do të iki të punoj në Dresden, Gjermani. Do punoj në ndërtim, për një sipërmarrës shqiptar që ka kompaninë e vet në Gjermani. (...) Më parë, do shkoj vetë dhe pastaj do vijë familja.

Të kthyerit e tjerë kanë përfituar nga lëvizja e lirë pa viza në zonën e Shengenit. Ata punojnë për tre muaj në sektorin informal në Gjermani, kryesisht ndërtim, shërbime dhe bujqësi. Mësojnë një zana, kanë përvojë pune, kanë rrethe shoqërore në vendin pritës, njohin gjuhën dhe presin një kontratë pune afatgjatë. Përgjithësisht, migracioni individual afatshkurtër i paraprin dhe përgatit terrenin për migracionin më afatgjatë familjar. Kjo është ajo që thotë Ismaili, një burrë i papunë nga Peshkopia:

Kam vetëm dy ditë që jam kthyer nga Gjermania, kur përfitova një kontratë pune me një kompani që shet materiale ndërtimi. (...) Kur të marr vizën, do të largohem bashkë me familjen në Gjermani.

Dëshira për të migruar lidhet me si e përfytyrojnë të ardhmen e tyre të kthyerit, sidomos, të ardhmen e fëmijëve të tyre. Ky perceptim mbi të ardhmen lidhet me shumë elemente të cilësisë së jetës që i analizuam më sipër, konkretisht, punësimi, pagat, mbrojtja sociale, cilësia e arsimit dhe kujdesit shëndetësor, strehimi, siguria, infrastruktura, mjedisi etj.

65 Gëdeshi, I. dhe King, R. (2018) *New Trends in Potential Migration from Albania*. Tirana: Fondacioni “F. Ebert”; King, R. and Gëdeshi, I. (2019) New trends in potential migration from Albania: the migration transition postponed? *Migration and Development*. Marrë në janar 2020, nga www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/21632324.2019.1608099?journalCode=rmd20.

66 Kjo theksohet nga studime të tjera të kryera me të kthyerit në Shqipëri. Shih Hackaj, A. dhe Shehaj, A. (2017), *Jashtë sistemit: Kthimi nga Gjermania dhe riintegrimi i azilkërkuesve shqiptarë*. Tiranë: Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Dokument Pune – Seritë e Procesit të Berlinit; Gëdeshi, I. dhe Xhaferaj, E. (2016) *Profil social dhe ekonomik i migrantëve të kthyer në Shqipëri*. Tiranë: IOM; INSTAT dhe IOM (2014) *Migracioni i kthimit dhe riintegrimi në Shqipëri*. Tirana: INSTAT/IOM.

Nermini, një nënë nga Kamza, thotë:

E ardhmja këtu është shumë e zymtë. Është vështirë. Familja jonë ka shtatë veta. Vetëm unë punoj. Kam pesë fëmijë dhe një nuse. Edhe për të paktën dy vjet të tjera, nusja nuk mund të shkojë në punë, se fëmija është vetëm dymuajshe. Fëmijët e tjerë shkojnë në shkollë (...) dhe duhet të investojmë për ta. Pavarësisht sa shumë punoj, marr vetëm 35 000–40 000 lekë në muaj. Shtatë persona të jetojnë me 40 000 lekë në muaj, kur duhen paguar faturat, lëre pastaj shpenzimet e spitalit (...). Po mendoj të emigroj. Po më doli mundësia, do të emigroj.

Siç duket edhe nga kjo intervistë, faktorët ekonomikë janë mbizotërues. Megjithatë, realiteti dhe perspektiva janë edhe më të zymta për ata të kthyer që kanë mbetur pa punë për një kohë të gjatë. Duke mos pasur një punë në sektorin formal, shumë familje thonë se përpiqen të mbijetojnë me 'ndihmë ekonomike', pensionin e vogël të prindërve, dërgesat në para nga të afërmit, pagesat e aftësisë së kufizuar ose fitimet nga ndonjë punë rastësore në sektorin informal. Ndërkohë, vlera e 'ndihmës ekonomike' dhe e burimeve të tjera të përmendura është e vogël – e pamjaftueshme për t'i nxjerrë nga varfëria familjet e kthyer – dhe nuk e ngushton hendekun e pabarazisë. Mira, një grua nga Kukësi, shpjegon:

Ne jetojmë me 'ndihmë ekonomike' nga shteti. (...) Po a janë mjaftueshëm 5 000 lekë ndihmë ekonomike? (...) Nuk po kërkojmë para pa punuar, nuk e duam fare ndihmën ekonomike. Ne duam punë, duam të punojmë, një punë për burrin.

Si rrjedhim, papunësia/nëpunësimi, pagat e ulëta dhe, në një shkallë më të vogël, nevoja për të përmirësuar kushtet e jetesës janë faktorët kryesorë që i shtojnë të rriemigrojnë në vendet e BE-së.

Kjo gjetje e studimit mund të shihet (dhe përforcohet) edhe nga një tjetër këndvështrim. Statistikat tregojnë se, në vitin 2018, PBB-ja mesatare për frymë në Shqipëri arriti në 31 për qind të mesatares së BE-së. Krahësuar me vende si Holanda, Gjermania, Belgjika, Franca etj., ky tregues ishte shumë më i ulët.⁶⁷ Pyetja për t'u bërë atëherë është: A migrojnë të kthyerit shqiptarë ose segmenti më i varfër i popullsisë në këto vende, për shkak të nivelit shumë më të lartë ekonomik dhe shoqëror apo është migracioni i tyre i mundshëm një pasqyrim i pamundësisë për të plotësuar nevojat bazë në vendin e tyre? Edhe pse faktorët shtytës dhe tërheqës ndërveprojnë e mund të mos jenë të ndarë, në thuajse të gjitha intervistat dhe diskutimet në grupet e fokusuar, pjesëmarrësit theksuan se ata migronin për shkak të kushteve të vështira ekonomike në Shqipëri. Sipas fjalëve të Burimit, një i kthyer i papunë nga Kukësi:

Ne duam punë. Nëse Shqiptarët kanë mundësi të punojnë, sikur edhe një person për familje, në Shqipëri, nuk mendoj se njerëzit do të donin të migronin. Ne nuk pretendojmë të jemi Gjermania apo Zvicra, apo Franca. Duam kushtet minimale të jetesës. (...) Po këtu nuk ka asnjë mundësi punësimi.

Të përballur me papunësinë, disa prej familjeve të kthyer jetojnë me ato që kanë kursyer gjatë qëndrimit në vendin pritës si azilkërkues. Megjithatë, kursimet e tyre janë të kufizuara dhe mbarojnë shpejt, çka shkakton stres dhe pasiguri për të ardhmen e familjeve të tyre. Fatmiri, një azilkërkues i kthyer nga Korça, tha:

'Ne jetojmë me kursimet nga Gjermania, po deri kur?!'

Krahësimi i faktorëve shtytës përpara dhe pas kërkesës për azil zbulon se procesi i riintegrit, të paktën për disa prej komponentëve të tij themelorë (si punësimi, mbrojtja sociale, kujdesi shëndetësor dhe siguria) nuk kanë qenë siç pritej. Shumë azilkërkues që janë kthyer në Shqipëri theksojnë se gjendja e familjeve të tyre, krahasuar me periudhën përpara se të aplikonin për azil, 'nuk ka ndryshuar' ose është 'më keq' ose 'shumë më keq'.⁶⁸ Si rezultat, migracioni mbetet i vetmi

67 Eurostat (2019), PBB për frymë, konsumi për frymë dhe treguesit e nivelit të çmimeve. Marrë në dhjetor 2019 nga https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/GDP_per_capita_consumption_per_capita_and_price_level_indices#Relative_volumes_of_GDP_per_capita.

68 Të intervistuarit u pyetën: Krahësuar me periudhën përpara se të kërkonit azil, pas kthimit, do ta konsideronit gjendjen e familjes suaj më të mirë apo më të keqe?

mekanizëm përballues, që u jep mundësinë të nxjerrin familjen nga varfëria ose nga një situatë e vështirë ekonomike, borxhi i vazhdueshëm. Shumica e të kthyerve thonë se, në rrethanat aktuale, emigracioni drejt një vendi të BE-së do të përmirësonte shumë situatën financiare të familjeve të tyre dhe do të ofronte një perspektivë të qartë në të ardhmen për fëmijët e tyre. Dëshira për një të ardhme më të mirë për fëmijët del pothuaj në të gjitha diskutimet dhe intervistat. Ajo perceptohet si arsimim më i mirë dhe më shumë mundësi për punësim në të ardhmen në sektorin formal. Ermira, nënë e dy fëmijëve nga Elbasani, thotë:

Ne mendojmë për të ardhmen e fëmijëve. Sa për ne, edhe po të rrimë këtu, do mbijetojmë. Por mendojmë për të ardhmen e fëmijëve tanë, për një jetë më të mirë për ta.

Pavarësisht dëshirës së tyre për të migruar, jo të gjithë të kthyerit i kanë burimet ta bëjnë këtë. Disa përballen me pengesa financiare dhe nuk kanë paratë për të udhëtuar në vendin pritës. Krenari, kryefamiljar nga Kukësi, thotë:

Ne nuk i kemi mjetet për të emigruar. Unë jam pa punë dhe jetoj me ndihmë ekonomike. (...) Njëherë morëm borxh, ndoshta dy, po nuk të jep njeri borxh për herë të tretë.

Të tjerët përballen me vështirësi lidhur me pasaportën, që i ndalon të udhëtojnë jashtë. Ky është rasti për Afrimin, një i ri nga Hasi në qarkun e Kukësit:

Unë kam një kontratë pune për të punuar si elektrikist në Gjermani (...) po nuk marr dot vizë, se më kanë ndaluar. Një vit ka ikur dhe më duhet të pres edhe 18 muaj.

Ndërkohë, disa të tjerë nuk kanë kapitalin e nevojshëm njerëzor (pasi nuk kanë profesion ose shihen si 'shumë të moshuar' etj.) për të emigruar. Ahmeti, një i kthyer që tani jeton në Gjirokastrë, thotë:

Unë jam shofer me profesion dhe kam punuar për shumë vjet si drejtues kamioni në vende të ndryshme të BE-së. (...) Një kompani e huaj kërkonte shoferë, po kur mësoi moshën time – unë jam te të 50-tat – nuk më pranuan. Ata donin të merrnin të rinj, rreth 35 vjeç (...). Kështu, nuk mund të emigroja, nuk do më marrin në punë prej moshës. Ky është fati im.

8.1 Format e emigrimit

Ne i pyetëm bashkëbiseduesit rreth formës së dëshiruar të emigrimit – d.m.th. nëse donin të migronin me procedurë të rregullt apo të kërkonin përsëri azil në një vend të BE-së. Shumica e të kthyerve planifikojnë të emigrojnë duke ndjekur procedurat e rregullta, me kontratë pune dhe vizë. Mira, një nënë e re nga Belshi, e kthyer që më parë kishte kërkuar azil në Gjermani, thotë:

Ne duam të gjejmë një kontratë pune e të emigrojmë në formë të rregullt. Nuk duam të kërkojmë azil, nuk jemi të paaftë, që të kujdeset qeveria gjermane për ne. Ne duam të punojmë.

Ndërkohë, shumë të kthyer e kuptojnë qartë se migrimi përmes kërimit të azilit është bërë më i vështirë ditët e sotme e, për pasojë, nuk është produktiv. Ndryshimi i procedurave (koha e shkurtër e përpunimit, ulja e vlerës së përfitimeve monetare, qëndrimi në kampe) në Gjermani ka sjellë si rezultat kohë më të shkurtër qëndrimi; kështu, kostoja e udhëtimit është shumë më e lartë sesa kursimet që mund të mbledhin në vendin e migrimit.

Mentori, një drejtues rom nga Levani, arsyeton:

Ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me njerëzit tanë në Gjermani. Një mik i imi që ka ikur tani së fundmi, do të kthehet për pak ditë. Për 20 ditë, çfarë mund të bësh në Gjermani?! Vetëm të humbësh para? Si mund t'i paguash borxhet?

Dëshira për të migruar në mënyrë të rregullt nga Shqipëria i motivon migrantët e mundshëm, sidomos të rinjtë, për të rritur nivelin e tyre arsimor, për të mësuar një gjuhë të huaj e për të marrë një profesion, që të jenë në gjendje të fitojnë një kontratë pune. Të intervistuarit u pyetën konkretisht për profesionin që do të donin të mësonin apo të ndiqnin. Më shumë se dy e treta e tyre donin të merrnin pjesë në trajnime, kryesisht për të mësuar një profesion që përputhet me nevojat e tregut të punës në vendin e dëshiruar pritës (mekanik, hidraulik, elektrikist, berber/parukier, punëtor ndërtimi, ndihmës-kuzhinier etj.).

Kjo është ajo çfarë shpreson të bëjë Bujari, një i ri rom nga Tirana:

Do ishte mirë të migroja prapë, po jo për të kërkuar azil. Po të mund të merrja një leje pune, do të migroja. Duhet arsim dhe një profesion për të shkuar dhe për të punuar në vendin e destinacionit.

Të tjerë dëshirojnë të migrojnë për të mësuar ose përmirësuar njohuritë e gjuhës së vendit pritës, çka do ta lehtësonte gjetjen e një kontrate pune dhe integrimin në atë vend. Kjo dëshirë dhe interes për të rritur nivelin arsimor dhe të formimit profesional të kësaj popullate duhet mbështetur, pasi rrit kapitalin njerëzor të vendit dhe të migrantit të mundshëm.

Vetëm një grup i vogël të intervistuarish (kryesisht romë dhe egjiptianë) deklaruan se do të përpiqeshin të kërkonin sërish azil, sapo të kenë mundësinë (të marrin një pasaportë, të financojnë udhëtimin etj.). Ky është rasti për Lulzimin, një i papunë rom nga Korça, i cili u shpreh kështu:

Unë dua të migroj sërish (...). Dua të aplikoj sërish për azil, pasi nuk kam askënd të më ndihmojë atje ...

Petriti, një ish-azilkërkues, që jeton tashmë në Kamëz, nuk ka shpresë tjetër përveçse të aplikojë për azil:

Nuk shoh asgjë në horizont. Asnjë të ardhme. (...) Jam i detyruar, që të gjej një punë. Shkova te zyra e punës, po nuk ka punë. Jam 63 vjeç dhe gruaja është 50. Edhe ajo është pa punë. Jemi të gjithë pa punë. Ku ta gjejmë rrugëdaljen? Na duhet të gjejmë një zgjidhje dhe, pastaj, të gjejmë një vend në fund të botës.

Ky grup i vogël duhet të ndërgjegjësohet për pasojat negative që vijnë nga aplikimi për azil. Për shumë prej tyre, kjo do t'u thellojë varfërinë. Për më tepër, shumë azilkërkues të kthyer nuk janë të ndërgjegjshëm që nuk mund të lëvizin brenda zonës Shengen për të paktën 10 muaj, në rastet kur janë kthyer vullnetarisht dhe të paktën 30 muaj, kur janë dëbuar.

8.2 Për ku?

Shumë azilkërkues të kthyer besojnë se ata dhe familjet e tyre kanë shanse më të mira në BE dhe, sidomos, në Gjermani. Kjo lidhet edhe me imazhin që azilkërkuesit kanë për Gjermaninë si vend i përparuar social (arsimi, kujdesi shëndetësor, mbrojtja sociale), që ofron shumë mundësi punësimi (edhe për personat e pakualifikuar) dhe paga të larta. Intervistat treguan se pothuaj të gjithë azilkërkuesit thanë se donin të emigronin në Gjermani.⁶⁹ Të tjera vende të preferuara janë Italia, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar.

69 Një studim i kryer në vitin 2018 zbuloi se Gjermania ishte vendi më i preferuar i migrantëve të mundshëm nga Shqipëria. Për më shumë informacion, shih: Gëdeshi, I. dhe King, R. (2018) *New Trends in Potential Migration from Albania*. Tirana: F. Ebert Foundation.

Kjo preferencë e flukseve të mundshme migratore shqiptare në të ardhmen kryesisht drejt Gjermanisë do të sjellë ndryshime cilësore dhe sasiore, konkretisht, në raport me të ardhurat, kursimet, dërgesat në para dhe kapitalin njerëzor e social të migrantëve shqiptarë.

Pavarësisht nga dëshira e shumicës së azilkërkuesve të kthyer për të riemigruar, ka dy pyetje që duhen bërë: Cili është dallimi midis këtyre dy flukseve? Cili është dallimi midis flukseve të azilkërkuesve dhe migracionit të mundshëm të të kthyerve në një hark prej disa vitesh? Sipas diskutimeve në grup dhe intervistave, dallimi kryesor qëndron në formën e migrimit dhe në atë që mund të quhet 'cilësia' e flukseve migratore. Pjesa më e madhe e azilkërkuesve dëshirojnë të migrojnë në mënyrë të rregullt, me kontratë dhe vizë pune, ndërsa vetëm një numër i vogël zgjedh të aplikojë sërish për azil në BE. Nga ana tjetër, cilësia e këtyre flukseve ose është e ndryshme, ose po ndryshon. Migrantët e mundshëm kanë marrë ose janë në proces të marrjes së një profesioni, flasin ose janë në proces mësimi të një gjuhe të huaj, kanë më shumë informacion dhe kapitale sociale në vendin pritës, kanë ndryshuar mendësinë dhe e shohin të ardhmen për familjet e tyre nga një këndvështrim ndryshe.

Këto prire të reja në migracionin e mundshëm mes të kthyerve, si arsimi dhe formimi profesional, mësimi i një gjuhe të huaj dhe migrimi i rregullt në vend të aplikimit për azil duhet të nxiten dhe mbështeten.

9. Përfundime dhe rekomandime

Gjatë tri dekadave të fundit, Shqipëria ka përjetuar një nga proceset më të mëdha në botë, kur bëhet fjalë për madhësinë (përqindjen e popullsisë aktuale) dhe intensitetit të migracionit ndërkombëtar.⁷⁰ Thuhet në gjysmën e dekadës së tretë të këtij procesi, një valë e re migracioni ndodhi jashtë Shqipërisë, që, ndryshe nga ato të mëparshme, ishte në formën e azilkërkimit në vendet e BE-së (kryesisht, Gjermani dhe Francë. Ndërkohë që dukuria ishte e pranishme gjatë dekadës së tretë, ajo e arriti kulmin në vitin 2015, kur rreth 67 000 shtetas shqiptarë aplikuan për azil, vetëm për të rënë më pas, falë masave shtrënguese të marra nga vendet pritëse.⁷¹ Ky segment i popullsisë migratore është nga më të varfrit në shoqërinë shqiptare, renditur në fund të shkallës së të ardhurave familjare, por, në kundërshtim me disa vende të tjera të Ballkanit Perëndimor, nuk ka karakter mbizotërues rom.⁷²

Struktura socio-demografike e këtij grupi tregon qartë se pjesëtarët e tij janë të rinj, me nivel më të ulët arsimor dhe profesional sesa popullsia e përgjithshme, në kërkim të një të ardhmeje më të mirë për veten, por, sidomos, për fëmijët e tyre. Shtysat kryesore për këtë dukuri janë kushtet ekonomike (varfëria, papunësia afatgjatë, punë rastësore të pakualifikuara me pagë të ulët në sektorin informal, rroga të vogla, ndihmë e papërfillshme sociale dhe borxhe). Përveç tyre, ka edhe faktorë të tjerë nxitës, si mospasja ose cilësia e ulët e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, strehimi, konfliktet dhe pasiguritë fizike, që shkaktojnë stres të vazhdueshëm psikologjik dhe cilësia e ulët e arsimit (për të thënë disa). Për disa nëngrupe (romët dhe egjiptianët), diskriminimi është faktor shtesë.

Kthimi i azilkërkuesve shqiptarë – sa i përket madhësisë dhe intensitetit, për disa vjet (2015-2017) Shqipëria ka kryesuar listën e vendeve për numrin e të kthyerve nga vendet e BE,⁷³ - ka sjellë si nevojë riintegrimin e tyre në kuptimin e punësimit, shëndetësisë, strehimit, arsimit dhe shërbimeve sociale. Shumë të kthyer, në varësi të kohëzgjatjes së qëndrimit dhe përvojës së përftuar në vendin pritës, kanë ndërtuar një kuptim të ri e më të gjerë të riintegrit. Edhe pse mbështetur në teknika kryesisht cilësore, raporti dokumenton se për familjet dhe individët ku integrim ka nuk ka qenë i qëndrueshëm, veçanërisht në aspektin social-ekonomik dhe se situata e familjeve të tyre nuk ka ndryshuar (në të kundërt, në disa raste, është përkeqësuar)⁷⁴ kundrejt periudhës përpara migracionit. Si rezultat, mungesa e ndihmës për riintegrim të qëndrueshëm bën që shumë të kthyer të kthejnë sytë nga rimiigrimi ose emigrimi i detyrë në vendet e BE-së, kryesisht, Gjermani, si alternativa e vetme e vlefshme. Në ç'formë duhet të jetë ky emigrim?

Studimi tregon se shumica e të kthyerve që duan të rimiigrojnë janë më të ndërgjegjshëm, krahasuar me disa vjet më parë, se të kërkosh azil në vendet e BE-së, nuk është zgjidhje për problemet e tyre. Ata duan të emigrojnë rregullisht, të marrin një kontratë dhe vizë pune. Nga njëra anë, raporti kosto-përfitim, si rezultat i masave shtrënguese (përsheptimi i procedurave të azilit, kushtet e vështira të strehimit në kampe, mosdhënia e një pagese për shpenzimet ditore etj.) në vendet pritëse të BE-së ka ndryshuar. Kjo nënkupton se kostoja (shpenzimet e udhëtimit etj.) për individët/familjet është më e lartë sesa përfitimet e mundshme në vendin pritës, duke cenuar kështu aftësinë e tyre për të shlyer borxhet që do duhet të marrin për të financuar udhëtimin. Nga ana tjetër, ata e lidhin migracionin e rregullt me punësimin dhe integrimin në vendin pritës (dhe jo me qëndrimin pasiv si azilkërkues në kampe).

Vetëm një grup i vogël të kthyerish, kryesisht romë dhe egjiptianë, thonë se do aplikojnë sërish për azil. Në këtë rast, autoritetet lokale dhe OJF të ndryshme që veprojnë në fushën e shërbimeve, përveç rritjes së mbështetjes së tyre për

70 Banka Botërore (2016a) *Migration and Remittances Factbook 2016*. Washington DC: The World Bank.

71 Schuring, E., Pearson, C., Castro, A., Mathebula, B., Kronenberg, V., Becker, M. dhe Horneber, J. (2017) *Social Protection as an Alternative to Migration? An Assessment of the Role of Social Protection in Reducing Push Factors for Migration in Different Country Contexts*. Berlin: Gesellschaft für Versicherungswissenschaft und -Gestaltung e.v.

72 Grupi i Bankës Botërore (2019) *Supporting the Effective Reintegration of Roma Returnees in the Western Balkans*. Washington DC: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Banka Botërore.

73 Grupi i Bankës Botërore (2019) *Mbështetja e riintegrit efektiv të të kthyerve romë në Ballkanin Perëndimor*. Washington DC: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Banka Botërore. Morrica, V. dhe Stavrou, S. (2018) Prezantim PowerPoint në Seminarin prezantues, 'Mbështetja e riintegrit efektiv të të kthyerve (romë) në Ballkanin Perëndimor'. Vjenë, më 15 janar.

74 Sipas intervistave dhe diskutimeve në grupet e fokusuara, familjet që kanë marrë para borxh për të paguar udhëtimin dhe që kthehen pas një qëndrimi të shkurtër jashtë nuk kanë qenë në gjendje të përfitojnë financiarisht aq sa për të shlyer borxhin, kështu që gjendja e tyre rëndohet më shumë seç ishte përpara se të largoheshin nga vendi.

riintegrimin, duhet të punojnë për të rritur ndërgjegjësimin e tyre se aplikimi i përsëritur për azil nuk është zgjidhje për problemet e tyre dhe se e gjitha kjo vetëm sa u thellon varfërinë.

Pyetja për t'u bërë në këtë rast është se çfarë duhet të bëjmë, që riintegrimi i të kthyerve të jetë një proces dinamik e i qëndrueshëm. Në këtë rast, riemigrimi i tyre do të merrte një tjetër natyrë. Të gjithë e kanë të qartë se përmirësimi i shërbimeve në arsim, kujdes shëndetësor, mbrojtje sociale, strehim, siguri etj. do të kërkonte kohë, më shumë investime dhe, së paku, një dyfishim të përqindjes së tyre në PBB-në e vendit. Ky objektivi, i cili do të zvogëlonte disa prej faktorëve shtytës të migracionit shqiptar, mund të arrihet vetëm në një periudhë afatgjatë. Në vijim do të paraqesim vetëm disa rekomandime afatshkurtra dhe afatmesme.

E para, regjistrimi i të kthyerve (spontanisht, vullnetarisht apo me forcë) në të gjitha pikat e hyrjes ose, të paktën, në aeroportin e Rinasit⁷⁵ dhe mbledhja e të dhënave. Kjo mund të realizohet përmes intervistës së strukturuar me të kthyerit për shkaqet e migracionit, përvojën dhe nevojat e tyre. Mbi këtë bazë mund të ngrihet sistemi i menaxhimit të informacionit, që do të mbledhë të dhëna elektronike, do të krijojë lidhje midis të kthyerve dhe institucioneve përkatëse që ofrojnë shërbime dhe ndjekin procesin e riintegrit. Ky sistem, i cili duhet të dërgojë të dhëna elektronike njëkohësisht në nivel qendror dhe vendor, do të bënte të mundur kontrollin dhe matjen e efektivitetit të politikave dhe programeve të riintegrit. Ai mund të ndihmojë aktorët (ofruesit e shërbimeve, donatorët, organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të) që të parandalojnë mbivendosjet dhe të bashkërendojnë më mirë përpjekjet për t'u ofruar shërbime të kthyerve. Përveç kësaj, sistemi mund të shkëmbejë informacion me institucionet e vendit pritës për çështje të caktuara (p.sh. certifikatat e lindjes për foshnjat e lindura atje, dokumentet e shkollës, certifikatat mjekësore).

Forcimi i kapaciteteve lokale në fushën e shërbimeve, sidomos në ato bashki që kanë numrin më të lartë të të kthyerve është një tjetër aspekt. Kjo mund të arrihet përmes trajnimit të vazhdueshëm të personelit të ofruesve lokalë të shërbimeve, hartimit të planeve vendore të riintegrit dhe parashikimit të fondeve në buxhetet përkatëse, si dhe përmes përmirësimit të bashkërendimit vertikal (me pushtetin qendror) dhe horizontal (me organizatat ndërkombëtare dhe OJF që punojnë me të kthyerit). Trajnimi i personelit do të rriste efikasitetin e përpjekjeve të tyre për riintegrimin e të kthyerve. Për më tepër, ai do të rriste besimin e të kthyerve në institucionet publike (sportelet e migracionit, zyrat e punësimit, zyrat e ndihmës ekonomike etj.).⁷⁶ Në disa raste (sidomos në bashkitë me numrin më të lartë të të kthyerve), mund të krijohen ekupe ndërsektoriale me përfaqësues nga zyrat e punësimit, ndihma ekonomike, kujdesi social, zyrat arsimore, policia, OJF-të lokale e ndërkombëtare, punonjës socialë e psikologë, për të ndihmuar në riintegrimin e të kthyerve.

Nga këndvështrimi ekonomik, riintegrimi në Shqipëri do të kërkonte përmirësim dhe zgjerim të strukturës së punësimit dhe mundësive të biznesit të vogël, me qëllim që të sigurohet punë për të kthyerit në sektorin formal dhe të ardhura më të larta. Kjo jo vetëm do t'i ndihmonte për riintegrimin e tyre ekonomik, por gjithashtu do të kontribuonte që të kishte më pak njerëz pesimistë për të ardhmen e tyre në Shqipëri e më pak njerëz që e shohin migracionin si 'e vetmja rrugëdalje'. Krijimi i kooperativave ose ndërmarrjeve sociale për të kthyerit (si edhe për qytetarë të tjerë) do të ishte një rrugë efektive për krijimin e vendeve të reja të punës, kryesisht në prodhim dhe përpunim. Në varësi edhe të moshës, arsimit, vendit dhe kohës së qëndrimit, të kthyerit kanë sjellë me vete kapital të ri njerëzor dhe social (aftësi, trajnime, praktika profesionale jashtë vendit, përvojë pune në sektorët formalë dhe joformalë, një mendësi të re), që mund t'i përdorin në përfitim të tyre dhe të shoqërisë. Një tjetër mundësi punësimi dhe të ardhurash më të larta do të ishte ndihma për fillimin e një biznesi dhe zgjerimi i ndërmarrjeve të vogla e të mesme (përmes trajnimeve për menaxhim, sigurimit të burimeve financiare, formimit profesional etj.).

Fëmijët e kthyer duhet të ndihmohen për t'u riintegruar në sistemin shkollor. Kjo përfshin së pari regjistrimin e menjëhershëm në shkollë, për të mos e humbur vitin shkollor⁷⁷. Shumë familje që janë dëbuar nga policia nuk kanë asnjë dokument shkollor për fëmijët. Në këtë rast, Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë (MASR) ose çdo institucion tjetër përgjegjës për arsimin duhet të shqyrtojë mundësitë e bashkëpunimit me institucionet homologe në vendin pritës për dokumentet që lidhen me shkollimin e fëmijës së kthyer (diploma, dëftesa etj.). Duhet zbatuar procedura të thjeshtuara për të ulur shpenzimet e familjeve të kthyer për përkthimin dhe noterizimin e dokumenteve shkollore për fëmijët. Në ato raste kur fëmijët e kthyer nuk disponojnë asnjë dokument shkollor, ata duhen ndihmuar me klasa shtesë nga mësues me përvojë, përpara sesa të kryejnë testin vlerësues, në mënyrë që të mos e humbasin vitin shkollor. OJF-të ndërkombëtare dhe lokale që janë aktive në fushën e riintegrit duhet të trajnojnë drejtorët e drejtorive arsimore

75 Nëse të kthyerit nuk janë regjistruar në pikat e kalimit kufitar, ata duhet të kenë mundësi të regjistrohen te institucionet vendore, si «sportelet e migracionit» ose «zyrat e punësimit» në qytetin ku banojnë.

76 Numri i papërfillshëm i të kthyerve të regjistruar në sportelet e migracionit tregon, mes të tjerave, nivelin e ulët të besimit.

77 Në bazë të diskutimeve dhe intervistave në grupet e fokusuara, fëmijët e kthyer që nuk regjistrohen menjëherë në shkollë rrezikojnë të humbasin vitin shkollor dhe, më pas, ta braktisin shkollën.

dhe drejtorët e shkollave, sidomos në ato bashki ku është numri më i lartë i fëmijëve të kthyer, lidhur me zbatimin e udhëzimeve/vendimeve të MASR, ndihmën për të kthyerit dhe për të ndarë historitë e suksesit. Fëmijët që nuk kanë njohuri të mjaftueshme të gjuhës shqipe duhen ndihmuar nga mësues me përvojë pas orëve rregullta të mësimit, ose në shkollë, ose në mjedise të tjera.

Kjo praktikë duhet të zbatohet edhe për lëndë të tjera të veçanta (p.sh. matematika ose lëndë të tjera shkencore), ku fëmija i kthyer i ka vështirësi, për shkak të ndryshimit të kurrikulave midis vendit pritës dhe Shqipërisë. Shkollat që kanë fëmijë të kthyer duhet të organizojnë më shumë aktivitete sociale, kulturore dhe sportive, për të nxitur përfshirjen dhe socializimin e tyre. Psikologu i shkollës dhe mësuesi kujdestar duhet t'i kushtojnë vëmendje shtesë fëmijës së kthyer lidhur me shqetësimet e mundshme që ka. Mbajtja e kontaktit sistematik me prindërit e tyre, në shkollë ose në shtëpi, duhet të jetë një praktikë e zakonshme. Shumë fëmijë të kthyer që kanë ndjekur kurse gjuhe ose shkollën për një apo dy vjet në vendet pritëse (Gjermani, Francë) flasin rrjedhshëm gjermanisht apo frëngjisht. Është e rëndësishme që ata t'i ruajnë dhe zhvillojnë më tej aftësitë e fituara gjuhësore përmes kurseve shtesë në shkollë apo diku tjetër. OJF-të lokale dhe ndërkombëtare mund të luajnë rol në këtë drejtim.

Në fushën e kujdesit shëndetësor, të kthyerit që kanë marrë trajtim në vendin pritës ose kanë probleme shëndetësore duhet të jenë në gjendje ta vazhdojnë mjekimin në spitale të specializuara publike ose private. Ndihma financiare, në këtë rast, duhet të ofrohet nga institucionet shëndetësore publike apo OJF-të që ofrojnë shërbime për të kthyerit. Në disa bashki ku ka mungesa në personelin e kujdesit shëndetësor mund të dërgohen ekipe të specializuara mjekësh nga Tirana për raste specifike. Duhet të ofrohet ndihmë e posaçme për shëndetin mendor të të kthyerve (sidomos të grave, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuar, grupeve të diskriminuara), të cilat mund të kenë përjetuar stres psikologjik të vazhdueshëm, ankth dhe traumë gjatë qëndrimit të tyre në vendin pritës dhe në kthim. Në bashki të tjera, duhet marrë parasysh mundësia e ofrimit të personelit të specializuar për trajtimin e fëmijëve autikë.

Lidhur me strehimin, të kthyerit mund të ndihmohen financiarisht për një periudhë të caktuar kohe nga bashkia apo OJF-të që merren me çështjet e riintegrit për të mbuluar qiranë apo riparuar shtëpinë. Në raste të tjera, të kthyerit që janë të pastrehë apo jetojnë në kushte të vështira duhet të ndihmohen për të përgatitur dokumentacionin përkatës për t'u kualifikuar për strehim social. Në disa vendbanime romë dhe egjiptiane duhen bërë më shumë investime për përmirësimin e infrastrukturës (rrugë, ujësjellës, kanalizimet etj.).

Nëse riintegrimi është i qëndrueshëm, natyra e migracionit për të kthyerit ndryshon. Siç e kemi theksuar në studime të tjera⁷⁸, dëshira për të riemigruar jashtë Shqipërisë është një sindromë e padëshiruar, por edhe një realitet që duhet ta pranojmë. Për rrjedhojë, duhen bërë përpjekje që procesi të menaxhohet në mënyrë të tillë që të ulë në minimum pasojat negative (migracionin e parregullt, shfrytëzimin etj.) dhe të rritë në maksimum efektet pozitive (përdorim produktiv i dërgesave, lidhje me atdheun, kthimi nga emigracioni etj.).

Studimi tregoi se të shqiptarët e kthyer janë më se të ndërgjegjshëm se disa vjet më parë për nevojën e formimit profesional, mësimit të gjuhës dhe kulturës së vendit pritës, me qëllim që të mund të përshtaten më lehtë me kërkesat e tregut të punës. Ndihma në këtë drejtim do të rriste kapitalin njerëzor për vendin dhe do të lehtësonte integrimin e tyre në vendin pritës. Përveç kësaj, kanalet zyrtare dhe agjencitë e punësimit mund të luajnë një rol kyç në migracionin e rregullt. Ato mund të lehtësojnë periudhën tranzitore, derisa ata të gjejnë një punë në sektorin formal, në përputhje me aftësitë dhe arsimin e migrantit. Kështu, burimet njerëzore nuk do të humbin dhe ne do të kemi një situatë prej së cilës fitojnë të gjithë.

78 Gëdeshi, I. dhe King R. (2018) *New Trends in Potential Migration from Albania*. Tiranë: Fondacioni "F. Ebert"; King, R. dhe Gëdeshi, I. (2019) *New trends in potential migration from Albania: the migration transition postponed? Migration and Development*.

Bibliografi

- Arslan, C., Dumont, J-C., Kone, Z., Moulan, Y., Ozden, C., Parsons, Ch. And Xenogiani, T. (2014) *A New Profile of Migrants in the Aftermath of the Recent Economic Crisis*. Paris: OECD Social, Employment and Migration Working Paper No. 160.
- Barjaba, K. (2000) Contemporary patterns in Albanian migration. *South-East Europe Review*, 3(2): 57–64.
- Barjaba, K. and Barjaba, J. (2015) *Embracing Emigration: The Migration–Development Nexus in Albania*. Brussels and New York: Migration Policy Institute. Retrieved November 2019 from: www.migrationpolicy.org/article/embracing-emigration-migration-development-nexus-albania.
- Connor, P. (2016) *Number of Refugees to Europe Surges to Record 1.3 Million in 2015*. Washington DC: Pew Research Centre, 2 August.
- De Soto, H., Gordon, P., Gëdeshi, I. and Sinoimeri, Z. (2002) *Poverty in Albania: A Qualitative Assessment*. Washington DC: World Bank Technical Paper No. 520.
- De Soto, H., Beddies, S. and Gëdeshi, I. (2005) *Roma and Egyptians in Albania: From Social Exclusion to Social Inclusion*. Washington DC: The World Bank.
- EASO (2013) *Asylum Applicants from the Western Balkans. Comparative Analysis of Trends, Push-Pull Factors and Responses*. Brussels: European Asylum Support Office.
- EASO (2015a) *Asylum Applicants from the Western Balkans. Comparative Analysis of Trends, Push-Pull Factors and Responses – Update*. Brussels: European Asylum Support Office.
- EASO (2016) *Annual Report on the Situation of Asylum in the European Union 2015*. Valletta: European Asylum Support Office.
- EASO (2019) *Annual Report on the Situation of Asylum in the European Union 2018*. Valletta: European Asylum Support Office.
- Esipova, N., Ray, J. and Pugliese, A. (2017) Number of potential migrants worldwide tops 700 million, *Gallup News*, 8 June.
- European Training Foundation (2007) *The Contribution of Human Resources Development to Migration Policy in Albania*. Turin: ETF.
- Eurostat (2019) GDP per capita, consumption per capita and price level indices. Retrieved December 2019 from ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/GDP_per_capita,_consumption_per_capita_and_price_level_indices#Relative_volumes_of_GDP_per_capita.
- Eurostat News Release (2016) Asylum in the EU member states: record number of over 1.2 million first-time asylum seekers registered in 2015, *Eurostat Newsrelease*, 4 March.
- Gëdeshi, I. and Jorgoni, E. (2012) *Mapping Roma Children in Albania*. New York: UNICEF.
- Gëdeshi, I. and Miluka, J. (2013) *Needs Assessment Study*. New York: UNDP.
- Gëdeshi, I. and Xhaferaj, E. (2016) *Social and Economic Profile of the Return Migrants in Albania*. Tirana: International Organization for Migration.
- Gëdeshi, I. and King, R. (2018) *New Trends in Potential Migration from Albania*. Tirana: F. Ebert Foundation.

- Gëdeshi, I. and de Zwager, N. (2012) Effects of the global crisis on migration and remittances in Albania, in: Sirkeci, I., Cohen, J.H. and Ratha, D. (eds) *Migration and Remittances during the Global Financial Crisis and Beyond*. Washington DC: The World Bank, pp. 237–254.
- Gëdeshi, I., Mykerezi, P. and Danaj, E. (2016) *Mapping of Skills, Employment and Entrepreneurship Opportunities of Roma and Egyptians in the Project Sites of Tirana, Durres, Berat and Shkodra*. Tirana: UNDP.
- Hackaj, A. and Shehaj, A. (2017) *Disconnected: Return from Germany and Reintegration Challenges of Albanian Asylum Seekers*. Tirana: Cooperation and Development Institute, Working Paper 'Berlin Process Series'.
- INSTAT (2012a) *Albania. Preliminary Results of the Census of Population and Housing 2011*. Tirana: INSTAT.
- INSTAT (2015a) *Roma and Egyptians in Albania: A Socio-Demographic and Economic Profile based on the 2011 Census*. Tirana: INSTAT.
- INSTAT (2015b) *Labour Market 2014*. Tirana: INSTAT.
- INSTAT (2018) *Tregu i Punës 2018*. Retrieved January 2020 from www.instat.gov.al/media/5576/tregu-i-punes-2018-njoftim-per-media.pdf.
- INSTAT (2019) *Quarterly Labour Force Survey*. Tirana: INSTAT. Retrieved January 2020 from: www.instat.gov.al/.
- INSTAT and IOM (2014) *Return Migration and Reintegration in Albania*. Tirana: INSTAT/IOM.
- King, R. (2003) Across the sea and over the mountains: documenting Albanian migration, *Scottish Geographical Journal*, 119(3): 283–309.
- King, R. and Gëdeshi, I. (2019) New trends in potential migration from Albania: the migration transition postponed? *Migration and Development*. Retrieved January 2020 from www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/21632324.2019.1608099?journalCode=rmd20.
- Morrica, V. and Stavrou, S. (2018) PowerPoint presentation at the Inception Workshop 'Supporting the Effective Reintegration of (Roma) Returnees in the Western Balkans'. Vienna, 15 January.
- OECD (2019) *International Migration Outlook 2019*. Paris: OECD Publishing.
- Open Society Foundation for Albania (2014) *Census of Roma Housing and Population in Albania*. Tirana: Open Society Foundation for Albania.
- Republic of Albania, Council of Ministers (2018) *National Strategy on Diaspora and Migration 2018–2024 and Action Plan*. Tirana: Council of Ministers.
- Robayo-Abril, M. and Millán, N. (2019) *Breaking the Cycle of Roma Exclusion in the Western Balkans*. Washington DC: The World Bank.
- Sabadie, J.A., Avato, J., Bardak, U., Panzica, F. and Popova, N. (2010) *Migration and Skills. The Experience of Migrant Workers from Albania, Egypt, Moldova, and Tunisia*. Washington DC: World Bank, 2010.
- Schuring, E., Pearson, C., Castro, A., Mathebula, B., Kronenberg, V., Becker, M. and Horneber, J. (2017) *Social Protection as an Alternative to Migration? An Assessment of the Role of Social Protection in Reducing Push Factors for Migration in Different Country Contexts*. Berlin: Gesellschaft für Versicherungswissenschaft und -Gestaltung e.v.
- Vathi, Z. and King, R., eds. (2017) *Return Migration and Psychosocial Wellbeing: Discourses, Policymaking and Outcomes for Migrants and their Families*. London: Routledge.
- World Bank (2011) *Migration and Remittances Factbook 2011*. Washington DC: The World Bank.
- World Bank (2016a) *Migration and Remittances Factbook 2016*. Washington DC: The World Bank.
- World Bank (2016b) *South-East Europe Regular Economic Report, Resilient Growth and Rising Risks*. Washington DC: The World Bank.
- World Bank (2018) *Higher but Fragile Growth: Western Balkans Regular Economic Report No. 14*. Washington DC: The World Bank.
- World Bank (2019) *Western Balkans Labour Market Trends 2019*. Washington DC: The World Bank.
- World Bank Group (2019) *Supporting the Effective Reintegration of Roma Returnees in the Western Balkans*. Washington DC: International Bank for Reconstruction and Development/The World Bank.